



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian




Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve



CLG Durrës

Expectation



No Budget for children
Health Education Illness
Violence Food
Healthy family entertainment

REALITY

ANALIZE AFATMESME

e Planit Kombëtar të Veprimit për Fëmijët dhe Fondeve Publike të Alokua për Zbatimin e tij

Instituti Studimeve Bashkëkohore



Institute for Contemporary Studies



Save the Children

Botimi i këtij raporti u mundësua nga Save the Children

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

TIRANË, 2014

Ky raport publikohet në kuadër të projektit “Rritja e Investimeve Publike për realizimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”, i financuar nga BE dhe zbatuar nga Save the Children në partneritet me Institutin e Studimeve Bashkëkohore dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

©Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave zbatuese si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

KAPITULLI 1

VLERËSIMI AFATMESËM I FONDEVE BUXHETORE DHE I SHPENZIMEVE PËR PLANIN KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Përgatitur nga:
**Instituti për Studime Bashkëkohore
(ISB)**

Experte të ISB:
**Juna Miluka
Sabina Ymeri
Elira Jorgoni**

Dhjetor, 2014

Pasqyra e lëndës

Indeksi i Tabelave dhe i Figurave	3
Lista e Figurave	4
Shkurtime	5
1. Objekti i studimit dhe metodologji e shkurtër	6
2. Situata e fëmijëve në Shqipëri	9
Përmbledhje e shkurtër mbështetur në kuadrin ekzistues të politikave dhe të dhënave ekzistuese	9
Shpenzimet e familjeve për arsimin	11
Përfshirja sociale	14
Puna dhe arsimimi i fëmijëve	17
Shëndeti i fëmijëve	21
3. Shpenzimet publike <i>k</i> . të drejtave të fëmijëve	24
Analizë e shkurtër e buxhetit sektorial	25
Shpenzimet e arsimit për fëmijët	29
Arsimi bazë	31
Arsimi i mesëm	33
Barazia në arsim	34
Shpenzimet shëndetësore për fëmijët	35
Kujdesi shëndetësor parësor	36
Shërbimet e kujdesit shëndetësor publik	38
Mbrojtja sociale për fëmijët	38
Drejtësia për të miturit	43
4. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet	46
Gjetjet kryesore dhe rekomandimet mbështetur në analizën e statistikave sociale	46
Gjetjet kryesore dhe rekomandimet mbështetur në analizën e buxhetit të shtetit	47

Indeksi i Tabelave dhe Figurave

Lista e Tabelave

Tabela 1:	Shpenzimet mujore për arsimin nga familjet.....	12
Tabela 2:	Shpenzimet mujore për arsimin sipas grupmoshave për fëmijët.....	13
Tabela 3:	Shpenzimet mujore për arsimin sipas prefekturave dhe grupmoshave të fëmijëve.....	14
Tabela 4:	Varfëria e fëmijëve e lidhur me arsimin	16
Tabela 5:	Shpërndarja e djemve dhe vajzave sipas moshës dhe statusit të punës	18
Tabela 6:	Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas aktiviteteve ekonomike	19
Tabela 7:	Shpërndarja e djemve dhe e vajzave sipas statusit të punësimit	19
Tabela 8:	Pjesëmarrja në shkollë e fëmijëve në moshë pune dhe jo pune sipas moshës	20
Tabela 9:	Modelet e përdorimit të kohës nga djemtë dhe vajzat e moshës 6-17	20
Tabela 10:	Përbërja e shpenzimeve të sektorit sipas programeve, 2012 – 2014 dhe PBAM 2015-2017	26
Tabela 11:	Shpenzimet për fëmijët në të katër sektorët 2012 - 2017	28
Tabela 12:	Shpenzimet në arsim sipas programit: 2012 dhe 2013 (aktuale), 2014 – 2017 (buxheti	30
Tabela 13:	Përqindja e shpenzimeve sipas programit dhe vitit.....	31
Tabela 14:	Ndarjet ekonomike për shpenzimet e arsimit publik në tri programet kryesore (në %, buxheti i 2015-ës)	31
Tabela 15:	Shpenzimet në arsimin bazë/klasifikimi ekonomik	32
Tabela 16:	Shpenzimet për arsimin e mesëm/klasifikimi ekonomik.....	33
Tabela 17:	Produktet në përfshirjen sociale në arsim (MAS).....	34
Tabela 18:	Financimi për MSH-në dhe të ardhurat nga sigurimet shoqërore në buxhetin e 2015-ës dhe buxhetin e rishikuar të 2014-ës.....	35
Tabela 19:	Përbërja e shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë sipas programit dhe zërave kryesore 2014 - 2015	36
Tabela 20:	Shpërndarja e mjekëve të përgjithshëm sipas rajoneve në vitin 2014	37
Tabela 21:	Përqindja e komponentëve kryesorë të mbrojtjes sociale në PBB dhe në shpenzimet publike totale.....	40
Tabela 22:	Programi dhe produktet e Programit për Mbrojtjen e Buxhetit	40
Tabela 23:	Përputhshmëria e buxhetit për mbrojtjen sociale - buxheti k. realizimit.....	42

Tabela 24: Programi i buxhetimit të përfshirjes sociale.....43

Tabela 25: Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë 2013 (aktuali) dhe buxheti për periudhën 2014 - 2017 ...45

Lista e figurave

Figura 1: Përqindja e popullsisë së fëmijëve	9
Figura 2: Numri i individëve për grupmosha.....	9
Figura 3: Shpenzimet mujore për arsimin sipas gjinisë dhe zonës	13
Figura 4: Niveli i varfërisë sipas moshës së fëmijëve	15
Figura 5: Niveli i varfërisë së familjeve sipas numrit të fëmijëve.....	15
Figura 6: Familjet me fëmijë nën 18 vjeç që marrin ndihmë ekonomike.....	17
Figura 7: Prevalenca e fëmijëve që punojnë dhe e punës së fëmijëve sipas rajonit.....	21
Figura 8: Niveli i vdekshmërisë sipas gjinisë.....	22
Figura 9: Përqindja e fëmijëve të keqshqyer.....	22
Figura 10: Përqindja e fëmijëve mbipeshë	23
Figura 11: Përqindja e shpenzimeve në sektorët e lidhur me fëmijët në raport me PBB-në dhe shpenzimet publike totale.....	26
Figura 12: Përbërja e buxhetit të sektorit sipas programeve, 2012 – 2017	27
Figura 13 Përqindja e PBB-së dhe shpenzimeve buxhetore të shpenzimeve direkte për fëmijët në programet e përzgjedhura buxhetore.....	29
Figura 14: Shpenzimet për arsimin si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore dhe PBB-ja 2012 - 2017	30
Figura 15: Buxheti i MSH-së sipas zërave kryesore dhe përqindja e tij në raport me PBB-në dhe shpenzimet totale buxhetore.....	35
Figura 16: Vizitat e kryera në qendrat e kujdesit parësor shëndetësor 2008 – 2013.....	37
Figura 17: Përbërja e shpenzimeve të mbrojtjes sociale.....	41
Figura 18: Përqindja e sistemit të burgjeve dhe e shërbimit të provës në buxhetin e përgjithshëm të MD-së për periudhën 2013 - 2017	45

Shkurtime

GDF	Grupet Drejtuese të Fëmijëve
KM	Këshilli i Ministrave
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
IEDDNj	Instrumenti Evropian për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
DBE	Delegacioni i Bashkimit Evropian
QSh	Qeveria e Shqipërisë
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shëndetësore
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti i Parapranimit
DM	Drejtësia për të Miturit
LFPR	Niveli i Pjesëmarrjes në Krahun e Punës
NjQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
LSMS	Vrojtimi për Matjen e Standardeve të Jetesës
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MF	Ministria e Financave
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MZhUT	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
PBAM	Programi Buxhetor Afatmesëm
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
PKVMDF	Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
AKAFPk	Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional dhe Kualifikimet
KKMDF	Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
ShKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
IKP	Inspektorati Kombëtar i Punës
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
BB	Banka Botërore

1. Objekti i studimit dhe metodologjia

Ky vlerësim afatmesëm i Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (PKVMDF) është realizuar si analizë bazë për të shqyrtuar nëse politikat dhe planet për të drejtat e fëmijëve mbështeten me burime financiare të mjaftueshme dhe mundësojnë rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e investimit për fëmijët. Metodologjia e përdorur është mbështetur në analizimin e raporteve kryesore strategjike, kërkimore dhe raporte monitorimi të organizatave jo-qeveritare, ndërkombëtare dhe dokumenteve strategjike të Qeverisë së Shqipërisë, diskutimet në grupe të fokusuara me fëmijët dhe me anëtarët e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe tryezat e rrumbullakëta me zyrtarë të qeverisë.

Analiza eksploroj dokumente strategjike të AShMDF-së, përparësitë dhe politika të tjera ndërsektoriale të lidhura me të drejtat e fëmijëve. Qëllimi i kësaj pune është të vlerësohet se sa objektivat strategjike të PKVMDF-së mbështeten me burime të nevojshme buxhetore. Më tej, kjo analizë përqendrohet në shqyrtimin e objektivave strategjikë të Planit Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve në fushën e mbrojtjes, përfshirjes sociale, mbrojtjes nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, arsimit, kujdesit shëndetësor dhe drejtësisë së të miturve (kjo e fundit u shtua më tej në analizë, në vijim të kërkesës së MMSR-së dhe AShMDF-së); meqenëse arritjet dhe dështimet në zbatimin e PKVMDF nuk lidhen gjithnjë me akordimin e burimeve, por më shumë me kapacitetet dhe me vullnetin e mirë. Ndërkohë, janë organizuar disa diskutime me autoritetet përkatëse për të përcaktuar me siguri faktorët kryesorë që kanë ndikim mbi planin e veprimit nëpërmjet një analize përfshirëse. Këto diskutime kanë përfshirë dhe elementë mbështetës. Kjo analizë ka përfituar nga mbështetja e MMSR-së dhe AShMDF-së, komentet dhe lehtësimi i vyer për procesin e mbledhjes së të dhënave.

Monitorimi i buxhetit ka parë tendencat e ndarjes së buxhetit, shpenzimet aktuale në një periudhë të caktuar kohore (prej rreth 3 vitesh) dhe përputhshmërinë e buxhetit, duke qenë se shpesh shpenzimet faktike buxhetore janë të ndryshme nga planet fillestare. Vlerësimi aktual përfshin disa elemente të përbashkëta: analizën e transparencës së buxhetit, duke u përqendruar specifikisht tek mbulimi dhe qartësia e tij. Përveç buxhetit me të dhënat e marra nga ministritë e linjës, ekipi i projektit ka bërë një analizë të shkurtër të tipareve dhe nevojave kryesore në secilin prej sektorëve, duke përdorur burime shtesë të dhënash, të tilla si sondazhet e Institutit të Statistikave (INSTAT) dhe në veçanti të Vrojimit për Matjen e Standardeve të Jetesës (LSMS 2012), Censusi i 2011-ës dhe të dhëna dhe raporte të tjera të disponueshme nga AShMDF-ja dhe agjenci të tjera që i kanë shërbyer analizës.

Kjo analizë përqaesë e fondeve të buxhetit përkundrejt përparësive të përcaktuara në PKVMDF dhe kostove të identifikuara, thekson çështje të lidhura me përbërjen ndërsektoriale të shpenzimeve. Analiza përkon po ashtu dhe me procesin afatmesëm

buxhetor, ndaj ekipi i projektit u ofroi ndihmë ministrive të linjës për identifikimin e burimeve dhe të planifikimit buxhetor për Programin Afatmesëm Buxhetor (2015-2017). Kontribute shtesë janë mbledhur nëpërmjet angazhimit të organizatave të shoqërisë civile dhe fëmijëve /GDF-ve në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet *Save the Children*, si partneri kryesor i projektit.

Metodat e përdorura:

Përkufizimi i Programeve: shpenzimet për fëmijët janë të shpërndara në një gamë të larmishme programesh qeveritare, ndaj ishte e nevojshme përlllogaritja e peshës së fondeve për fëmijët në disa programe që i shërbejnë popullsisë së përgjithshme. Janë ngritur disa pyetje lidhur me çështjet konceptuale që kanë të bëjnë me masën deri ku përfitojnë fëmijët, por përderisa nuk ka përgjigje të drejtpërdrejta për të gjitha pyetjet, ekipi ka dhënë gjykime personale mbështetur në qasjen metodologjike dhe të dhënat e disponueshme.

Në këtë analizë fëmijëria është përkufizuar përgjithësisht si grupi i individëve që i përkasin grupmoshës nga 0-18 vjeç. Si rezultat, janë përjashtuar shpenzimet për arsimin e lartë ose për programe të tjera që etiketojnë grupe përtej kësaj kategorie. Për të vendosur për përzgjedhjen e programit për këtë analizë, programi duhet të plotësojë të paktën njëri prej kriterëve të mëposhtme:

Fëmijët janë përfitues të drejtpërdrejtë: përfitimet ose shërbimet e drejtpërdrejta që janë tërësisht për fëmijët (p.sh., programe arsimit fillor dhe të mesëm, etj.), duke përfshirë dhe programe që përfshijnë përfitime të drejtpërdrejta për fëmijët (p.sh., pagesa për fëmijët me paaftësi etj.);

Fëmijët janë përfitues të tërthortë: nivele të caktuara të përfitimeve familjare mund të rriten kur bëhet fjalë për familje me disa fëmijë (p.sh. kur aplikohet për përfitimin e ndihmës ekonomike);

Megjithatë, për qëllime të kësaj analize pjesë e përkufizimit për programin nuk janë të gjitha programet që u ofrojnë përfitime familjeve (p.sh. përfitimet e papunësisë dhe përfitime të tjera ku shumica e përfitimit që merr i rrituri nuk lidhet me praninë ose me numrin e fëmijëve). Në këtë analizë, nuk janë marrë parasysh as programe të tjera që sjellin përfitime në përgjithësi për popullsinë që mund të ketë fëmijë si përfitues të tërthortë, por që nuk janë kusht për zbatimin e programit.

Mbledhja e të dhënave: llogaritja e përqindjes së shpenzimeve publike për fëmijët kërkon mbledhjen e të dhënave nga burime të shumta dhe bërjen e prezumimeve dhe hamendësimeve. Detyra e parë për ekipin e punës ishte mbledhja e programeve përkatëse për fëmijët sipas secilit sektor, duke u përqendruar kryesisht drejtpërsëdrejti tek programet në përfitim të fëmijëve ose të familjeve përfituese për shkak të pranisë së fëmijëve. Së dyti, ne mblodhëm të dhënat e shpenzimeve për secilin program duke përdorur *Buxhetin e Shtetit për vitin 2012, 2013 dhe 2014* si burim parësor, buxhetet e detajuara nga ministritë përkatëse dhe/ose agjencitë e varësisë, dhe raportet e monitorimit të buxhetit për shpenzimet e realizuara për krahasimin e planeve të buxhetit dhe ekzekutimin e tyre. Përpjekje të mëdha janë bërë për të vlerësuar pjesët e programeve që u shkojnë posaçërisht fëmijëve. Intervistat me ekspertët e buxhetit nga agjencitë

përkatëse, me Sekretarin e Përgjithshëm të MMSR-së dhe drejtuesin e AShMDF-së kanë dhënë informacion lidhur me proceset e buxhetit dhe lidhjes të tyre me përparësitë e politikave.

Llogaritja e shpenzimeve për fëmijët: Në llogaritë tona janë përfshirë plotësisht të gjitha programet që ua kanë dedikuar të gjitha burimet e tyre fëmijëve. Këto janë edhe programe që u japin fonde fëmijëve dhe grupmoshave më të mëdha, kështu që, për këtë arsye, ne kemi llogaritur pjesën e kontributit për fëmijët mbështetur në numrin e fëmijëve dhe të të rriturve në familje dhe duke prezumuar përfitime të barabarta për frymë brenda familjes.

Për më tepër, ne i kemi kushtuar përpjekje të posaçme vlerësimit të përqindjes së shpenzimeve të familjeve për arsimimin, mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve, mbështetur në të dhënat ekzistuese nga vrojtimi i fundit i realizuar nga INSTAT-i. Kjo analizë e ndërthurur na ka ndihmuar për të bërë një analizë më të plotë duke krahasuar nevojat aktuale të fëmijëve me shpenzimet e familjeve për sektorët e përzgjedhur dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit. Më tej, analiza mbështetet në artikulin e rekomandimeve kyçe nga një perspektivë më e gjerë politikash dhe nga një qasje rajonale, pasi analiza e buxhetit përqendrohet vetëm në nivelin qendror.


Shënime shtesë për metodologjinë dhe programet shtjellohen më tej në seksionet kryesore (seksioni 2 dhe 3)

2. Situata e fëmijëve në Shqipëri

Përmbledhje e shkurtër mbështetur në kuadrin dhe të dhënat ekzistuese të politikave


Popullsia shqiptare është shumë e re, me moshë mesatare 35.3 vjeç në vitin 2011. Indeksi i zëvendësimit, i cili tregon raportin e popullsisë nën moshën 15 vjeç, është 21.0% sipas Censurit të vitit 2011. Më specifikisht fëmijët, të përkufizuar si individë ndërmjet moshës 0-17 vjeç përbëjnë më pak se 9%¹ 30%² të popullsisë së përgjithshme. Në Shqipëri numërohen 847,312 individë në moshën nga 0-19³ vjeç. Përqendrimi i fëmijëve të moshës nga 0-4 vjeç dhe nga 5-9 vjeç është pak më i madh në zonat urbane, ndërsa përqendrimi i fëmijëve nga mosha 10-14 vjeç është pak më i madh në zonat rurale. Personat në moshën 15-19 vjeç kanë po ashtu përqendrim pak më të madh në zonat urbane. Vizualizimi i përbërjes dhe përqendrimit të grupmoshave të fëmijëve në zona është i rëndësishëm për të hartuar politika në përputhje me karakteristikat, tiparet social-ekonomike të vendeve ku ata jetojnë.

Figura 1: Përqindja e fëmijëve në popullsi



Burimi: Censuri i vitit 2011

Figura 2: Numri i individëve sipas grupmoshave



1. Të dhënat e Censurit sipas grupmoshave kanë grupuar së bashku grupmoshat 15-19, kështu që nuk ka një vlerësim të saktë të fëmijëve të moshës 0-17. Vlera prej 9% është rrrumbullakosur për t'ju afruar më shumë përjashtimit të individëve të grupmoshave 18-19, të cilët nuk janë pjesë e popullsisë së fëmijëve.
2. Të dhënat e Censurit sipas grupmoshave janë grupuar së bashku për moshën 15-19 vjeç, kështu që nuk ka një vlerësim i saktë për fëmijët e moshës 0-17. Vlera prej 30% është një mbivlerësim i fëmijëve, pasi në të përfshihen po ashtu individë të moshës 18-19 vjeç, të cilët nuk janë pjesë e popullsisë së fëmijëve.
3. Për vlerësim të saktë të numrit të fëmijëve duhet të përjashtohet grupmosha 18-19 vjeç. Siç u përmend dhe më sipër, grupimi sipas të dhënave të Censurit nuk lejon bërjen e këtij vlerësimi.

Ka pasur disponueshmëri të vazhdueshme nga ana e qeverisë për të prodhuar strategji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto strategji përmbajnë parashikime për uljen e pabarazive ndërmjet qarqeve, grupeve social-ekonomike dhe fëmijëve në rrethana të posaçme. Zbatimi i ligjit në nivelin lokal dhe krijimi i infrastrukturës së posaçme për zbatimin e ligjit kanë qenë ndër ato hapa të pranishme në të gjitha strategjitë. Në këtë kuadër, krijimi i zyrave të Observatorit⁴ ka ndihmuar në monitorimin e të drejtave të fëmijëve si dhe në udhëzimin e ofrimin e politikave që përkojnë me nevojat e fëmijëve. Për më tepër, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve shërbejnë si struktura në bashki për të vlerësuar dhe monitoruar situatën e familjeve dhe të fëmijëve në rrezik, për të koordinuar mbrojtjen, referimin dhe përgjigjen në nivelin lokal dhe për të kryer identifikimin dhe menaxhimin e çështjet multidisiplinore më urgjente. NjMF-të shërbejnë dhe si qendër ku mund të lihen fëmijët, vend ku fëmijët dhe familjet mund të vijnë dhe të gjejnë më shumë informacion ose për të marrë referime për shërbime të tjera mbështetëse. Të gjitha shërbimet janë pa pagesë dhe synojnë të prekin fëmijët dhe familjet më vulnerabël.

Ligji “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” parashikon kuadrin e plotë ligjor dhe institucional dhe përcakton mekanizmat institucionalë për të garantuar zhvillimin dhe mbrojtjen nëpërmjet një qasje të koordinuar. Ligji forcon mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet krijimit të Njësiteve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në nivelin lokal dhe koordinimit me aktorë të ndryshëm si në nivelin e qeverisjes qendrore dhe në nivelin e qeverisjes lokale. Ai krijon Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (KKMDF) dhe një organ këshillimor në Këshillin e Ministrave.

Strategjia e Sektorit për Mbrojtjen Sociale (2007-2013) mbulon politika të mbrojtjes sociale të cilat synojnë përmirësimin e trajtimit të përfitimeve sociale, decentralizmin e shërbimeve sociale dhe institucionalizimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me organizatat e shoqërisë civile. Disa prej përparësive të strategjisë përfshijnë lëvizjen drejt shërbimeve të mbështetura në komunitet, krijimin e alternativave të mbështetura në komunitet për shërbimet e kujdesit rezidencial. Më tej, ato përfshijnë rritje të shumëllojshmërisë dhe gjeografisë së shërbimeve mbështetur në nevojat e komunitetit si dhe rritjen e përfshirjes së qeverisjes lokale lidhur me planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Roli i qeverive vendore për financimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe vijimësisë së shërbimeve mendohet të rritet. Strategjia bën thirrje për hartimin, zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e standardeve të shërbimeve për të gjitha grupet në nevojë për të siguruar cilësi më të mirë jetese, veçanërisht për fëmijët, njerëzit me paaftësi dhe të moshuarit, si dhe duke promovuar përfshirjen e praktikave të biznesit social në financimin dhe ofrimin e shërbimeve të komunitetit. Duhet të theksohet që është përmbushur periudha e zbatimit të strategjisë, ndërkohë që aktualisht po zhvillohet një strategji e re.

Kuadri i Decentralizimit të Kujdesit Social dhe plani i tij i veprimit kanë si qëllim të krijojnë një sistem të qëndrueshëm mbarëkombëtar për kujdesin social. Një ndër

4. “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” është një iniciativë ndërmjet UNICEF Albania dhe “Aleancës së Fëmijëve Shqiptarë”, e cila ka ndërtuar mekanizmin e saj për të mbledhur informacion dhe për të analizuar situatën e të drejtave të fëmijëve në nivelin rajonal në të gjitha rajonet e Shqipërisë. Ai përbën një strukturë për shoqërinë civile duke shërbyer si platformë për dhënien e opinionëve dhe angazhimeve të reja, dhe si forum për ndarjen e eksperiencave ndërmjet organizatave të ndryshme të institucioneve dhe të organizatave lokale. Projekti është zbatuar që prej marsit të vitit 2009. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve ka zyra në 12 qarqe të Shqipërisë. Informacioni i mbledhur në terren dhe të gjitha studimet janë vënë në dispozicion të institucioneve, organizatave dhe të gjithë individëve të interesuar. Janë hartuar edhe raporte vjetore të cilat përshkruajnë situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Këto çështje janë pjesë edhe e monitorimit nga strukturat e Bashkimit Evropian dhe reflektohen dhe në raportet e progresit për Shqipërisë.

sfidat kryesore është reforma për mirëqenien sociale si dhe politika të tjera plotësuese social-kulturore për të siguruar uljen ose eliminimin e pabarazive dhe politika sipas nevojave specifike të fëmijëve.

Strategjia Ndërsektoriale për Përfshirjen Sociale (2007-2013) përqendrohet tek strategjitë ndërsektoriale lidhur me varfërinë dhe përjashtimin social. Në të përshkruhen strategjitë për t'ju ardhur në ndihmë familjeve dhe grupeve vulnerabël në komunitet, duke i kushtuar rendësi të posaçme fëmijëve me paaftësi dhe romëve. Strategjia përcakton objektiva për rritjen e të ardhurave dhe rritjen e aksesit në shërbime.

Plani i Veprimit i Qeverisë së Shqipërisë (2012-2015) përqendrohet tek çështjet e lidhura me strukturat institucionale dhe është projektuar për të monitoruar dhe për të raportuar për të drejtat e fëmijëve. Dispozitat e tij çojnë përpara reforma legjislativë dhe institucionale që sigurojnë në një mjedis mbrojtës dhe përfshirës për të gjithë fëmijët. Më tej, Plani i Veprimit synon po ashtu të nxisë, koordinojë dhe të harmonizojë politika që janë përfshirëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe për përfshirjen sociale. Në këtë kuadër, është krijuar Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në vitin 2011, e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e ligjit dhe për të siguruar koordinimin e strategjive dhe politikave për të drejtat e fëmijëve në të ardhmen. Ajo ofron po ashtu mbështetje teknike për njësitë e qeverisjes vendore, qeverisë qendrore dhe organizatave të shoqërisë civile të përfshira me të drejtat e fëmijëve. Ajo koordinohet me organet e qeverisjes qendrore dhe lokale për të hartuar raporte, dërguar informacione dhe statistika për vënien në jetë të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Shpenzimet e familjeve për arsimin

Rritja e investimeve publike për fëmijët kërkon një analizë dinamike të kufizuar jo vetëm në analizën buxhetore dhe qeveritare, por edhe brenda familjes, si dhe në vlerësimin e situatës social-ekonomike të fëmijëve. Në këtë kuadër, ndarja e shpenzimeve për arsimin sipas familjeve jep informacion më të detajuar lidhur me kategoritë që kërkojnë pjesën më të madhe të shpenzimeve, ose të cilave u jepet pjesa më e madhe e burimeve nga familjet. Kjo mund të shërbejë për t'u dhënë një tregues politikë-bërësve lidhur me dispozitat e posaçme që mund të ndërmerret prej tyre në analizimin e buxhetimit ose të fondeve publike.

Lidhur me shpenzimet mujore të familjeve për arsimin, në përgjithësi shpenzimet mujore për arsimin janë më të mëdha për zonat urbane krahasuar me zonat rurale. Për më tepër, zonat urbane kanë shpenzime më të larta mujore për arsimin lidhur me tarifat⁵, ndërsa zonat rurale kanë shpenzime më të larta për transportin. Shpenzimet për jetesën zënë po ashtu një pjesë më të madhe të shpenzimeve mujore të familjeve si në zonat urbane dhe në zonat rurale. Këto gjetje theksojnë praninë e kushteve të ndryshme social-ekonomike ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Pavarësisht dallimeve në koston e jetesës ndërmjet të dy zonave, gjë e cila mund të shpjegojë dallimet në tarifa, dëshmojnë dhe dallimet në kthimet nga arsimit ndërmjet zonave, dhe në këtë mënyrë, dhe vendimin e prindërve për arsimimin e fëmijëve të tyre. Në anën tjetër, përderisa zonat rurale mund të gjenden në zona më të largëta dhe mund të kenë një numër më të vogël shkollash, ato mund të

5. Tarifat përfshijnë çdo lloj paraje që i paguhet shkollave për funksione të ndryshme. Ato mund të përfshijnë tarifat shkollore për institucionet private.

kërkojnë më shumë transport, çfarë përkthehet në shpenzime më të larta për arsimimin e fëmijëve. Për pasojë, mund të jetë i nevojshëm transporti publik për fëmijët ruralë për të çliruar familjet nga shpenzimet e larta për arsimimin e fëmijëve dhe për t'ju dhënë mundësi prindërve në zonat rurale për t'i dërguar fëmijët në shkollë.


Shpenzimet parashkollore janë një tjetër zë i lidhur me shpenzimet mujore të familjeve si në zonat urbane dhe në ato rurale. Ashtu si edhe për zërat e tjera të shpenzimit për arsimin, ato janë më të larta në zonat urbane. Përveç asaj çfarë u përmend më sipër lidhur me standardet dhe me koston e dallimeve të jetesës ndërmjet të dyja zonave, familjet në zonat rurale mund të mbështeten më shumë tek anëtarët e tjerë të familjes për t'u kujdesur për fëmijët në moshë parashkollore, gjë e cila mund të ndryshojë për familjet urbane. Nga ana tjetër, mund të ndodhë që edhe në zonat rurale familjeve t'u duhet të mbështeten tek anëtarët e tjerë të saj për t'u kujdesur për fëmijët e vegjël në mungesë të shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijëve. Kjo mund të jetë një fushë tjetër që mund të kërkojë investime përsa i përket ndihmës publike nga shteti.

Nuk ka prova të qarta për dasitë në nivelin e familjeve përsa i përket nivelit të shpenzimeve për arsim ndërmjet djemve dhe vajzave (Figura 3). Megjithëse në përgjithësi djemtë kanë shpenzime pak më të larta, dallimi është i parëndësishëm. Dallimi duket diçka më i madh në zonat urbane, megjithëse mbetet ende shumë i vogël (47.2 Lek/muaj). Kjo është në përputhje me gjetjet e mëparshme nga Miluka (2011⁶), ku familjet nuk bëjnë dallimin ndërmjet djemve dhe vajzave lidhur me shpenzimet për arsimin në momentin që vendosin t'i çojnë fëmijët në shkollë, por mekanizmi dallues është vendimi për t'i dërguar ose jo fëmijët në shkollë. Së fundmi, megjithëse shpenzimet për arsimin për djemtë dhe vajzat duken në pamje të parë të jenë në të njëjtin nivel, ato mund të duken të ndryshme nëse marrim parasysh nevojat e ndryshme të të dyja gjinive. Megjithatë, kjo çështje mbetet objekt i studimeve të mëtejshme të përqendruara në këtë temë.

Tabela 1: Shpenzimet mujore për arsimin nga familjet

	Lekë	Urbane	Rurale
Tarifat dhe pagesat për parashkollorin	2221.53	2476.22	1276.63
Totali i tarifave, dhuratave dhe shërbimeve në parashkollor	2264.11	2512.77	1341.62
Transporti	1135.23	976.94	1332.20
Tarifat	1147.53	1339.64	908.47
Unifomat	115.16	121.07	107.80
Tekstet shkollore	690.15	717.60	655.99
Tekstet shkollore plotësuese	64.40	83.18	41.03
Materiale	188.01	194.53	179.89
Jetesë	1036.76	1036.72	1036.81
Ekskursionet	129.75	136.30	121.60
Mbikëqyrje	225.90	308.78	122.75
Dhurata	12.46	10.87	14.45
Të tjera	172.12	181.37	160.60
Totali i shpenzimeve për arsim	3493.90	3747.20	3178.60

6. Miluka, J. (2011). Arsimimi, Migracioni dhe Tregjet e Punës në Shqipëri: Perspektivë gjinore, Umi Dissertation Publishing. ISBN-10: 1243607211.

Figura 3: Shpenzimet mujore për arsim sipas seksit dhe zonës

Burimi: LSMS 2012

Është e dukshme që shpenzimet mujore të familjeve për arsimin rriten paralelisht me moshën e fëmijës (Tabela 2). Fëmijët e moshës shkollore nga 6 deri në 14 vjeç kërkojnë shpenzime më të larta lidhur me transportin, tarifën, uniformat, librat shkollore, materialet, jetesën, ekskursionet, etj. krahasuar me fëmijët në moshë shkolle. Është e qartë që me rritjen e fëmijës rriten dhe shpenzimet për arsimin pasi nevojat e tyre vijnë në rritje. Për pasojë, mbështetja publike duhet të marrë parasysh përbërjen e popullsisë së fëmijëve për të kanalizuar investimet publike siç duhet, pasi fëmijët e moshave të ndryshme kanë nevojë të ndryshme dhe përbëjnë pengesa/barra të ndryshme financiare mbi familjet. Për më tej, përderisa shpenzimet për arsim rriten me rritjen e moshës, prindërit me të ardhura të ulëta mund të duhet të marrin vendimin për të vazhduar t'i çojnë apo jo fëmijët në shkollë, apo në tregun e punës. Për pasojë, është e domosdoshme të kuptohet struktura e moshës së fëmijëve dhe shpenzimet për arsimin brenda familjeve përpara se të merren vendime publike lidhur me ndarjet e buxhetit për investime publike.

Tabela 2: Shpenzimet mujore për arsimin sipas grupmoshave për fëmijët

	Fëmijët e moshës 0-5 vjeç	Fëmijët e moshës 6-14 vjeç
Tarifat dhe pagesa e parashkollorit	395.98	
Totali i tarifave, dhuratave dhe shërbimeve në parashkollor	409.25	
Transporti	236.42	697.29
Tarifat	276.86	464.75
Uniformat	46.04	114.38
Tekstet shkollore	228.33	554.47
Tekstet shkollore plotësuese	20.16	52.34
Materiale	59.45	171.78

Jetesë	100.48	502.31
Ekskursionë	28.55	106.91
Mbikëqyrje	21.20	178.43
Dhurata	3.52	10.70
Të tjera	58.99	125.52
Totali i shpenzimeve për arsim	1059.89	2111.26

Burimi: LSMS 2012

Shpenzimet mujore të familjeve për arsimin sipas prefekturave dhe moshës së fëmijëve tregojnë që prefekturat e Beratit, Kukësit dhe Korçës kanë vlerat më të larta (Tabela 3). Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve jepen për fëmijët e moshës 6 deri në 14 vjeç në Berat, dhe fëmijët e moshës 0-5 në dy prefekturat e tjera. Shpenzimet më të mëdha mujore për arsimin në prefekturën e Kukësit, e cila është ndërmjet prefekturave më të varfra në vend, mund të jetë shkaktuar nga numri i madh fëmijëve në këtë zonë. Po ashtu, prefektura e Dibrës është një tjetër prefekturë me shpenzime të larta mujore për arsimin. Në këtë kuadër, shpenzime më të larta arsimore ndërmjet prefekturave më të varfra mund të paralajmërojnë kundër barrës më të madhe financiare për familjet për shkak të numrit të madh të fëmijëve në moshë parashkollori. Këto zona mund të kenë nevojë për më shumë mbështetje për fëmijët e parashkollorit.

Tabela 3: Shpenzimet mujore për arsimin sipas prefekturave dhe grupmoshave të fëmijëve

Prefekturat	Totali	Fëmijët e moshës 0-5 vjeç	Fëmijët e moshës 6-14 vjeç
Berat	5457.996	1640.51	3346.561
Dibër	3790.396	3289.678	2508.226
Durrës	2982.889	1858.661	2004.777
Elbasan	3580.65	1394.306	2117.259
Fier	3924.482	889.9474	2302.981
Gjirokastër	3940.009	1064.422	2250.854
Korçë	4083.824	4080.304	2187.85
Kukës	4135.439	2647.228	2498.998
Lezhë	3620.403	1101.854	2847.447
Shkodër	2698.135	1765.296	1736.338
Tiranë	2968.616	2055.616	2123.886
Vlorë	3145.048	3352.904	2391.905

Burimi: LSMS 2012


Përfshirja sociale

Niveli i varfërisë së familjeve⁷ duket se ulet me rritjen e moshës së fëmijëve (Figura 4). Familjet me fëmijë në moshën 0-5 vjeç kanë nivele më të larta të varfërisë, ndërsa familjet me fëmijë në moshën nga 15 deri në 17 kanë nivelin më të ulët të varfërisë. Fëmijët më të vegjël janë të varur nga prindërit e tyre dhe, për pasojë, përdorin burimet e familjes pa kontribuar në to, ndërsa fëmijët më të rritur mund të kontribuojnë me

7. Niveli i varfërisë është përcaktuar në shpenzimin real për frymë në 4,891 lek për muaj me çmimet e 2002-it.

punën e familjeve, ose mund të dërgohen për punë. Sa më e varfër të jetë familja, aq më shumë të ngjarë ka që ajo t'i dërgojë fëmijët në punë për të lehtësuar shtrëngesat e buxhetit dhe për të rritur të ardhurat e familjes, të cilat, nga ana tjetër, mund të përdoren nga fëmijët më të vegjël. Për pasojë, fëmijët nga familjet më të varfra që janë në moshë shkolle janë në rrezik më të madh që të lihen jashtë sistemit arsimor dhe të punojnë brenda ose jashtë familjes. Kërkohe mbështetje për familjet më të varfra për të minimizuar rrezikun e dërgimit të fëmijëve në punë. Të dhënat, të cilat tregojnë familjet me fëmijë më të mëdhenj që kanë nivele më të ulëta të varfërisë, mund të jenë treguese të fëmijëve që punojnë për të ulur varfërinë e familjes. Mund të ndodhë po ashtu që prindërit me fëmijë më të vegjël, veçanërisht gratë, të qëndrojnë në shtëpi, ndërsa prindërit me fëmijë më të rritur të shkojnë në punë. Nga ana tjetër, familjet me fëmijë më të vegjël janë më të prekshëm nga varfëria dhe më vonë mund t'i drejtojnë drejt punës fëmijët e tyre. Për pasojë, demografia dhe përbërja e familjeve është e domosdoshme për ndarjen e mbështetjes publike.


Figura 4: Niveli i varfërisë sipas moshës së fëmijëve



Burimi: LSMS 2012

Qartazi, me rritjen e numrit të fëmijëve rritet niveli i varfërisë së familjeve (Figura 5 dhe Tabela 4). Familjet më të mëdha kërkojnë burime më të mëdha, ose kërkojnë që burimet ekzistuese të ndahen ndërmjet një numri më të madh personash. Nga ana

Figura 5: Niveli i varfërisë së familjeve sipas numrit të fëmijëve



Burimi: LSMS 2012

tjetër, siç u përmend më sipër, familjet më të mëdha mund të kenë më shumë fëmijë në varësi, gjë e cila paraqet më shumë kufizime financiare për familjen. Kjo dëshmon nevojën për mbështetje publike lidhur me kujdesin gjatë ditës, ose për shërbime të tjera dhe për mbështetje sociale për fëmijët e vegjël në mënyrë që nënat që janë kryesisht personat kyç për kujdesin ndaj fëmijës mund të bëhen pjesë e tregut të punës dhe të kontribuojnë tek të ardhurat e familjes. Duhet të ofrohen stimuj në mënyrë që më shumë gra të bëhen pjesë e tregut të punës, në vend që të bëjnë fëmijët e tyre pjesë të tregut të punës. Kjo kërkon ndërveprim dhe koordinim të organeve të ndryshme të politikë-bërjes për të ofruar stimuj që përmirësojnë jetesën në familje dhe, për pasojë, mirëqenien e fëmijëve.

Ashtu siç u diskutua dhe më sipër, familjet me numër më të madh fëmijësh që kanë nivel më të lartë varfërie kanë po ashtu tendencë të kenë nivele më të ulëta arsimit të krerëve të familjes (Tabela 4). Problemi është dinamik: nga njëra anë, sa më arsim të ulët të ketë kreu i familjes, dhe për pasojë, sa më pak e arsimuar familja, aq më shumë ka të ngjarë që familja të jetë e varfër, dhe për pasojë, aq më e lartë është incidenca e të qenët më pak të arsimuar. Në anën tjetër, familjet më pak të arsimuara kanë tendencë të kenë më shumë fëmijë, duke e rritur kështu mundësinë e të qenët të varfër dhe probabilitetin e dërgimit të fëmijëve në punë si mënyrë për të ulur varfërinë. Kjo ka ndikim negativ mbi arsimin dhe rrit mundësinë e të bërit të varfër, ose të mbetjes në nivelin e varfërisë. Si rezultat, ka nevojë për mbështetje publike për të rritur nivelin e arsimit, uljen e punës së fëmijëve dhe përmirësimit të jetesës.

Tabela 4: Varfëria e fëmijëve e lidhur me arsimin


Numri i fëmijëve	Niveli i varfërisë	Arsimimi sipas kokëve	Madhësia e familjes
0	4.5	10.0	3
1	12.29	10.3	4
2	15.39	10.1	5
3	27.36	9.7	6
4	45.79	8.7	7
5	49.77	7.9	8
6	96.33	10.3	10
7	100	8	9
8	100	12	16

Burimi: LSMS 2012

Cenueshmëria e familjeve me fëmijë ndaj varfërisë konfirmohet dhe nga përqindja e familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç të cilat marrin ndihmë ekonomike (Figura 6). Mesatarisht një e pesta e familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç marrin ndihmë ekonomike. Dallimet rajonale janë mjaft të dukshme. Kukësi ka pa diskutim përqindjen më të lartë të familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç që trajtohen me ndihmë ekonomike. Niveli i Kukësit e kalon 85%. Qarku tjetër me nivelin më të lartë të trajtimit me ndihmë ekonomike është qarku i Dibrës me nivele që e kalojnë 50%, pasuar nga Shkodra dhe Lezha me mesatarisht 35% dhe 30%. Nivelet më të ulëta hasen në Durrës, Vlorë, Fier dhe Tiranë. Qarqet me nivelet e përgjithshme më të larta kanë tendencë të kenë përqindje më të lartë të familjeve që marrin ndihmë ekonomike. Në fakt, qarqet e Kukësit, Lezhës, Dibrës dhe Shkodrës janë ndërmjet qarqeve me

nivelin më të lartë të varfërisë në vend. Nivelet e varfërisë në Kukës janë më të lartët në vend, duke arritur në 21.8%. Këto nivele janë po ashtu të larta në Lezhë, duke kapur nivelin e 17.5%, pasur nga Shkodra me 15.7% dhe Dibra 13.0%⁸. Kjo tregon që pasja e fëmijëve të pavarur rrit gjasat e familjeve që të bien në varfëri.

Figura 6: Familjet me fëmijë nën moshën 18 vjeç që marrin ndihmë ekonomike



Burimi: INSTAT, Censusi i 2011-ës

Varfëria në familje mund t'i çojë fëmijët të bien pre e kryerjes së krimeve. Përqindja e fëmijëve të akuzuar krahasuar me totalin e popullsisë është 8.21%. Djemtë kanë shumicën e akuzave me 9.33% krahasuar me popullsinë e përgjithshme. Nga ana tjetër, 99 vajza përbëjnë një përqindje shumë jo domethënëse për akuzat, duke zënë 0.94% të këtij zëri. Prej 1,437 fëmijëve të cilët kanë kryer krime në vitin 2013, pjesa më e madhe e krimeve të rënda që arrijnë totalin e 227 çështjeve janë si rezultat i krimeve të lidhura me drogat, të cilat numërohen në 133 çështje. Dallimet rajonale tregojnë që qytetet më të mëdha kanë numrin më të madh të krimeve të drogës. Numri më i madh i 69 çështjeve të krimeve të drogës është regjistruar në Tiranë dhe numri tjetër më i madh i çështjeve (12) është regjistruar në Durrës. Është e qartë që ka dallime të mëdha ndërmjet Tiranës dhe qarqeve të tjera. Kjo mund të vijë si rezultat i faktit që Tirana është zona më e populluar, ka prurjet më të mëdha të migracionit dhe pabarazitë social-ekonomike ndërmjet vendeve në qendër dhe zonave periferike. Demografia e qytetit është shumë e ndryshme në vendndodhje të ndryshme.

Puna dhe arsimimi i fëmijëve

Varfëria e familjeve si dhe pamundësia lidhur me burimet dhe me transportin e fëmijëve në shkollë mund të kenë ndikim mbi vendimin e prindërve për t'i dërguar në punë fëmijët. Në vendet në zhvillim fëmijët përdoren shpesh për punë plotësuese në

8. Burimi: LSMS-ja e 2012-ës.

familje si mënyrë për të rritur të ardhurat e familjeve. Në rast se prindërit nuk mund të përballojnë dërgimin e fëmijëve në shkollë, ata e zëvendësojnë këtë mundësi me dërgimin e tyre në punë. Për pasojë, është shumë e rëndësishme që të shihen statistikat e tregut të punës për fëmijët që punojnë në mënyrë që të ofrohet një pikëpamje më e qartë lidhur me nevojën më të madhe për investime dhe mbështetje publike për fëmijët, në mënyrë që ata të mund të zëvendësojnë punën me arsimin.

Djemtë e të gjitha moshave (5-17) kanë nivel më të lartë punësimi dhe pjesëmarrje më të lartë në krahun e punës (Tabela 5). Siç pritet, me rritjen e moshës, rritet dhe niveli i punës së fëmijëve dhe pjesëmarrja në tregun e punës. Djemtë ndërmjet moshës 15-17 vjeç kanë nivelin më të lartë të punësimit dhe të pjesëmarrjes në tregun e punës me përkatësisht 20.7% dhe 22.5%. Vajzat e të njëjtës grupmoshë, nga ana tjetër, kanë nivel punësimi prej 13.1% dhe pjesëmarrje në tregun e punës prej 14.5%. Kjo tregon që djemtë mund të kenë më shumë mundësi të bëhen fëmijë që punojnë ose të angazhohen në punën e fëmijëve. Duke përqafuar rolet tradicionale, kjo situatë mund të lidhet po ashtu me faktin që vajzat mund të kontribuojnë më shumë në punët brenda familjes, ndërsa djemtë dërgohen jashtë. Çdo lloj investimi duhet të marrë parasysh këto dinamika.

Tabela 5: Shpërndarja e djemve dhe vajzave sipas moshës dhe statusit të punës

	mosha 5 - 17		mosha 5 - 11		mosha 12 - 14		mosha 15 - 17	
	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat
Popullsia fëmijë	357,800	340,800	189,700	164,600	79,600	84,000	88,500	92,100
Të punësuar	32,400	21,600	5,400	3,000	8,700	6,600	18,300	12,000
Krahu i punës*	34,000	23,000	5,400	3,000	8,700	6,600	19,900	13,400
Niveli i punësimit (%)	9.1	6.3	2.9	1.8	10.9	7.9	20.7	13.1
LFPR (%)**	9.5	6.7	2.9	1.8	10.9	7.9	22.5	14.5

*Krahu i punës përfshin si individët e punësuar dhe ata të papunë: megjithatë, papunësia regjistrohet vetëm për fëmijët e moshës 15 - 17

**LFPR: Niveli i Pjesëmarrjes në Krahun e Punës (LFPR).

Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve 2010

Fëmijët angazhohen kryesisht në bujqësi (Tabela 6). Tetëdhjetë përqind e të gjithë fëmijëve të punësuar janë të angazhuar në bujqësi, gjueti, pyje dhe peshkim. Përfshirja e vajzave është disi më e madhe se pjesëmarrja e djemve në këtë aktivitet. Kjo mund të lidhet me pjesëmarrjen e tyre të madhe në punën e papaguar në familje (Tabela 7). Ndarja sipas statusit të punësimit tregon që 93.4% e vajzave të punësuar punojnë në punë familjare. Edhe pjesëmarrja e djemve në këtë aktivitet është e konsiderueshme, në nivelin 87.2%, por në nivel më të ulët se vajzat. Ky nivel është shumë domethënës pasi tregon që vajzat dhe djemtë, djemtë dhe vajzat vendosen në rolet e tyre goxha herët. Modeli i punësimit i ndjek ata gjatë të gjithë jetës, ku gratë gjenden kryesisht në punë familje të papaguar. Mund të ketë dhe ndikime të tjera për fëmijët në zonat rurale, pasi ata kryesisht merren me bujqësinë. Për pasojë, kërkohet vëmendje lidhur me mundësitë e punësimit për fëmijët dhe mbështetje shtesë për ata që merren me bujqësi. Po ashtu, kjo situatë kërkon vëmendje lidhur me mundësitë arsimore për fëmijët dhe mbështetje të mëtejshme për personat që jetojnë në zonat rurale.

Ka po ashtu disa aktivitete të fëmijëve të punësuar në tregtimin me shumicë dhe me pakicë, që mund të lidhet kryesisht me shitjen e fëmijëve në rrugë. Ky aktivitet shpesh

i largon fëmijët nga shkolla, ose nga aktivitetet edukative dhe nga detyrat e shkollës. Pra, informacioni rreth aktiviteteve të fëmijëve në punësim shërben për të hartuar politika që sigurojnë dhe rrisin të drejtat e fëmijëve, i largon ata nga puna e fëmijëve dhe i vendos në sistemin arsimor.

Tabela 6: Shpërndarja e fëmijëve në punësim sipas aktiviteteve ekonomike

Aktiviteti ekonomik (NACE rev. 1.1)	Të gjithë	Djemtë	Vajzat
Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi	43,200	25,200	18,000
	80.0%	77.8%	83.3%
Prodhimi	1,000	600	400
	1.8%	2.0%	1.6%
Energjia elektrike, gazi dhe uji	200	200	0
	0.3%	0.5%	0.0%
Ndërtimi	1,100	1,000	100
	2.0%	3.1	0.5%
Shitja me shumicë dhe me pakicë	4,400	2,600	1,800
	8.2%	8.1%	8.4%
Hotelet dhe restorantet	2,200	1,700	600
	4.1%	5.1%	2.6%
Transporti, ruajtja dhe komunikimi	500	200	300
	1.0%	0.7%	1.4%
Aktivitete të tjera	200	0	200
	0.6%	0.0%	1.1%
Të paklasifikuara (mbajtja e ujit, ndihma në shtëpi)	1,200	900	300
	2.1%	2.8%	1.2%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të punësuar	54,000	32,400	21,600

Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve

Tabela 7: Shpërndarja e djemve dhe e vajzave sipas statusit të punësimi

Statusi i punësimi	Të gjithë	Djemtë	Vajzat
Punonjës me pagesë (i punësuar)	3,100	25,200	18,000
	5.8%	77.8%	83.3%
Punonjës në llogari të vet	2,500	600	400
	4.6%	2.0%	1.6%
Punonjës familje pa pagesë	48,400	200	0
	89.7%	0.5%	0.0%
Numri i përgjithshëm i fëmijëve të papunë	54,000	32,400	21,600

Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve 2010

Koha e harxhuar për punësim të merr kohë nga koha e shkollës (Tabela 8). Fëmijët që nuk janë në punë ndjekin thuhetse 100% shkollën. Niveli i regjistrimit në shkollë është më i ulët për fëmijët që punojnë në moshën 15-17. Modelet e kohës për djemtë dhe vajzat e moshës 6-17 tregojnë që vajzat që janë në shkollë janë shumë më të përfshira në shërbimet e papaguara në familje krahasuar me djemtë (Tabela 9). Vajzat arrijnë në 43.0% krahasuar me 28.1% tek djemtë. Këto modele vijojnë gjatë të gjithë jetës dhe tregojnë rëndësinë e përcaktimit të roleve brenda dhe jashtë familjes që në moshë

të hershme. Më pas, dallimet brenda familjeve mund të nxirren jashtë familjes dhe shënjojnë pozicionin e tyre në tregun e punës në të ardhmen. Djemtë kanë po ashtu përqindje më të lartë të kohës së harxhuar në shkollë krahasuar me vajzat. Dallimi vjen kryesisht nga pjesëmarrja më e madhe e vajzave si në shkollë dhe në shërbime të papaguara në familje. Për pasojë, dasitë gjinore ndërmjet djemve dhe vajzave duhet të merren parasysh kur hartohen politika dhe kur bëhen investime publike, pasi ato mund të kenë efekt të ndryshëm mbi fëmijët. Investimet publike duhet të ofrojnë barazi dhe mundësi të barabarta për të përfutur prej tyre.

Tabela 8: Pjesëmarrja në shkollë e fëmijëve në moshë pune dhe jo pune sipas moshës

Pjesëmarrja në shkollë	mosha 5 - 17		mosha 5 - 11		mosha 12 - 14		mosha 15 - 17	
	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat	Djemtë	Vajzat
Fëmijët që punojnë	28,400	16,600	5,500	3,000	10,100	6,700	12,700	7,000
	79.9%	73.7%	100%	96.5%	94.8%	96.3%	65.9%	55.8%
Puna e fëmijëve	18,600	10,600	5,500	3,000	7,900	5,100	5,100	2,600
	79.2%	81.3%	100%	96.5%	95.3%	95.2%	53.4%	55.3%
Që nuk punojnë	300,500	293,000	169,400	150,000	67,300	74,600	63,700	68,800
	93.2%	92.3%	92%	93.1%	97.6%	96.7%	92.1%	86.4%

Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve, 2010

Tabela 9: Modelet e përdorimit të kohës nga djemtë dhe vajzat e moshës 6-17

Aktiviteti ekonomik (NACE rev. 1.1)	Të gjithë	Djemtë	Vajzat
Shkollë + të punësuar + punë shtëpie e papaguar	28,200	14,800	13,400
	4.3%	4.4%	4.2%
Shkollë + të punësuar	12,500	10,500	2,000
	1.9%	3.1%	0.6%
Shkollë + punë të papaguar në familje	232,300	94,100	138,300
	35.4%	28.1%	43.0%
Të punësuar + punë të papaguara në familje	9,400	3,900	5,500
	1.4%	1.2%	1.7%
Vetëm në shkollë	329,600	188,700	140,900
	50.2%	56.4%	43.8%
Vetëm të punësuar	3,900	3,200	700
	0.6%	1.0%	0.2%
Vetëm shërbime/punë të papaguara në familje	15,400	3,200	12,200
	2.3%	1.0%	3.8%
Jo aktivë (i ngathët)	24,800	16,400	8,400
	3.8%	4.9%	2.6%
Totali i numrit të fëmijëve të moshës 6 - 17	656,100	334,800	321,300


Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve 2010

Së fundmi ka më shumë fëmijë që punojnë sesa punë të fëmijëve⁹ (Figura 7). Prefekturat e Elbasanit, Korçës dhe Shkodrës kanë nivelet më të larta të fëmijëve që punojnë dhe të punës së fëmijëve. Prefekturat e Durrësit, Fierit, Gjirokastrës, Lezhës,

9. **Fëmijët** (e moshës 5-17) **përkufizohen si fëmijë** që punojnë (ose të punësuar), nëse ata punojnë të paktën një orë gjatë periudhës së përmendur, ose nëse kanë pasur një punë ose biznes nga i cili janë larguar përkohësisht. Sistemi i Kombeve të Bashkuara për Llogaritë

Tiranës, dhe Vlorës kanë nivelet më të larta të fëmijëve që punojnë dhe të punës së fëmijëve. Për këto rajone nevojitet një tjetër vështrim për të hedhur dritë mbi shkaqet e niveleve të larta të fëmijëve që punojnë dhe të punës së fëmijëve që shkojnë përtej marrëdhënies me nivelet e varfërisë rajonale.

Figura 7: Prevalenca e punës së fëmijëve dhe e punësimit të fëmijëve sipas qarqeve



Burimi: Sondazhi Kombëtar për Punën e Fëmijëve


Shëndeti i fëmijëve

Ka dasi gjinore si dhe dallime sipas grupmoshave të fëmijëve për sa i përket statistikave shëndetësore. Rezultatet më të mira dalin lidhur me imunizimin. Në vitin 2013 statistikatat nga Ministria e Shëndetësisë dëshmojnë që niveli i imunizimit arrin afër 100%. Nga ana tjetër, 71.2% e fëmijëve me sëmundje akute respiratore dhe 61.0% e fëmijëve me diarre trajtohen në ambientet e kujdesit shëndetësor.

Vdekshmëria tek fëmijët rezulton relativisht e lartë për fëmijët nën moshën pesë vjeç. Nivelet e vdekshmërisë për këtë grupmoshë kapin 10%. Nivelet ulen në rreth 9% për fëmijët deri në një vjeç, dhe më poshtë deri në thujse 6% për fëmijët (Figura 8). Megjithatë këto tendenca ruhen për të dyja gjinitë, në secilën grupmoshë djemtë kanë nivel më të lartë vdekshmërie krahasuar me vajzat. Dallimet më të mëdha janë për grupmoshat më të mëdha.


Kombëtare (SNA) përkufizohet si çfarë përbën dhe çfarë nuk përbën aktivitet ekonomik. Në aspekte të gjera, të gjitha aktivitetet e orientuara drejt tregut, prodhimi për konsum vetjak dhe aktivitetet të caktuara të bëra nga dhe për anëtarët e familjeve (të tilla si riparime të mëdha në familje, mbajtja e ujit, ose mbajtja e druve të zjarrit për përdorim nga familja) konsiderohen si aktivitete ekonomike, ndërsa personat e angazhuar në këto aktivitete konsiderohen si të punësuar.

Punë e fëmijëve në Shqipëri përkufizohet si aktiviteti që përfshin fëmijët e angazhuar në punë të papërshtatshme për kapacitetet e tyre, e cila mund të cenojë shëndetin, arsimin ose zhvillimin moral të tyre. Përkufizimi kombëtar mbështetet tek Konventa Nr. 138 e ILO-s për moshën minimale (1973) dhe Konventa e ILO-s Nr.182 për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve. Moshë minimale e punësimit në Shqipëri është 16 vjeç, megjithatë, fëmijët e moshës 14 deri në 15 vjeç mund të punojnë gjatë pushimeve të shkollës me kusht që punësimi të mos cenojë negativisht zhvillimin e tyre (Kodi i Punës i Shqipërisë, Neni 98).

Figura 8: Niveli i vdekshmërisë sipas gjinisë

Burimi: Ministria e Shëndetësisë, 2013

Niveli i kequshqyerjes¹⁰, i cili lidhet po ashtu me mirëqenien social-ekonomike të familjes, shoqërohet me dallime të mëdha ndërmjet grupmoshave (Figura 9). Po ashtu, lidhur me kequshqyerjen janë të pranishme dhe dallimet gjinore. Grupmoshat nën 6 vjeç kanë nivelin më të lartë të kequshqyerjes, e cila arrin nivelin 27%. Niveli i kequshqyerjes bie me rritjen e moshës së fëmijëve. Këto dallime janë shumë më të ulëta krahasuar me dallimet për fëmijët nën 6 vjeç. Niveli i kequshqyerjes për ta është 7 deri në 10%. Përqindja shumë e lartë e kequshqyerjes për fëmijët e moshës nën 6 vjeç mund të lidhet me nivelet e larta të varfërisë dhe vulnerabilitetin për varfëri të familjeve me fëmijë të vegjël. Po ashtu, fëmijët më të rritur mund të kenë më shumë mënyra për t'u ushqyer jashtë shtëpie, për t'u bërë pjesë e tregut të punës dhe për të mbajtur veten. Kequshqyerja e fëmijëve duhet të merret shumë seriozisht pasi ajo ka ndikim mbi rezultatet në shkollë përveç ndikimeve negative të drejtpërdrejta mbi shëndetin.


Figura 9: Përqindja e kequshqyerjes tek fëmijët

Burimi: Ministria e Shëndetësisë, 2013

10. Ministria e Shëndetësisë.

Fëmijët mbipeshë janë po aq shqetësues, megjithëse statistikat tregojnë për më pak dallime gjinore dhe dallime sipas grupmoshave (Figura 10). Tendencat e mbipeshës lidhen me kequshqyerjen dhe kushtet social-ekonomike të familjeve. Përqindja e fëmijëve mbipeshë arrin në 22%, çfarë do të thotë që 22 nga 100 fëmijë janë mbipeshë. Djemtë janë pak më mbipeshë sesa vajzat. Grupmosha e fëmijëve nën moshën 6 vjeç dhe grupmosha e fëmijëve të moshës 12-17 vjeç kanë nivele më të larta të mbipeshës. Grupmosha mesatare e fëmijëve nga 9-11 vjeç ka nivelin më të ulët të mbipeshës.

Figura 10: Përqindja e fëmijëve mbipeshë



Burimi: Ministria e Shëndetësisë, 2013

3. Shpenzimet publike për të drejtat e fëmijëve

Ky kre analizon politikat dhe shpenzimet fiskale të Qeverisë së Shqipërisë duke nënvizuar interpretimin e ndikimit të politikave fiskale të përqendruara tek fëmijët. Ai fillon me një përshkrim të ministrive dhe të organeve të tjera publike mandati i të cilave trajton ose plotësisht ose pjesërisht çështje dhe shpenzime të lidhura me politikat e lidhura me fëmijët. Ministrinë dhe sektorët e analizuar për qëllim të këtij studimi, përfshijnë ministrinë e mëposhtme me shpenzimet e lidhura me çështje që kanë të bëjnë me fëmijët:

• **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është ministria përgjegjëse kryesore për koordinimin dhe zbatimin e objektivave të përgjithshme të zhvillimit të qeverisë. Kjo ministri drejton programin e mbrojtjes sociale, i cili përfshin programin e përfitimeve për uljen e varfërisë (ndihmën ekonomike); si dhe programin e përfitimit për paaftësinë, i cili përbën një përfitim kategorik. Shërbimet e kujdesit shëndetësor janë po ashtu pjesë e programeve të mbrojtjes sociale, përfshirë shërbimet rezidenciale dhe të kujdesit të shërbimeve ditore për kategori të ndryshme përfituesish. Pjesa më e madhe e këtyre shërbimeve menaxhohen dhe/ose ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore, por Ministria e Mirëqenies Sociale është përgjegjëse si për politikat dhe për financimin e pjesës më të madhe të këtyre shërbimeve.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve nën MMSR-në është një institucion koordinues përgjegjës për monitorin dhe sigurimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve. Programet buxhetore nën MMSR-në që janë më të përshtatshme për fëmijët janë programi i mbrojtjes sociale dhe programi i përfshirjes sociale. Programet e tjera të MMSR-së nuk janë analizuar në detaje në këtë raport. Ato përfshijnë programin e sigurimeve shoqërore, i cili ofron pensionet dhe përfitime shtesë. Programi i sigurimeve shoqërore i ofruar nëpërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISS) ofron përfitime për nënën në formën e lejes së lindjes për gratë kontribuese. Punësimi dhe programet e AFP-së nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me të drejtat e fëmijëve, për shkak se ato i drejtohen popullsisë së rritur. Megjithatë, në mënyrë të tërthortë këto përfitime mund të jenë kontribuese për mirëqenien e përgjithshme të familjeve (si nëpërmjet masave aktive dhe atyre pasive të tregut të punës).

• **Ministria e Arsimit dhe e Sportit**

Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS) është përgjegjëse për politikat e arsimit dhe ofrimin e shërbimeve arsimore në vend. Njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë e mirëmbajtjes së shkollave dhe përmirësimeve kapitale në sistemin shkollor para-

universitar, ndërsa Ministria e Arsimit është përgjegjëse për menaxhimin e përmbajtjes së procesit arsimor, përfshirë kurrikulën dhe mësuesit. Studimi ka analizuar programet e arsimit fillor dhe të mesëm ku janë të regjistruar fëmijët e moshës 3-18 vjeç. Arsimi i lartë nuk është objekt studimi. Programi i arsimit të mesëm profesional është transferuar nën përgjegjësinë e MMSR-së duke filluar nga viti buxhetor 2015, por është analizuar si pjesë e sektorit të arsimit në këtë program.

• **Ministria e Shëndetësisë**

Ministria e Shëndetësisë (MSh) është përgjegjëse për politikat shëndetësore dhe financon një pjesë të madhe të shpenzimeve publike në sektorin shëndetësor. Shpenzimet janë bashkëfinancuar nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore (ISSH), një skemë e detyrueshme e sigurimeve shëndetësore për popullsinë aktive. Programet më të rëndësishme në sektorin e shëndetësisë janë kujdesi parësor shëndetësor dhe shërbimet e kujdesit publik shëndetësor, të cilat prekin pjesën më të madhe të popullsisë. Fëmijët përdorin edhe shërbimet dytësore të kujdesit shëndetësor, por zakonisht në nivele më të ulëta. Këto shërbime nuk janë përfshirë në studim për shkak të vështirësisë për të marrë të dhëna lidhur me numrin e fëmijëve që i përfitojnë këto shërbime.

• **Ministria e Drejtësisë**


Ministria e Drejtësisë kontrollon masat e drejtësisë për të miturit, përfshirë dhe shërbimin e provës dhe objektet e korrektimit për të miturit autorë veprash penale. Institucione të tjera të përfshira në trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin përfshijnë policinë, zyrën e prokurorisë, dhe gjyqësorin. Ministria e Drejtësisë kontrollon Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe të Shërbimit të Provës.

Analizë e shkurtër e buxhetit të sektorit

Përqindja ndaj PBB-së dhe shpenzimeve të përgjithshme publike

Kjo analizë ka shqyrtuar të dhënat e buxhetit nga katër sektorë të ndryshëm: arsimi, shëndeti, politikat sociale dhe mbrojtja sociale, si dhe drejtësinë për të miturit, duke u mbështetur në të katër shtyllat e Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve 2012 – 2015. Buxheti i sektorit ka arritur në 75 miliardë lek në vitin 2014 (535 milionë euro), duke shënuar një rritje prej 16.7% krahasuar me buxhetin e sektorit për vitin 2012. Përqindja e buxhetit të sektorit në PBB është rritur nga 4.8% në vitin 2012, në 5.3% në vitin 2014. Pësia relative e sektorit pritet të mbetet në nivele të qëndrueshme (5.1% e PBB-së deri në vitin 2017). Pësia e sektorit në shpenzimet e përgjithshme publike është ulur lehtë në periudhën nga viti 2012 deri në 2014, pasi shpenzimet e sektorit janë rritur me ritëm më të ulët sesa buxheti i përgjithshëm. Sipas PBA-së 2015 – 2017, shpenzimet e sektorit do të mbulojnë rreth 18% të totalit të buxhetit në vitin 2017.

Figura 11: Përqindja e shpenzimeve për sektorët e lidhur me fëmijët në PBB dhe shpenzimet e përgjithshme publike



Burimi: Ministria e Financave, ministritë e linjës, PBAM 2015 - 2017

Përbërja e shpenzimeve të sektorit

Sektori i buxhetit dominohet nga shpenzimet për arsim, të cilat zënë rreth 44% të buxhetit të përgjithshëm për vitin financiar 2013 – 2014 dhe janë parashikuar të qëndrojnë në nivele të ngjashme në periudhën afatmesme. Programi i dytë më i madh buxhetor është mbrojtja sociale me një peshë relative prej 32-33% në buxhetin e përgjithshëm në vitin financiar 2012, 2013 (realizimi) dhe në vitin 2014 (buxheti i rishikuar). Megjithatë, përqindja e sektorit të mbrojtjes sociale pritet të rritet si në terma nominalë dhe si përqindje e totalit të shpenzimeve të sektorit në periudhën 2015 – 2017; me rreth 26% në periudhën 2015 – 2017. Madhësia e shpenzimeve

Tabela 10: Përbërja e shpenzimeve të sektorit sipas programeve, 2012 – 2014 dhe PBAM 2015-2017


	VF 2012	VF 2013	VF 2014	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Përfshirja sociale	23	139	36	34	34	35
Mbrojtja sociale	20,705	23,647	24,703	21,741	21,768	22,970
Kujdesi shëndetësor publik	2,443	2,489	2,584	2,755	3,104	3,282
Kujdesi shëndetësor parësor	9,980	9,700	9,305	19,003	19,272	20,225
Arsimi bazë	23,707	23,603	24,950	24,948	26,100	27,125
Arsimi i mesëm	5,158	5,494	6,398	6,899	6,705	7,161
Arsimi profesional	2,255	2,360	2,193	2,757	2,943	3,079
Sistemi i burgjeve**	-	3,715	4,703	4,376	3,999	3,999
Shërbimi i provës *	-	101	106	166	176	176
Totali	64,271	71,248	74,978	82,678	84,102	88,052

* Të dhënat për 2012-ën nuk janë të disponueshme.

Burimi: Ministria e Financave, ministritë e linjës

në sektorin shëndetësor pritet të rritet ndjeshëm si në terma nominalë dhe në peshë relative: shpenzimet në kujdesin shëndetësor parësor do të mbulojnë afërsisht 23% të totalit të shpenzimeve në periudhën 2015 – 2017, pas tendencës në ulje që ka pësuar në vitet e fundit.

Figura 12: Përbërja e buxhetit të sektorit sipas programeve, 2012 – 2017



Burimi: Ministria e Financave, ministritë e linjës

Përqindja e shpenzimeve për fëmijët

Vlerësimi i përqindjes së shpenzimeve për fëmijët në shpenzimet e përgjithshme kërkon mbledhjen e të dhënave nga sektorë të ndryshëm. Në fillim të punës janë bërë disa prezumime. Programet e përfshira në analizë, përfshijnë vetëm programe që prekin drejtpërdrejt fëmijët, ose që u shkojnë familjeve po ashtu për shkak të fëmijëve që ato kanë. Disa programe ua dedikojnë të gjitha burimet fëmijëve, ndërsa programe të tjera ua japin fondet si fëmijëve dhe të rriturve. Duke vlerësuar përqindjet e programeve që u shkojnë specifikisht fëmijëve është mbështetur në metodat e mëposhtme:

- Për programet që u shërbejnë vetëm fëmijëve, ne presupozojmë se 100 përqind të shpenzimeve të programit (përfitime dhe kosto të lidhura administrative) u shkojnë fëmijëve. Këtu përfshihen programet e arsimit bazë dhe të mesëm.
- Për programet që u ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta fëmijëve dhe të rriturve), ne përlllogarisim përqindjen e shpenzimeve të programit që shkojnë për fëmijët. Këtu përfshihen programet e kujdesit shëndetësor dhe të shëndetit publik. Për shkak se nuk kemi të dhëna të detajuara për përdorimin e shërbimeve nga fëmijët krahasuar me të rriturit, u kemi dhënë fëmijëve një përqindje të shpenzimeve të përgjithshme që është e barabartë me peshën e fëmijëve në popullsinë e përgjithshme (mesatarisht 30%).
- Për programet që u ofrojnë përfitime familjeve me fëmijë;
- Për programe të tjera ku u ofrohen përfitime familjeve pa detaje për

përqindjen e prindërve dhe të fëmijëve, ne përgjithësisht llogarisim përqindjen e fëmijëve mbështetur në numrin e fëmijëve dhe të të rriturve në familje dhe duke prezumuar përfitime të barabarta për frymë brenda familjes (p.sh., TANF, SNAP, strehimi).

Ne i kemi kushtuar përpjekje të posaçme vlerësimit të përqindjeve të programeve të mëdha, të tilla si SNAP, Medicaid, ose SSI, të cilat u dedikohen vetëm fëmijëve. Për këto përllogaritje, burimet më shpesh të përdorura të të dhënave janë tabulatet e pabotuara të të të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative të mbledhura nga autorët, ose nga kërkues të tjerë në Institutin Urban (përfshirë tabulatet e gjeneruara nga Modeli i Transferimit të të Dhënave) dhe raportet nga agjencitë që administrojnë programet. Ndonjëherë kemi kërkuar në faqet e internetit të qeverisë, ose kemi kontaktuar drejtpërdrejt me stafin e agjencisë federale për të marrë informacionin lidhur me pjesëmarrjen në program. Informacion i mëtejshëm jepet në shtojcën për të dhënat.

Tabela 11. Shpenzimet për fëmijët në të katër sektorët 2012 - 2017

	VF 2012	VF 2013	VF 2014	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Përfshirja sociale	23	139	36	34	34	35
Mbrojtja sociale	2,878	3,345	2,141	3,342	3,390	3,553
Kujdesi shëndetësor publik	733	747	775	826	931	985
Kujdesi shëndetësor parësor	2,994	2,910	2,792	5,701	5,782	6,068
Arsimi bazë	23,707	23,603	24,950	24,948	26,100	27,125
Arsimi i mesëm	5,158	5,494	6,398	6,899	6,705	7,161
Arsimi profesional	2,255	2,360	2,193	2,757	2,943	3,079
Sistemi i burgjeve**	-	68.35	86.54	80.53	73.59	73.59
Shërbimi i provës *	-	4.41	4.62	7.23	7.66	7.66
Totali	37,748	38,670	39,375	44,595	45,966	48,086
Përqindja e fëmijëve në sektor	58.7%	54.3%	52.5%	53.9%	54.7%	54.6%


* Të dhënat për 2012-ën nuk janë të disponueshme.

Burimi: Ministria e Financave, PBAM 2015 - 2017, ministritë e linjës

Tabela 11 jep përqindjen e shpenzimeve të drejtpërdrejta për fëmijët në programet e përgjithshme buxhetore që janë përfshirë në analizë. Kjo tregon që shpenzimi për fëmijët po rritet në terma nominalë. Janë shpenzuar mesatarisht 2% më shumë fonde për fëmijët në programet përkatëse buxhetore. Gjithsesi, përqindja e përgjithshme e shpenzimeve për fëmijët në programet e përgjithshme të buxhetit ka rënë nga 58.7% në vitin 2012, në 52.5% në vitin 2014. Pësia e shpenzimeve të drejtpërdrejta për fëmijët është parashikuar të rritet sërish duke filluar nga viti 2015. Pësia e shpenzimeve të fëmijëve në programet e përzgjedhura buxhetore parashikohet të jetë rreth 54.6% në vitin 2017, ende në nivele më të ulëta sesa në vitin 2012.

Pësia e shpenzimeve për fëmijët në raport me PBB-në do të ulet nga përkatësisht 2.8% dhe 3% në vitin 2014 dhe 2015 sërish në 2.8% të PBB-së deri në vitin 2017 pavarësisht rritjes në terma nominalë, duke qenë që PBB-ja parashikohet të rritet me ritëm më të shpejtë sesa shpenzimet për fëmijët.

Figura 13. Përqindja e PBB-së dhe shpenzimeve buxhetore të shpenzimeve direkt për fëmijët në programe të përzgjedhura buxhetore




Shpenzimet për arsimin për fëmijët

Shpenzimet publike për arsimin, në rreth 2.8% të PBB-së janë të ulëta krahasuar me vendet e rajonit dhe ato fqinje. Në krahasim, vende të tjera në rajon, të tilla si Serbia dhe Kroacia shpenzojnë mesatarisht 5-6% të PBB-së për arsimin¹¹, dhe vendet e OECD-së shpenzojnë mesatarisht 6.3% të PBB-së. Nivelet aktuale të shpenzimeve janë goxha nën objektivin prej 5% të PBB-së të përcaktuar në programin aktual të qeverisë. Shpenzimet e Shqipërisë për arsimin si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë kanë rënë nga 11.3% në vitin 2005, në 10.3% në vitin 2012 dhe 8.5% në vitin 2015.

Financimi për sektorin arsimor është rritur në terma nominalë, por përqindja e PBB-së do të vijojë modelin në rënie deri në fund të 2017-ës. Shpenzimet për arsimin si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore do të rriten lehtë nga niveli 8.5% i planifikuar në vitin 2015 në 9.7% në vitin 2017.

11. Banka Botërore, <http://databank.worldbank.org/data/views/reports/tableview.aspx>, të dhëna nga Serbia (2011) dhe Kroacia (2010). Të dhëna nga shtetet e OECD-së: Arsimi në një vështrim (Education at a Glance), 2013.

Figura 14: Shpenzimet e arsimit si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore dhe e PBB-së 2012 - 2017

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministria e Financave

Tabela 12: Shpenzimet në arsim sipas programit: 2012 dhe 2013 (aktuale), 2014 – 2017 (buxheti)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Totali¹²	38,905,135	42,490,733	40,118,801	40,578,473	43,480,832	46,406,357
Shërbimet e përgjithshme publike	769,574	672,450.40	787,500	805,730	844,182	887,783
Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	23,707,160	23,602,617	24,950,000	24,947,628	26,099,988	27,124,524
Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	5,158,339	5,493,546	6,398,188	6,899,263	6,705,420	7,160,944
Arsimi i mesëm (profesional)	2,552,423	2,288,681	2,369,613	1,951,262	2,943,312	3,079,135
Arsimi i lartë	6,250,519	10,019,540	5,436,500	5,797,590	6,587,930	7,793,971
Kërkimi dhe shkenca	467,120	413,899	177,000	177,000	300,000	360,000

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Pjesa më e madhe e burimeve publike të investuara në arsim i janë dhënë arsimit fillor, në përputhje me objektivat për regjistrimin parësor universal. Arsimi i mesëm ka marrë rreth 20% të shpenzimeve publike. Më shumë se tre të katërtat e burimeve janë dhënë për arsimin e mesëm të përgjithshëm; ndërsa përqindja e shpenzimeve për arsimin profesional ka rënë në periudhën nga viti 2012 deri në 2015 dhe pritet të rritet sërish në fillim të vitit 2016. Programet e arsimit të lartë, të shkencës dhe kërkimit zënë përafërsisht 14% të shpenzimeve të përgjithshme për arsimin në vitin 2014.

12. Përgjegjësia për arsimin profesional i është kaluar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në fillim të vitit buxhetor 2015. Buxheti për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve përfshin dhe programin "për zhvillimin e sporteve", i cili nuk përfshihet në këtë analizë.

Tabela 13: Përqindja e shpenzimeve sipas programit dhe vitit

	Aktual			Buxhetor		
	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Shërbimet e përgjithshme publike	2.0%	1.6%	2.0%	2.0%	1.9%	1.9%
Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)	60.9%	55.5%	62.2%	61.5%	60.0%	58.5%
Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)	13.3%	12.9%	15.9%	17.0%	15.4%	15.4%
Arsimi i mesëm (profesional)	6.6%	5.4%	5.9%	4.8%	6.8%	6.6%
Arsimi i lartë	16.1%	23.6%	13.6%	14.3%	15.2%	16.8%
Kërkimi dhe shkenca	1.2%	1.0%	0.4%	0.4%	0.7%	0.8%

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Pagat e mësuesve konsumojnë një përqindje të lartë të shpenzimeve të përgjithshme publike në të tri programet në këtë analizë, duke zvogëluar shpenzimet në zërat jo të lidhura me pagat, të cilët mund të cenojnë cilësinë e mësimdhënies. Ky problem është më shumë akut në arsimin bazë, ku vetëm 4 përqind e shpenzimeve aktuale janë në dispozicion të zërave jo buxhetorë për vitin 2015. Ky raport ka mbetur i qëndrueshëm përgjatë viteve të fundit për të tri programet¹³.

Tabela 14: Ndarjet ekonomike për shpenzimet e arsimit publik në tri programet kryesore (në %, buxheti i 2015-ës)

	% e shpenzimeve korrente	% e shpenzimeve kapitale	Pagat si % të shpen. korrente	Shpen. të tjera korrente si %
Parashkollori dhe arsimi bazë	94.6%	5.4%	96.0%	4.0%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	89.3%	10.7%	95.2%	4.8%
Arsimi i mesëm profesional	68%	32%	83%	17%

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve

Arsimi bazë

Programi bazë në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit është programi bazë i arsimit, i cili përfshin programin parashkollor (kopsht dhe klasa 0 për fëmijët e moshës 5-6 vjeç) dhe programin e arsimit fillor (klasa 1-9). Shpenzimet për arsimin fillor janë relativisht të larta në më shumë se 60% e buxhetit të përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit. Njësitë e qeverisjes vendore kanë po ashtu përgjegjësinë e mirëmbajtjes së godinave të shkollës. Shpenzimet për arsimin nga autoritetet e qeverive vendore nuk reflektohen në këtë raport.

Shpenzimet në arsimin bazë dominohen nga pagat e mësuesve, të cilat zënë rreth 96% të totalit të shpenzimeve korrente në arsimin bazë. Shpenzimet për zërat e ndryshme nga pagat janë shumë të kufizuara dhe mund të kenë ndikim mbi cilësinë e mësimdhënies.

13. Ju lutem vini re se përgjegjësia kryesore për mirëmbajtjen e godinave të arsimit në sistemin e arsimit parashkollor u përket njësitë të qeverive vendore. Për pasojë, shpenzimet rikorrente jo për pagat nën programin buxhetor të MAS-it janë kryesisht shpenzime për material arsimor dhe për transferime të tjera.

Tabela 15: Shpenzimet në arsimin bazë/klasifikimi ekonomik

Zëri	2012		2013		2014	2015
	Buxheti	realizimi (në cash)	Buxheti	realizimi (në cash)	Buxheti	Buxheti
Pagat & Sigurimet	21,092,866	21,045,656	21,719,027	21,440,423	22,240,000	22,642,920
Shpenzimet operative	518,351	512,514	636,057	623,559	670,000	704,000
Transferrat tek familjet dhe individët	300,467	300,098	283,545	277,289	240,000	246,000
<i>Shpenzimet korrente</i>	21,911,684	21,858,268	22,638,772	22,341,413	23,150,000	23,592,920
Shpenzimet kapitale	2,075,341	1,976,687	1,293,091	1,245,335	1,800,000	1,354,708
TOTALI	23,987,025	23,834,955	23,931,863	23,586,748	24,950,000	24,947,628

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sporteve

Shpenzimet për arsimin bazë janë rritur me 3% në vitin 2014 krahasuar me vitin 2012. Në buxhetin për vitin 2015 planifikohet një ulje shumë e vogël në totalin e burimeve që i jepen këtij programi. Megjithatë, buxheti pritet të rritet mesatarisht me 4% në vitin 2016 dhe vitin 2017.

Shpenzimet kapitale në arsimin bazë mbeten ende në nivele shumë modeste, me përfaqësimin 5% të totalit të shpenzimeve. Raporti është ulur më tej në buxhetin për vitin 2015, ku parashikohet një ulje me 30% të investimeve kapitale për këtë program (1.3 miliardë lek në vitin 2015 krahasuar me 1,8 miliardë në vitin 2014). Viti financiar 2013 ishte viti i fundit i zbatimit të projektit të mbështetur nga Banka Botërore “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, i cili i kishte drejtuar pjesën më të madhe të burimeve të tij për përmirësime kapitale për godinat e shkollave. Megjithatë, programi buxhetor afatmesëm ka parashikuar një rritje domethënëse për arsimin bazë në vitin 2016 dhe 2017, me përkatësisht 2,87 dhe 3,66 miliardë lek, të cilat do të financohen pjesërisht nëpërmjet financimeve të huaja. Përmirësimi i kushteve fizike të godinave të shkollave përbën përparësi në kuadrin afatmesëm dhe afatgjatë, pasi mungesa e investimeve mund të nënkuptojë klasa më të mëdha, më shumë përdorim të dy turneve dhe masa të tjera eficiente në nivelin arsimor.

Në vitin 2013 kishte mesatarisht 356,347 nxënës të regjistruar në arsimin bazë dhe 76,416 fëmijë që ndiqnin arsimin parashkollor. Shpenzimet për arsimin parashkollor llogariten në mesatarisht 17% e shpenzimeve të përgjithshme në programin e arsimit bazë, çka dëshmon se kostot për njësi arsimit janë të ngjashme. Mesatarisht Qeveria e Shqipërisë shpenzon 51,625 lek shqiptare (510 dollarë amerikanë) për shpenzimet e lidhura me shërbimin e arsimit për fëmijët dhe nxënësit e regjistruar në programin e arsimit bazë (shifrat për 2013-ën). Shpenzimet për nxënës në vitin 2012 ishin mesatarisht 5% më të ulëta, në nivelin e 490 dollarëve amerikanë. Kjo shifër është shumë e ulët krahasuar me mesataren e vendeve të OECD-së, në përfaqësimin 7,974 dollarë amerikanë për nxënës fillor. Megjithatë, shpenzimet për arsimin për nxënës ndikohen nga disa faktorë, përfshirë pagat e mësuesve; numrin e nxënësve të regjistruar, raportin mësues/nxënës, etj. Nivelet e regjistrimit në arsimin bazë janë afër vlerave universale, ndërsa Ministria e Arsimit ka për qëllim të rrisë nivelin e regjistrimit për fëmijët e grupmoshës 3-5 vjeç.

Arsimi i mesëm

Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për arsimin e mesëm të përgjithshëm. Duke filluar që prej vitit 2015, përgjegjësia për arsimin e mesëm profesional i është transferuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të siguruar orientim më të mirë drejt tregut të punës.

Shpenzimet për arsimin e mesëm arrijnë në 8,8 miliardë lek në vitin 2015, duke shënuar një rritje prej 16% krahasuar me vitin 2012. Rritja shtyhet kryesisht nga një rritje e shpenzimeve në arsimin e mesëm të përgjithshëm: buxheti për vitin 2015 planifikohet në 6,9 miliardë lek, ose 25% më i lartë sesa në vitin 2012 (5.5 miliardë).

Tabela 16: Shpenzimet për arsimin e mesëm/klasifikimi ekonomik

	2012	2013	2014	2015
Arsimi i mesëm	5,518,857	5,493,537	6,398,188	6,899,263
Pagat	4,596,862	4,798,528	5,005,000	5,865,805
Shpenzimet operative	55,631	116,382	156,450	230,166
Transfertat tek familjet dhe individët	96,638	82,475	65,000	66,000
Shpenzimet kapitale	764,046	490,512	1,171,738	737,292
Arsimi i mesëm profesional	2,123,442	2,274,216	2,269,613	1,951,262
Pagat	1,630,946	1,707,099	1,800,000	1,095,570
Shpenzimet operative	205,639	213,537	270,000	220,000
Transfertat tek familjet dhe individët	5,229	8,590	6,000	8,000
Shpenzimet kapitale	281,628	344,949	193,613	627,692
Totali i shkollës së mesme	7,642,299	7,767,754	8,667,801	8,850,525

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Nivelet e regjistrimit në arsimin e mesëm janë relativisht të larta dhe në përmirësim: në vitin 2013 92% e nxënësve që mbaronin arsimin bazë regjistroheshin në shkollat e mesme. Shpenzimet mesatare të Qeverisë së Shqipërisë për shërbime të lidhura me arsimin në arsimin e mesëm të përgjithshëm (përfshirë investimet kapitale) ishin 45,037 në vitin 2013 (410 dollarë amerikanë). Kjo shumë është 20% më e vogël se shpenzimet për fëmijët në arsimin fillor dhe mund të jetë tregues për nënfinancimin e arsimit të mesëm. Në vendet e OECD-së niveli i shpenzimeve për nxënësit rritet në çdo nivel, me shpenzime mesatare për nxënësit e shkollave të mesme në 9,014 dollarë amerikanë ose 13% më të larta se shpenzimi për arsimin bazë.

Shpenzimet për fëmijë në arsimin profesional janë më të larta për shkak të kostove më të larta të lidhura me programin. Në të vërtetë, kostot e ndryshme nga pagat në arsimin e mesëm profesional shkojnë në 17% të shpenzimeve korrente. Mesatarisht ka pasur rreth 25,837 nxënës që kanë ndjekur shkollat e mesme profesionale në Shqipëri në vitin 2014. Kostoja mesatare e arsimimit për nxënës në shkollat profesionale ka qenë 80,350 lek shqiptare në vitin 2014 (730 dollarë amerikanë). Qeveria është angazhuar për përmirësimin e cilësisë së kurrikulave, nivelit të mësimdhënies dhe të regjistrimit në shkollat e arsimit profesional për të arritur një lidhje më të mirë me tregjet e punës, por pa planifikuar për rritje domethënëse në shpërndarjen e burimeve për këtë program.

Barazia në arsim

Ministria e Arsimit dhe Sportit menaxhon shumë masa që synojnë sigurimin e arsimit përfshirës. Masat në programet e arsimit bazë dhe të mesëm përfshijnë shpenzimet për:

- o Kompensimin e kostove për tekstet shkollore për nxënësit nga familjet e varfra dhe/ose nxënësve nga komuniteti rom në arsimin bazë dhe të mesëm;
- o Shërbimet e transportit për nxënësit dhe mësuesit në zonat rurale;
- o Bursa për nxënësit në nevojë, veçanërisht në arsimin profesional;
- o Kosto të lidhura me projektin e “shkollave në komunitet”, përfshirë trajnimin e psikologëve të shkollës dhe punonjësit socialë për arsimin përfshirës, trajnimin e mësuesve për nxënësit me nevoja të posaçme, etj.

Ministria mbështet po ashtu dhe masa të ngjashme (p.sh. bursa) për arsimin e lartë dhe kërkimin. Këto shpenzime nuk janë përshkruar në detaje për shkak se numri i studentëve në arsimin e lartë është rritur. Më poshtë jepen shpenzimet që synojnë të arrijnë barazi në arsim. Pjesa më e madhe e shpenzimeve përbëhet nga shpenzimet në programet e arsimit bazë. MAS-i mbështet transportin në shkollë për mbi 30 mijë nxënës në arsimin bazë (ose afro 9% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar) dhe mbi 11 mijë mësues për të shkuar në shkolla në zonat rurale.

Programi i kompensimit të teksteve shkollore shtrihet në të tria programet, por financimi është ulur krahasuar me nivelet e 2012-ës.

Tabela 17: Produktet në përfshirjen sociale në arsim (MAS)

	Aktuale			Buxheti		
	VF 2012	VF 2013	VF 2014	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Arsimi bazë						
Shërbimi i transportit për nxënësit dhe mësuesit	393,803	523,000	560,000	580,000	600,000	640,000
Kompensimi për tekstet shkollore	300,098	277,289	246,000	252,000	256,000	270,000
Shërbimi i arsimit për nxënësit me nevoja të posaçme		118,374	113,113	119,400	125,760	133,400
Shkolla në komunitet /trajnimet e punonjësve socialë	2,400		4,800	6,000	7,000	8,000
Arsimi i mesëm						
Kompensimi i teksteve shkollore	96,638	82,475	65,000	66,000	66,000	66,000
Arsimi profesional						
Bursa për nxënësit në nevojë	143,700	113,719	160,000	180,000	186,000	205,000
Tekstet shkollore dhe transporti			22,634	29,720	32,970	37,020
Totali	936,639	1,114,857	1,171,547	1,233,120	1,273,730	1,359,420

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Shpenzimet shëndetësore për fëmijët


Totali i shpenzimeve në sektorin e shëndetësisë për buxhetin e 2015-ës arrin në 41.23 miliardë lek. Buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë është 32,4 miliardë lek në vitin 2015, ose 1.6 miliardë lek më i lartë se në vitin 2014; ndërsa kontributet për skemën e detyrueshme të sigurimeve shëndetësore janë parashikuar të rriten me 500 milionë lek në vitin 2015 (8.8 miliardë lek në vitin 2014). Tabela më poshtë tregon nivelet e parashikuara të shpenzimeve në sektorin e shëndetësisë dhe përqindjen e tyre në shpenzimin e përgjithshëm qeveritar dhe në PBB.

Tabela 18: Financimi për MSH-në dhe të ardhurat nga sigurimet shoqërore në buxhetin e 2015-ës dhe buxhetin e rishikuar të 2014-ës

	B 2015	RB 2014	PB15 - BR14
Ministria e Shëndetësisë	32,430,542	30,816,020	1,614,522
Të ardhura nga HII	8,800,750	8,319,000	481,750
Totali i financimit të sektorit shëndetësor	41,231,292	39,135,020	2,096,272
Në % të totalit të shpenzimeve buxhetore	8.7%	8.6%	
Në % të PBB-së	2.76%	2.77%	

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave

Figura 15: Buxheti i MSH-së sipas zërave kryesorë dhe përqindja e tij në PBB dhe në shpenzimet e përgjithshme të buxhetit



Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave

Ndërmjet pesë programeve të Ministrisë së Shëndetësisë, programet që i janë nënshtruar rritjes më të konsiderueshme janë “kujdesi shëndetësor parësor” dhe “kujdesi shëndetësor dytësor”. Fondet për kujdesin shëndetësor parësor janë rritur me 916 milionë lek, ose 9.9% më shumë sesa buxheti i rishikuar i 2014-ës. Financimi për programin e “kujdesit shëndetësor dytësor” është rritur me 927 milionë lek, ose 5% më shumë se në vitin 2014. Programi i “kujdesit shëndetësor publik” është rritur lehtë në vitin 2015 krahasuar me 2014, ndërsa për herë të parë është krijuar programi i “Shërbimit të Emergjencës Kombëtare” në Ministrinë e Shëndetësisë, duke arritur në 120 milionë lek për vitin 2015.

Buxheti i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë është rritur, megjithatë shpenzimet kapitale në sektor janë tkurrur me 14% (307 milionë lek) krahasuar me buxhetin e

rishikuar të 2014-ës. Uljet më domethënëse në shpenzimet kapitale janë në programet e kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor.

Tabela 19: Përbërja e shpenzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë sipas programit dhe zërave kryesore 2014 - 2015

	2015			2014		
	Shpenzimet korrente	Shpenzimet kapitale	Totali	Shpenzimet korrente	Shpenzimet kapitale	Totali
Ministria e Shëndetësisë	30,550,900	1,879,642	32,430,542	28,629,500	2,186,520	30,816,020
Shërbimet e Përgjithshme Publike	224,000	13,210	237,210	226,500	3,500	230,000
Kujdesi Shëndetësor Parësor	9,932,000	240,172	10,172,172	9,003,500	252,108	9,255,608
Kujdesi shëndetësor dytësor	17,667,800	1,495,260	19,163,060	16,880,500	1,900,912	18,781,412
Shërbimet e kujdesit shëndetësor	2,696,900	41,000	2,737,900	2,519,000	30,000	2,549,000
Shërbimi kombëtar i emergjencave	30,200	90,000	120,200			

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Kujdesi shëndetësor parësor

Programi që i prek më shumë fëmijët është kujdesi shëndetësor parësor, i cili mbulon godinat e kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin dhe shërbimin e mjekut të familjes. Shërbimet e kujdesit shëndetësor në Shqipëri bashkëfinancohen nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore (ISSH), i cili është një fond për sigurimet shëndetësore që mbledh kontribute nga e gjithë popullsia aktive dhe Ministria e Shëndetësisë. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen pa pagesë për disa kategori të popullsisë, përfshirë përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, veteranët e luftës, fëmijët e moshës 0-1 vjeç dhe jetimët, si dhe njerëzit me kushte specifike mjekësore. Fëmijët më të mëdhenj se 1 vjeç dhe gratë shtatzëna ose me leje lindje pranohen në sistemin e kujdesit shëndetësor me bashkëpagesë (sigurim shëndetësor).

Objektivat kryesore të kujdesit shëndetësor parësor lidhen me menaxhimin dhe shtrirjen e grupit të medikamenteve me rimbursim (aktualisht ka mbi 420 lloje të ndryshme medikamentesh që rimbursohen ose plotësisht ose pjesërisht nga Instituti i Sigurimeve Shëndetësore). Për më tepër, programi i kujdesit shëndetësor parësor ka për qëllim të ulë nivelet e vdekjes së foshnjave dhe të nënave, të cilët në nivelin 19/100 mijë në vitin 2012 janë relativisht të larta krahasuar me mesataren e 16/100,000 në vendet e zhvilluara (OBT).

Vizitat ambulatorie në kujdesin shëndetësor parësor janë ende të ulëta në nivelin e 10-11 vizitave në ditë/doktor, çfarë dëshmon për ulje të efikasitetit të shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor si dhe rritje të ngarkesës në vizitat e kujdesit shëndetësor dytësor paralelisht me rritjen e kostove për familjet. Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e mjekëve të përgjithshëm të familjeve sipas rajoneve dhe llojit të kompetencës në vitin 2014: në Shqipëri në vitin 2014 numëroheshin 1,592 mjekë të përgjithshëm, me 214 mjekë të specializuar për mjekë të përgjithshëm për fëmijë. Shpërndarja e mjekëve të përgjithshëm ndryshon sipas rajoneve në përputhje me popullsinë ku qarku i Tiranës ka numrin më të madh të mjekëve. Qarku i Tropojës duket se është i mbuluar me shërbimin e mjekëve të përgjithshëm, së bashku me disa komuna në zonat e largëta të Kukësit. Numri i stafit mbështetës mjekësor ishte 1,794. Ka pasur rreth 109 mjekë

të specializuar në shërbimet e kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe nënat (në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor për fëmijët dhe kujdesin e nënës), nga të cilët 67 ishin specialistë fëmijësh.


Tabela 20: Shpërndarja e mjekëve të përgjithshëm sipas rajoneve në vitin 2014

Nr.	DRSKSH	GP1 Fëmijët	GP2 Të rriturit	GP3 Të gjitha moshat/urbane	GP4 Të gjitha moshat/rurale	Total
1	Berat	15	29	2	46	92
2	Dibër	2	5	15	35	57
3	Durrës	30	64	20	87	201
4	Elbasan	16	42	19	88	165
5	Fier	18	34	23	97	172
6	Gjirokastër	2	4	15	33	54
7	Korçë	11	38	9	73	131
8	Kukës	0	0	13	31	44
9	Lezhë	10	19	13	42	84
10	Shkodër	16	28	11	63	118
11	Tiranë	71	171	20	90	352
12	Vlorë	19	30	12	33	94
13	Sarandë	4	5	5	14	28
14	Tropojë	0	0	0	0	0
	Totali	214	469	177	732	1,592

Burimi: Instituti i Sigurimeve Shëndetësore

Numri i vizitave në kujdesin shëndetësor parësor është i ulët, por në rritje: numri i vizitave në vitin 2013 ishte 8.6% më i lartë se vitet më parë. Pjesa më e madhe e vizitave janë kryer në qendrat urbane (68%).

Figura 16: Vizitat e realizuara në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor 2008 – 2013



Burimi: Raporti Vjetor i Institutit të Sigurimeve Shëndetësore 2013

Shpenzimet në programin e kujdesit shëndetësor parësor kanë shkuar në 34% të totalit të shpenzimeve të MSH-së në vitin 2013. Kjo përqindje është relativisht e vogël po të kemi parasysh objektivin e qeverisë për të shtrirë dhe për të forcuar shërbimet e

kujdesit shëndetësor parësor për të përmirësuar mbulimin dhe efincencën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.¹⁴

Shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor

Shërbimi i kujdesit shëndetësor publik mbulon programin e imunizimit për fëmijët e të gjitha moshave në Shqipëri. Mbulimi i programit të imunizimit është thuajse universal me më shumë se 99% të mbulimit të fëmijëve, duke përfshirë fëmijë nga familje më pak të avantazuara dhe/ose fëmijë nga pakicat. Shërbimi i vaksinimit ofrohet nëpërmjet shërbimit të shëndetit të kujdesit parësor dhe shpesh është pa pagesë për të gjithë fëmijët. Nuk ka të dhëna të disponueshme për raportin e fëmijëve nga familjet e varura (jo kontribuese) që marrin imunizim, duke qenë se financimi është universal. Programi i kujdesit shëndetësor publik ka po ashtu për qëllim që të parandalojë sëmundje epidemiologjike, duke monitoruar cilësinë/ndotjen e agjentëve mjedisorë si dhe realizon aktivitete ndërgjegjësimit për çështjet e lidhura me shëndetin. Shpenzimet e programit për kujdesin shëndetësor publik arritën në 2,7 miliardë lek në vitin 2015. Rreth 12% e fondeve në program harxhohen për programin e vaksinimit për rreth 240,000 fëmijë.

Mbrojtja sociale për fëmijët

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR), e cila është përgjegjëse për ndjekjen e politikave sociale dhe të punësimit të vendit ka buxhetin më të madh ndërmjet institucioneve arsimore në Shqipëri në vitet e fundit: 76,6 miliardë lek i janë dhënë MMSR-së në buxhetin për 2015-ës, krahasuar me 72,8 miliardë lek në buxhetin e rishikuar të 2014-ës. Megjithatë buxheti dominohet nga shtresat e sigurimeve sociale: 46 miliardë lek ose 62% e totalit të fondeve të MMSR-së financojnë deficitin fiskal të fondit të pensionit si dhe përfitimet shtesë të mbështetura nga qeveria.

Buxheti për mbrojtjen sociale është rritur me 10% krahasuar me buxhetin e rishikuar të 2014-ës dhe ai zë 29,5% të buxhetit të MMSR-së në vitin 2015 (22,4 miliardë lek në buxhetin e 2015-ës krahasuar me 24,7 miliardë në buxhetin e rishikuar të 2014-ës).

Mbrojtja sociale

Programi i buxhetit të mbrojtjes sociale përbëhet nga dy nën-programe kryesore: pagesat e ndihmës sociale për uljen e varfërisë; pagesat për personat me aftësi të kufizuara. Komponenti i tretë i programit përfshin aktivitete në kuadrin e shërbimeve të kujdesit shoqëror; megjithatë, pesha e tij relative për buxhetin e përgjithshëm të programit është shumë modeste. Tabela më poshtë tregon përqindjen e komponentëve kryesorë të mbrojtjes sociale përkundrejt PBB-së dhe shpenzimeve të buxhetit.

Shpenzimet për ndihmën sociale janë goxha të ulëta në më pak se 1% e PBB-së, nga niveli 1.4% i PBB-së në vitin 2012 dhe parashikohen të mbeten në nivele të njëjta

14. Të dhënat e buxhetit nuk e identifikojnë qartë numrin e fëmijëve si përqindje e përdoruesve të përgjithshëm të sistemit të kujdesit shëndetësor, kështu që nuk është e mundur të përlogaritet përqindja e kostove të fëmijëve në shpenzimet e përgjithshme të kujdesit shëndetësor.

deri në vitin 2017. Përfitimet e ndihmës sociale kanë rënë në mënyrë domethënëse në vitin 2013 krahasuar me vitet e mëparshme, pavarësisht rritjes së niveleve të varfërisë pas rënies ekonomike të viteve të fundit. Në vitin 2013 programi i ndihmës ekonomike ka mbuluar rreth 106,000 familje. Programi i ndihmës ekonomike duhet të përmirësohet, në veçanti për të shmangur gabimet e përjashtimit. Për më tepër, ndihma ekonomike nuk ka qenë shumë efiçente për nxjerrjen e njerëzve nga varfëria (Banka Botërore); pagesat shumë modeste të ndihmës ekonomike mbulojnë vetëm rreth 16% të pagesave post-transferimi për përfituesit. Shqipëria nuk ka përfitime të transferimit të *cash-it* që u drejtohen fëmijëve – programi i ndihmës ekonomike ndahet sipas familjeve dhe sasia maksimale e përfitimit për familje është 8,000 LEK, e përlogaritur për maksimumi 3200 lek për çdo prind dhe vetëm 700 lek për fëmijë në familje. Programi i ndihmës ekonomike mbështet rreth 20% të familjeve me fëmijë nën 18 vjeç – 77,444 familje nga totali prej 390 mijë familjesh që kanë fëmijë në vend; ose 85 mijë fëmijë nga 144 mijë fëmijët që jetojnë në familje të varfra.¹⁵ Struktura e ndihmës ekonomike nuk është projektuar duke pasur parasysh mirëqenien e fëmijës. Fëmijët që jetojnë në familje më të mëdha të varfra kanë më shumë të ngjarë të vuajnë nga varfëria sesa fëmijët që jetojnë në familje të vogla dhe ka instrumente të kufizuara që mund ta trajtojnë këtë çështje. Siç jepet në seksionin e parë të këtij raporti, nivelet e varfërisë kanë të ngjarë të jenë më të mëdha për familjet me më shumë fëmijë dhe me fëmijë me moshë më të re. Reformat në programin e ndihmës ekonomike janë në vijim e sipër me prezantimin e Formulës së Llogaritjes së Unifikuar që ka si synim të përmirësojë etiketimin e saktë dhe përmasat e përfitimeve në varësi të shkallës së varfërisë. Si rezultat, numri i familjeve që preken nga programi i ndihmës ekonomike është ulur ndërsa përmasa mesatare e përfitimeve të ndihmës ekonomike është rritur për familjet që e përfitojnë këtë trajtim. Megjithatë, programi i ndihmës ekonomike ka ende nevojë për rregullim për të korrigjuar gabimet domethënëse si të përfshirjes edhe të përjashtimit.

Përfitimet e paaftësisë janë shtrirë në mënyrë të qëndrueshme në kurriz të programit të ndihmës ekonomike. Në vitin 2013 ata përbënin rreth 1,4% e PBB-së; por parashikohen të ulen me rreth 1% në periudhën 2015 – 2017, në nivel të krahasueshëm me nivelin e 2012-ës. Skema e mbështetjes së paaftësisë mbulonte rreth 143,000 përfitues dhe rreth 23 mijë kujdestarë në vitin 2014 dhe është afërsisht tri here më e lartë sesa mesatarja e ndihmës ekonomike. Përfitimet e paaftësisë nuk janë mjete të testuara. Problemet e lidhura me shkuarjen e ndihmës tek personat që vërtetë kanë nevojë për të dhe mbulimi i ndihmës pritet të trajtohen shpejt me prezantimin e një sistemi të ri të përcaktimit të atyre që kanë të drejtë të përfitojnë prej këtij sistemi dhe të një sistemi MIS të ngjashëm me sistemin e ndihmës ekonomike (mbështetur nga BB-ja).

Në Shqipëri në vitin 2014 kishte rreth 17,698 fëmijë me lloje të ndryshme të paaftësisë, nga të cilët 28% (5,018 fëmijë) janë të moshës 0-5 vjeç; 48% (8,573 fëmijë) të moshës nga 6-15 vjeç dhe 23% (4,107) të moshës nga 15 deri në 18 vjeç. Më shumë se gjysma e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në zonat urbane (bashki); megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e tyre, 48% (8,479 fëmijë), jetojnë në zonat rurale. Shërbimet sociale në zonat rurale janë shumë të kufizuara, nëse jo ekzistente.

15. Niveli i varfërisë është përcaktuar në shpenzimin real për frymë në 4,891 lek për muaj me çmimet e 2002-it, shih seksionin më sipër.

Tabela 21: Përqindja e komponentëve kryesorë të mbrojtjes sociale në PBB dhe në shpenzimet publike totale

000 Lek	VF 2012	VF 2013	VF 2014*	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Ndihma ekonomike (varfëria)	5,403,604	3,842,854	5,584,018	4,700,000	4,700,000	4,900,000
Përfitimet e paaftësisë	12,659,503	18,548,394	20,597,034	15,579,400	15,579,400	16,600,000
Shërbimet e ndihmës sociale, nga të cilat	560,175	788,166	903,232	621,340	644,440	628,940
në % të PBB-së						
Ndihma sociale (varfëria)	0.41%	0.28%	0.39%	0.31%	0.29%	0.28%
Përfitimet e paaftësisë	0.95%	1.37%	1.45%	1.04%	0.97%	0.96%
Shërbimet e kujdesit social nga të cilat	0.04%	0.06%	0.06%	0.04%	0.04%	0.04%
Në % të shpenz. publike						
Ndihma sociale (varfëria)	1.4%	0.9%	1.2%	1.0%	1.0%	1.0%
Përfitimet e paaftësisë	3.4%	4.5%	4.5%	3.4%	3.2%	3.4%
Shërbimet e kujdesit sociale nga të cilat	0.1%	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%
Në % të programit të buxhetit						
Ndihma sociale (varfëria)	25%	17%	39%	22%	22%	21%
Përfitimet e paaftësisë	60%	80%	145%	72%	72%	72%
Shërbimet e kujdesit shoqëror, nga të cilat	3%	3%	6%	3%	3%	3%

* Parashikimi i mbështetur në realizim 6-mujore, 2015 – 2017 shifrat e mbështetura në PBAM 2015 - 2017

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financës


Tabela 22: Programi dhe produktet e Programit për Mbrojtjen e Buxhetit

	VF 2012	VF 2013	VF 2014/ 6 muaj	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Ndihma ekonomike (varfëria)	5,403,604	3,842,854	2,792,009	4,700,000	4,700,000	4,900,000
Përfitimet e paaftësisë, nga të cilat:	12,659,503	18,548,394	10,298,517	15,579,400	15,579,400	16,600,000
Të varfrit		5,815,326	1,584,133	2,788,250	2,788,250	2,992,762
Paraplegjikë & tetraplegjikë		4,240,229	2,251,139	2,943,728	2,943,728	3,166,914
Individë pune		5,412,114	2,003,017	2,566,093	2,566,093	2,694,929
Me paaftësi mendore		90,677	4,460,228	7,281,329	7,281,329	7,745,395
Të përndjekur politikisht	1,700,000	2,990,048	134,210			
Shërbimet e kujdesit shoqëror nga të cilat	560,175	788,166	451,616	621,340	644,440	628,940
Fëmijët me kujdes rezidencial	138,681	247,233	142,339	195,490	239,490	236,290
Të moshuarit me kujdes rez.	145,202	153,221	103,934	147,550	150,550	152,550
PËD në kujdesi rezidencial	219,323	166,989	165,972	201,000	171,000	173,000
Gratë e trafikuar në kujdes rez.	48,485	122,600	15,133	37,500	39,500	20,500
Gratë e lënduara në kujdesin rez.	8,484	98,123	9,467	16,800	18,900	20,500
Operimi i qendrës së romëve		-	14,771			
Qendra e emergjencave				23,000	25,000	26,100
Inspektimet e programit të mbrojtjes sociale	295,040	33,992	65,463	114,060	111,060	105,060
Krijimi i sistemit MIS	-	63,923	92,386	500,000	500,000	500,000

Biznesi social	70,000	na	4			
Modernizimi i ndihmës sociale		335,570				
MIS PËD			225,700	233,100	235,500	
TOTALI	21,248,497	23,277,329	14,169,771	21,740,500	21,768,000	22,969,500

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Figura 17: Përbërja e shpenzimeve të mbrojtjes sociale



Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Shpenzimet në shërbimet e kujdesit social janë shumë pak domethënëse me rreth 3% të programit të buxhetit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale. Në të vërtetë, ky nënprogram pritet të ulet më tej gjatë periudhës 2015 – 2017, si në terma nominalë dhe në përqindje të buxhetit të përgjithshëm. Kjo është pak e çuditshme duke pasur parasysh që MMSR-ja i ka deklaruar shërbimet e kujdesit social si përparësi në kuadër të strategjisë së re të mbrojtjes sociale, në përpjekje për të plotësuar ndihmën në *cash* për ata që kanë nevojë për shërbime përfshirëse. Në të vërtetë qeveria po parashikon një reformë përfshirëse në shërbimet sociale që synon të arrijë forcimin e kapaciteteve të stafit në ofrimin e shërbimeve sociale, krijimin e shërbimeve të reja si dhe një lëvizjen drejt shërbimeve të mbështetura në komunitet. Ndërkohë që strategjia është ende në përgatitje e sipër dhe nuk ka kosto të përcaktuara për shërbimet sociale, duket se një reformë e gjerë do të duhet të mbështetet nga financimi i qëndrueshëm në mbështetje të strukturave dhe të shërbimeve të reja.

Shërbimet e kujdesit social për fëmijët janë shumë të kufizuara: aktualisht ka 14 qendra të shërbimit social publik që ofrojnë shërbime për rreth 511 fëmijë në total. Pjesa më e madhe përfshin shërbimet rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror dhe/ose fëmijët me paaftësi, por ka dhe disa shërbime të kujdesit ditor. Kapaciteti i këtyre qendrave është shumë i kufizuar: numri i përgjithshëm i fëmijëve që marrin shërbime është më pak se 3% e fëmijëve me lloje të ndryshme paaftësie. Këta të fundit të gjithë përfitojnë një lloj mbështetje dhe shërbimi. Po ashtu, shërbimet ndihmëse për

fëmijët nga familjet më pak të pasura janë thuajse inekzistente. Çerdhet për fëmijët e moshës 0-3 ekzistojnë vetëm në qytete, me kapacitet të kufizuar dhe nuk ka shërbime për mbështetjen e fëmijëve në zonat rurale. Më tej, programet e përfshirjes sociale për fëmijët nga familjet më pak të pasura përqendrohen tek kompensimi i drejtpërdrejtë i shpenzimeve të lidhura me shpenzimet (p.sh. kostot e transportit dhe kompensimi i teksteve shkollore)¹⁶, ndërsa qeveria ka miratuar një instrument të ri për të siguruar që fëmijët nga familjet që trajtohen me programin e ndihmës sociale të shkojnë në shkollë dhe të marrin pjesë në programin e vaksinimit të detyrueshëm. Në kuadrin afatmesëm nuk është realiste që të pritët krijimi dhe zgjerimi i shërbimeve sociale në të gjithë vendin. Më tej, krijimi i qendrave të shërbimit social për t'u ofruar shërbime fëmijëve nga familjet e varfra ose nga pakicat mund të shoqërohet me një stigmë sociale për fëmijët pjesëmarrës, gjë e cila me shumë gjasa do të kontribuojë për përjashtim të mëtejshëm. Në të vërtetë, qeveria mund të shqyrtojë zgjerimin e shërbimeve sociale në sistemin e shkollës për të siguruar mbulim më të mirë si dhe më shumë efikasitet përsa i përket kostove të godinave dhe të mirëmbajtjes. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nisur një projekt të ri pilot për “shkollën në komunitet”, i cili përqendrohet tek disa shkolla pilote që gjenden në disa zona suburban dhe të disavantazuara. Ofrimi i shërbimeve pas shkolle për nxënësit, të tilla si programet e ushqimit dhe të bërjes së detyrave të shtëpisë ka të ngjarë të kenë rezultate të mira në rritjen e interesit të familjeve për regjistrimin e fëmijëve në shkolla si dhe për përmirësimin e rezultateve të tyre. Për më tepër, orët e zgjatura në shkollë do të kontribuonin po ashtu për mbështetjen e nevojave të fëmijëve për familjet, në mënyrë që familjet të ishin në gjendje të bëheshin pjesë e tregut të punës. E njëjta logjikë qëndron dhe për nevojën për godinat shtesë për çerdhet dhe për rritjen e kapaciteteve në të gjithë vendin. Një studim i kohëve të fundit të Bankës Botërore tregon që ka një rritje në përqindjen e popullsisë joaktive në vitet e fundit në Shqipëri: gratë e reja që largohen nga krahu i punës për t'u kujdesur për fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të popullsisë joaktive.

Tabela 23: Përputhshmëria e buxhetit për mbrojtjen sociale - buxheti k. realizimit

	Buxheti			Realizimi		
	2014	2013	2012	2014	2013	2012
Mbrojtja sociale	24,702,700	23,647,042	20,704,527	14,202,087	23,271,230	20,649,441
Kostot e stafit	475,500	484,640.00	474,884	213,133	473,061.72	464,542
Shpenzimet operative	298,000	242,000	306,436	130,584	240,816	306,557
Subvencionet	0					
Transferrat e brendshme	20,000	56800	95,000	0	56800	95,000
Transferrat e jashtme	0			13,015		
Transferrat për familjet	23,900,000	22,402,152	19,763,107	13,818,155	22,361,300	19,709,920
Investimet kapitale	9,200	461,450	65,100	27,200	139,252	73,421

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

16. Shpenzimet mesatare mujore për fëmijët e moshës 6-14 vjeç që ndjekin arsimin e detyrueshëm janë mbi 2 mijë lek, ndërsa programi i ndihmës ekonomike jep vetëm 700 lek për fëmijë për familjet e varfra për të mbuluar të gjithë konsumin. Një vlerësim i përfaqësues tregon që buxheti për përfshirjen sociale në arsim të paktën duhet të dyfishohet për të përmirësuar targetimin dhe mbulimin e fëmijëve nga kategoritë në nevojë.

Përfshirja sociale

Buxheti për programin e përfshirjes sociale është shumë modest dhe përfshin kryesisht aktivitete të stafit të lidhura me monitorimin e strategjive dhe të planeve të veprimit si dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit të cilat përqendrohen kryesisht tek tema e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Aktivitete të tjera për përfshirjen sociale përfshihen dhe në programe të tjera buxhetore, të tilla si bursat në arsimin fillor, subvencionimet për çmimin e teksteve shkollore, etj.

Tabela 24: Programi i buxhetimit të përfshirjes sociale

Produkti	VF 2012	VF 2013	VF 2014/ 6 muaj	VF 2015	VF 2016	VF 2017
Raporti i monitorimit për barazinë gjinore	1,919	1,634	1,308	2,590	2,590	1,860
Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit	6,527	6,279	2,117	11,995	11,995	12,560
Seminare dhe botime për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit	1,605	1,663	954	2,160	2,115	2,150
Telefon 24 orë	1,634	1,688		1,660	1,260	700
Mekanizmat ligjorë dhe institucionale		1,679	1,540	1,680	1,600	1,280
Raporti i monitorimit për dekadën Rome	1,650	1,612	26,653	1,015	990	1,590
Raport vlerësimi për strategjinë MF	1,658	2,618	1,002	2,790	2,490	3,260
Raporti i monitorimit për strategjinë e përfshirjes së romëve	1,583	292	960	4,100	3,660	2,600
Raportimi i monitorimit për planin e veprimit të fëmijëve	1,478	1,611	1,079	5,510	6,800	8,500
Agjencia Shtetërore për Fëmijët	3,288					
Totali	21,342	19,075	35,613	33,500	33,500	34,500
Në % të buxhetit të përgjithshëm të sektorit	0.017%	0.015%	0.025%	0.021%	0.020%	0.020%
Në % të shpenzimeve publike	0.006%	0.005%	0.008%	0.007%	0.007%	0.007%

Burimi: Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Drejtësia penale për të miturit

Shqipëria ka miratuar së fundmi disa masa në fushën e reformës së sektorit të drejtësisë penale me synim përmirësimin e situatës së fëmijëve dhe të të rriturve të rinj që janë viktime të episodeve të dhunës, duke u përqendruar posaçërisht tek ndalimi i të rinjve që kryejnë krime. Disa prej masave më domethënëse dhe të progresit në fushë përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrjen e njohurive nga vendimmarrësit dhe profesionistët për rrugën e reformës në drejtësinë penale për të miturit nëpërmjet avokatisë dhe trajnimit, gjë e cila ka çuar në miratimin e rekomandimeve për përmirësimin e administrimit të sistemit të drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri; miratimin e legjislacionit për alternativat ndaj ndalimit, krijimin e sistemit të provës dhe ofrimin e ndihmës juridike falas; zhvillimin e një game funksionimi alternativash të ndryshme nga ndalimi që reflektojnë plotësisht parimin e ri-integrimit dhe trajtojnë parandalimin e recidivizmit. Ligji për shërbimin e provës parashikon krijimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe, nëpërmjet mekanizmit të angazhimit të OJQ-ve

në zbatimin e dënimeve alternativave dhe ndërmjetësimit, ka potencialin të bëhet gradualisht pjesë e sistemit në të gjithë vendin. Në gjykata dhe në prokurori të shumë rretheve janë krijuar “seksionet për të miturit” si dhe janë miratuar akte specifike për policinë për dhunën në familje dhe drejtësinë për të miturit. Instituti i Riintegritimit në Kavajë është projektuar sipas një koncepti modern për trajtimin e minorenëve që janë në vuajtje dënimi, duke u përqendruar tek programet e riintegritimit dhe ato arsimore;

Megjithatë, pavarësisht progresit të mirë të arritur deri tani, ka ende përpara disa sfida për t'i bërë të mundur administratës shqiptare të zbatojë masa ligjore dhe administrative, përfshirë dhe nevojën për rishikimin e një plani dhe të politikave më të gjëra kombëtare për drejtësinë ndaj të miturve, pas zhvillimit të sistemit të drejtësisë penale dhe progresit në trajtimin më human të të miturve, si dhe rritjen e përdorimit të masave alternative ndaj dënimit. Për më tepër, do të ishte i nevojshëm një organ i përhershëm koordinimi për agjencitë qeveritare për t'ju përgjigjur më mirë në veçanti parandalimit të krimeve dhe riintegritimit social të të miturve, për të monitoruar progresin dhe për të bërë rekomandime lidhur me politikat që kanë të bëjnë me drejtësinë penale për të miturit nga MMSR-ja. Nevojitet mbështetje e mëtejshme për institucionalizimin e alternativave të tjera përveç ndalimit në sistem, duke mbështetur veçanërisht shërbimin e provës, ndërmjetësimin dhe ofrimin e ndihmës ligjore dhe psiko-sociale. Rritja e kapaciteteve për programet e riintegritimit në sistemin e burgjeve dhe forcimi i kapaciteteve të brendshëm për të monitoruar dhe ruajtur të drejtat e të miturve dhe një mekanizëm i përshtatshëm ankesash janë po ashtu të nevojshme në sistem. Agjencitë qeveritare kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme për një koordinim dhe planifikim më të mire, përfshirë buxhetimin e komponentëve të ndryshëm të sistemit të drejtësisë penale për të miturit. Nevoja për forcimin e kapaciteteve për mbledhjen e të dhënave dhe analizën e buxhetit është imediate për t'u bërë të mundur autoriteteve të monitorojnë situatën dhe të marrin vendime për shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore, si dhe mbi vlerësimin e nevojave dhe përparësive në të ardhmen pas informimit të plotë.

Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2013 ishte 5,57 miliardë lek. Buxheti parashikohet të ndryshojë çdo vit, duke arritur shifrën 8 miliardë në vitin 2014 (rritje prej 44%) kryesisht për shkak të rritjes domethënëse të fondit për kthimin e pronësisë; dhe të ulet sërish në periudhën 2015 – 2017. Buxheti i parashikuar për vitin 2016 dhe 2017 është 6.44 miliardë lek, 15.7% më i lartë se në vitin 2013.

Buxheti për sistemin e burgjeve ndjek të njëjtën tendencë si buxheti i përgjithshëm për Ministrinë e Drejtësisë, me një rritje domethënëse prej 4.7 miliardë lekësh në vitin 2014 dhe një ulje të vogël përgjatë vitit 2017. Megjithatë, buxheti për vitin 2017 do të jetë 7% më i lartë se në vitin 2013. Institucioni korrigjues i Kavajës është një institucion vuajtje dënimi vetëm për të miturit dhe është ndërtuar kohët e fundit me mbështetjen financiare të BE-së. Institucione të tjera penitenciare për fëmijët janë Korça (paraburgim); Jordan Misja Tiranë; Durrës; Lezhë dhe Vlorë (paraburgim).


Buxheti për shërbimin e provës është i ulët; në vitin 2013 ai ishte vetëm 101,4 milionë lek. Megjithatë, burimet që jepen për këtë shërbim parashikohen me rritje të qëndrueshme gjatë të gjithë 2017-ës, me buxhetin për 2017-ën që parashikohet në 176,17 milionë lek, ose 73.7% më shumë se në vitin 2013. Kjo reflekton përparësitë e qeverisë për të kontribuar më shumë burime për sistemin alternativ.

Tabela 25: Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë 2013 (aktuali) dhe buxheti për periudhën 2014 - 2017

	2013	2014	2015	2016	2017
Ministria e Drejtësisë	5,567,966	8,034,220	7,087,250	6,443,860	6,443,860
Shërbimet e përgjithshme për publikun	1,082,501	1,568,270	1,726,690	1,509,660	1,509,660
Botimet zyrtare	49,135	44,850	56,950	49,950	49,950
Mjekësia ligjore	48,165	62,500	62,500	60,500	60,500
Sistemi i burgjeve	3,714,916	4,703,240	4,376,420	3,999,420	3,999,420
Shërbimi i përmbaaruesve gjyqësor	105,460	108,980	104,800	104,500	104,500
Shërbimi i birësimit	12,317	11,200	12,700	12,700	12,700
Kthimi i pronave	425,317	1,428,880	581,020	530,960	530,960
Shërbimi i provës	101,420	106,300	166,170	176,170	176,170
Ish të përndjekurit politikë	28,735				

Burimi: Ministria e Drejtësisë

Në vitin 2014 kishte përafërsisht 9 të mitur të dënuar që vuanin dënime në ambientet e vuajtjes së dënimit në vend dhe 97 të mitur nga shifra e përgjithshme e 2658 të dënuarve dhe 3110 individëve në paraburgim¹⁷. Totali i shpenzimeve për sistemin e burgjeve në vitin 2014 arriti në 4,7 miliardë lek. Përqindja për fëmijët i takon që është mesatarisht 1.84% e shpenzimeve të përgjithshme, ose mesatarisht 86,4 milionë lek në vitin 2014. Kjo shifër është mesatare pasi nuk merr parasysh diferencat në koston për ambientet e vuajtjes së dënimit për fëmijët dhe për të rriturit.¹⁸ Për më tepër, kostot janë të lidhura me faktorë të tillë si numri i fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijët si dhe kostot fikse. Për më tepër, në vitin 2013 ka pasur mesatarisht 2085 persona që kanë marrë dënime alternative dhe që i janë nënshtruar shërbimit të provës. Nga këto, rreth 9 kanë qenë fëmijë, çfarë do të thotë që janë shpenzuar përafërsisht 437 mijë lek për fëmijët në shërbimet e provës.

Figura 18: Përqindja e sistemit të burgjeve dhe e shërbimit të provës për buxhetin e përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë 2013 - 2017

Burimi: Ministria e Drejtësisë

17. Burimi: Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

18. Nuk ka tregues për dallimet në politika lidhur me kostot për të burgosur të rritur dhe për fëmijë.

4. Përfundimet kryesore dhe rekomandimet

Përfundimet kryesore dhe rekomandimet mbështetur në analizën e statistikave sociale

Arsimi: Shpenzimet mujore për arsimin janë më të larta në zonat urbane krahasuar me zonat rurale. Familjet në zonat urbane kanë shpenzime më të larta për tarifa në arsim, ndërsa ato në zonat rurale kanë shpenzime më të larta për transportin. Është vënë re se shpenzimet për strehim zënë pjesën kryesore të shpenzimeve mujore për arsim si në zonat urbane dhe në ato rurale; ndërkohë që zonat urbane duket se kanë shpenzime më të larta parashkollore. Nuk vërehen dallime të qarta midis shpenzimeve të arsimit për djemtë dhe vajzat; megjithatë regjistrimi në shkollë mund të përbëjë një mekanizëm paraprak diferencimi.

Shpenzimet mujore të familjeve për arsim rriten me moshën e fëmijës. Shpenzime më të larta nevojiten për fëmijët e moshës shkollore 6 deri në 14 vjeç për transportin, tarifat, uniformat, librat shkollorë, materialet, strehimin, ekskursionet, etj. krahasuar me fëmijët në moshë parashkollore. Të dhënat nga INSTAT tregojnë që prefekturat e Beratit, Kukësit, dhe Korçës kanë vlerat më të larta të shpenzimeve të familjeve për arsim. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve shpërndahen tek fëmijët e grupmoshës 6 deri në 14 në Berat dhe fëmijët e moshës 0-5 në dy prefekturat e tjera.

Varfëria tek fëmijët: Niveli i varfërisë së fëmijëve ulet me rritjen e moshës së tyre. Familjet me fëmijë 0-5 vjeç kanë nivele më të larta varfërie, ndërsa familjet me fëmijë në moshën 15-17 kanë nivelin më të ulët të varfërisë. Me rritjen e numrit të fëmijëve rritet dhe niveli i varfërisë tek familjet. Familjet me numër më të madh fëmijësh që janë më të varfra kanë më shumë gjasa të kenë kryefamiljar me nivel më të ulët arsimimi. Mesatarisht një e pesta e familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç marrin ndihmë ekonomike.

Drejtësia për të mitur: fëmijët e akuzuar për krime zënë 8.21% të popullsisë. Nivelet e vajzave nuk e tejkalojnë 1%. Tirana ka shifrën më të lartë të krimeve të kryera nga fëmijët, ndërsa pjesa më e madhe e krimeve të kryera lidhen me drogat.

Puna e fëmijëve: Nivelet e punësimit dhe të pjesëmarrjes në forcën e punës rriten me moshën e fëmijëve. Djemtë në moshën 15-17 vjeç kanë nivelin më të lartë të punësimit dhe të pjesëmarrjes në tregun e punës me përkatësisht 20.7% dhe 22.5%. Vajzat e së njëjtës grupmoshë, nga ana tjetër, kanë nivel punësimi prej 13.1% dhe pjesëmarrje në tregun e punës prej 14.5%. Kjo tregon që djemtë mund të kenë më shumë mundësi të bëhen fëmijë që punojnë ose të angazhohen në punën e fëmijëve. Vajzat, nga ana tjetër, janë më shumë të angazhuara për punë të papaguar bujqësore brenda familjes, ku kanë tendencë të qëndrojnë edhe në moshë madhore.

Fëmijët marrin pjesë kryesisht në punën në bujqësi. Tetëdhjetë përqind e të gjithë fëmijëve të punësuar merren me bujqësi, gjueti, pyje dhe peshkim. Përqindja e vajzave në këtë aktivitet është paksa më e lartë sesa përqindja e djemve. Ndarja sipas gjendjes së punësimit tregon se 93.4% e vajzave të punësuar punojnë në punë të papaguar në familje. Pjesëmarrja e djemve në këtë aktivitet është po ashtu mjaft e konsiderueshme, në nivelin 87.2%, por më e ulët se e vajzave.

Ka fëmijë të punësuar në tregtinë me shumicë dhe pakicë, aktivitet që mund të lidhet kryesisht me shitjen në rrugë nga fëmijët.

Pothuajse 100% e fëmijëve që nuk punojnë frekuentojnë shkollën. Nivelet e frekuentimit të shkollës janë më të ulëtat për fëmijët e moshës 15-17 vjeç që punojnë. Modelet e përdorimit të kohës për djemtë dhe vajzat e moshës 6-17 vjeç tregojnë që vajzat që janë në shkollë janë shumë më të angazhuara në shërbimet e papaguara në familje krahasimisht me djemtë. Vajzat arrijnë 43.0% krahasuar me 28.1% për djemtë.

Ka më shumë fëmijë që punojnë sesa fëmijë të punësuar. Prefekturat e Elbasanit, Korçës dhe Shkodrës kanë nivelet më të larta të fëmijëve që punojnë dhe të fëmijëve të punësuar. Prefekturat e Durrësit, Fierit, Gjirokastrës, Lezhës, Tiranës, dhe Vlorës kanë nivelin më të ulët të fëmijëve që punojnë dhe të punës së fëmijëve.

Shëndeti: vdekshmëria foshnjore për fëmijët nën moshën 5 vjeç arrin në 10%. Në çdo grupmoshë djemtë kanë nivel më të lartë vdekshmërie sesa vajzat. Grupmosha nën 6 vjeç ka nivelin më të lartë të kequshqyerjes në 27%. Djemtë kanë nivel më të lartë kequshqyerje krahasuar me vajzat. Përqindja e fëmijëve mbi peshë arrin në 22%.

Përfundimet kryesore dhe rekomandimet mbështetur në analizën e buxhetit të shtetit

Shpenzimet e buxhetit të shtetit për fëmijët arritën në 39,4 miliardë lekë në vitin 2014, duke shënuar një rritje prej 4 përqind për shpenzimet për fëmijët krahasuar me vitin 2012. Parashikimet për periudhën afatmesme tregojnë që shpenzimet për fëmijët pritet të rriten në 48 miliardë lekë deri në fund të vitit 2017, ose 22% më shumë sesa financimi vjetor për vitin 2014. Shpenzimet për fëmijët në vitin 2014 zënë 8.6% të buxhetit të përgjithshëm kombëtar dhe 2.8% të PBB-së. Përqindja e shpenzimeve për fëmijët në raport me PBB-në pritet të mbetet në nivele të qëndrueshme në periudhën 2015 – 2017, pavarësisht rritjeve domethënëse në terma nominalë duke qenë se niveli i parashikuar i rritjes së PBB-së është më i lartë sesa ritmi i rritjes në sektorët e fëmijëve.

Shpenzimet e buxhetit të shtetit për fëmijët janë rritur me 1,6 miliardë lekë, ose 4.3 përqind në vitin 2014 krahasuar me buxhetin e 2012-ës. Parashikimet deri në 2017-ën sugjerojnë rritje të buxhetit të shtetit për fëmijët si përqindje e totalit të buxhetit, nga 8.6% përqind në 9.8% përqind të totalit të shpenzimeve. Shpenzimet totale të buxhetit të shtetit parashikohen të rriten për tri vitet e ardhshme me mesatarisht 2% në vit, por programet e fëmijëve do të rriten me ritëm mesatar prej 7%.

Shpenzimet publike për **arsimin**, në nivelin prej 2.8% të PBB-së janë të ulëta krahasuar me shtetet e rajonit dhe ato fqinje. Në krahasim, shtetet e tjera në rajon shpenzojnë

mesatarisht 5-6% të PBB-së për arsimin, dhe shtetet e OECD-së shpenzojnë 6.3% të PBB-së.

Financimi për sektorin arsimor është rritur në terma nominalë, por përqindja e tij në raport me PBB-në do të vijojë tendencën në ulje deri në 2017-ën. Shpenzimet për arsimin si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme publike kanë rënë nga 11.3% në vitin 2005, në 10.3% në vitin 2012 dhe 8.5% në vitin 2015. Shpenzimet për arsimin si pjesë e shpenzimeve të buxhetit janë rritur nga niveli i planifikuar prej 8.5% në vitin 2015, në 9.7% në vitin 2017.

60% e fondeve për arsimin janë dhënë për arsimin bazë dhe rreth 20% për arsimin e mesëm. Në vitin 2013, shpenzimet mesatare të buxhetit për shërbime për fëmijët në arsimin bazë ishin 51,625 lekë; ndërsa për fëmijët në arsimin e mesëm të përgjithshëm (përfshirë investimet kapitale) ishin 45,037 lekë, ose rreth 20% më pak. Kjo tregon nënfinancimin e arsimit të mesëm; ndërkohë që të dhënat për vendet e OECD-së dëshmojnë se shpenzimi për nxënësit rritet për secilin nivel.

Shpenzimet e përgjithshme në **sektorin shëndetësor** për buxhetin e 2015-ës arrijnë në 41.23 miliardë lekë. Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë ishte 32,4 miliardë lekë në vitin 2015, ose 1.6 miliardë lekë më shumë sesa në vitin 2014; ndërsa kontributet për skemën e sigurimeve të detyrueshme shëndetësore parashikohen të rriten me 500 milionë lekë në vitin 2015 (8.8 miliardë lekë në vitin 2015). Buxheti i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë është rritur, megjithëse shpenzimet kapitale në sektor janë tkurrur me 14% (307 milionë lekë) krahasuar me buxhetin e rishikuar të 2014-ës. Uljet më domethënëse në shpenzime kapitale vërehen në programet e kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor.

Programi më i lidhur me fëmijët është kujdesi shëndetësor parësor, i cili përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor në të gjithë vendin dhe shërbimin e mjekut të familjes. Shërbimet e kujdesit parësor janë pa pagesë për disa kategori të popullsisë, përfshirë përfituesit e programit të ndihmës ekonomike, veteranët e luftës, personat me aftësi të kufizuara për shkak të luftës, fëmijët e moshës 0-1 vjeç dhe jetimët, si dhe persona me kushte të posaçme mjekësore. Fëmijët mbi 1 vjeç dhe gratë shtatzëna/me leje lindje pranohen në sistemin e kujdesit shëndetësor me bashkëpagesë (sigurimet shëndetësore).

Shërbimi shëndetësor publik mbulon programin e vaksinimit për fëmijët e të gjitha moshave në Shqipëri. Mbulimi i programit të vaksinimit është thujse universal me mbi 99% të fëmijëve të vaksinuar, përfshirë fëmijët nga familje të disavantazuara dhe/ose fëmijë nga pakicat. Shërbimi i vaksinimit ofrohet nëpërmjet shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor dhe jepet pa pagesë për të gjithë fëmijët. Nuk ka të dhëna të disponueshme për raportin e fëmijëve nga familjet e varura (jo kontribuese) që mbulohen nga skema e vaksinimit, pasi financimi është universal.

Shpenzimet për **ndihmë ekonomike** janë mjaft të ulëta në më pak se 1% e PBB-së, nga niveli 1.4% i PBB-së në vitin 2012 dhe parashikohen të mbeten në nivele të ngjashme deri në vitin 2017. Përfitimet e ndihmës ekonomike (sociale) kanë rënë në mënyrë të ndjeshme në vitin 2013 krahasuar me vitet e mëparshme, pavarësisht rritjes së niveleve të varfërisë pas rënies ekonomike të viteve të fundit. Programi i ndihmës ekonomike mbështet rreth 20% të familjeve me fëmijë nën moshën 18 vjeç

– 77,444 familje nga gjithsej 390 mijë familje me fëmijë në vend; ose 85 mijë fëmijë nga 144 mijë fëmijë që jetojnë në familje të varfra.

Financimi për **shërbime të kujdesit social** zë më pak se 3% të shpenzimeve të përgjithshme për mbrojtjen sociale, ndërsa shërbimet e fëmijëve zënë rreth 24% të kostove të shërbimeve të kujdesit social. Shërbimet e kujdesit social për fëmijët janë shumë të kufizuara: aktualisht ka vetëm 14 qendra të shërbimeve sociale publike që ofrojnë shërbime për rreth 511 fëmijë në përgjithësi. Pjesa më e madhe përfshin shërbime rezidenciale për fëmijët pa kujdes prindëror dhe/ose fëmijë me paaftësi, por ka edhe disa shërbime të kujdesit ditor për ta. Kapaciteti i këtyre qendrave është jashtëzakonisht i kufizuar: numri i përgjithshëm i fëmijëve që marrin shërbime është më i ulët se 3% e fëmijëve me lloje të ndryshme paaftësish. Shërbimet ndihmëse për fëmijët e moshës 0-3 vjeç janë të disponueshme vetëm në qytete, kanë kapacitet të kufizuar dhe nuk ka shërbime të mbështetjes për kujdesin e fëmijëve në zonat rurale.

Shqipëria ka bërë progres në fushën e **drejtësisë për të miturit**, lidhur me përmirësimin e legjislacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe të njohurive për drejtësinë për të miturit. Institucionet e specializuara për ndalimin e të miturve janë ndërtuar me mbështetjen e donatorëve ndërkombëtarë. Gjatë viteve të fundit është krijuar shërbimi i provës. Buxheti i tij është dyfishuar për vitin financiar 2015. Nuk ka tregues specifikë për politikat e veçanta të shpenzimeve për të miturit për ndalimin e tyre ose për shërbimin e provës.

Nga pikëpamja institucionale, ka disa agjenci publike me funksione të ndryshme për fëmijët – për shembull, për çështjet sociale MMSR-ja është institucioni përgjegjës për politikat e përgjithshme që synojnë fëmijët, ndërsa SSS-ja është përgjegjëse për kujdesin social, PKVMDF-ja për avokati dhe këshillim për të drejtat e fëmijëve, NLI për punën e fëmijëve, SHKP-ja për punësimin dhe AKAFPT-ja për shërbimet e AFP-së, MD-ja për drejtësinë për të miturit, MZhUT-ja për strehimin social, MAS-i për arsimin në përgjithësi, por edhe për programe specifike për arsimin gjithëpërfshirës, etj. Po ashtu, ka dhe organizata të shoqërisë civile si ofruer shërbimesh dhe si mbrojtës së të drejtave të fëmijëve dhe agjenci ndërkombëtare me axhendat e tyre për të drejtat e fëmijëve dhe kushtëzimet e tyre, të tilla si KE-ja. Ky sfond i ngarkuar thekson **nevojën për një mekanizëm bashkëpunues ndërinstitucional**, ose nëpërmjet agjencisë ose MMSR-së, e cila siguron ndarjen e informacionit dhe sinergji dhe marrëdhënie të harmonizuara ndërmjet agjencive të përfshira. Në të njëjtën kohë, ekziston edhe **nevoja për racionalizim të funksioneve sipas llojit të organizimit** përderisa disa funksione duket se janë të izoluara në agjenci të caktuara mandatet e të cilave janë të përqendruara në elementë të caktuar dhe punojnë në izolim.

Eksperienca nga shtetet e tjera që kanë nisur buxhete miqësore për fëmijët, zakonisht nëpërmjet mbështetjes së UNICEF-it përbëhen nga: legjislacioni për buxhetin, struktura e sistemit buxhetor, etapat bazë të proceseve buxhetore, të cilat përfshirë përgatitjen, miratimin dhe kontrollin e ekzekutimit të buxhetit, sistemin e barazimit ndërbuxhetor. Ndërsa në disa vende janë krijuar Fondet Kombëtare për Fëmijët, shoqëruar me një formulim të qartë dhe përdorim të këtij fondi. Për më tepër, janë bërë dhe vlerësimet e shërbimeve sociale në interes të familjes dhe fëmijëve, duke analizuar dhe shpërndarjen e shpenzimeve në arsim ndërmjet niveleve të sistemit buxhetor dhe shpenzimeve lokale për buxhetin në arsim dhe ndarje në përpjesëtim të zhdrejtë për frymë ndërmjet qarqeve. Një vlerësim i ngjashëm që mbulon dhe **shpenzimet lokale**

në të gjitha fushat parësore të Planit të Veprimit do të kishte qenë vërtet i dobishëm për Agjencinë, por edhe për organizatat e shoqërisë civile që promovojnë të drejtat e fëmijëve, në mënyrë që të ishin në gjendje të artikulonin më mirë përpjekjet e tyre drejt buxheteve miqësore.

Vëmendje i duhet kushtuar dhe **vlerësimit të cilësisë së shërbimeve, projekteve dhe programeve** të ofruara nga qeveria duke marrë parasysh rezultatet e ulëta të sektorëve kryesorë (arsimi, shëndetësia, etj.) në krahasim me standardet rajonale dhe ndërkombëtare. Është e nevojshme të kalohet nga diskutimet e përgjithshme të mbështetura vetëm tek shumica e fondeve të shpenzuara për fëmijët në një analizë cilësore të shpenzimeve për fëmijët. Vlerësimet sasiore dhe cilësore duhet të bëhen në mënyrë periodike nga ekspertë të pavarur.

Mbledhja e të dhënave duhet të forcohet në të gjitha nivelet e qeverisjes ndërsa sigurohet vijimësi dhe raporte të standardizuara, si dhe raporte statistikore në kohë për monitorimin e shpenzimeve publike, të cilat duhet të jenë po ashtu publikisht të disponueshme.

Qeveritë, për shkak të pengesave fiskale, i shkurtojnë shpenzimet që mbështesin mirëqenien e fëmijëve. Si rezultat, megjithëse fondet buxhetore mund të duken se po rriten, fondet për fëmijët nuk janë rritur në mënyrë të ndjeshme. Nga kjo analizë e parë për buxhetimin e fëmijëve, disa prej konstatimeve kryesore janë: **programi ekonomik kombëtar nuk reflekton domosdoshmërisht vëmendje tek fëmijët dhe familjet** (përveç transfertave të parave si pjesë e skemës së ndihmës ekonomike); **vëmendje e kufizuar i kushtohet vlerësimit të ndikimit tek fëmijët** të shpenzimeve si dhe rezultateve në kuadrin e politikave dhe atë fiskal; njohuri të kufizuara për buxhetin miqësor për fëmijët dhe kapacitete të dobëta për matjen e efektivitetit dhe efikasitetit të shpenzimeve publike për fëmijët; mungesa e lidhjes ndërmjet përparësive të politikave dhe të shpenzimeve për të prekur fëmijët më vulnerabël; mungesa e një programi përfitimesh për fëmijët dhe familjet dhe një sistem i dobët kujdesi social për mbrojtjen e fëmijëve.

Rritja e investimeve për fëmijët kërkon një vizion që garanton të drejtat e fëmijëve pavarësisht nga sa familjet e tyre mund t'i përballojnë, të tilla si sigurimin e burimeve të përshtatshme që mbështesin aksesin e barabartë për **kujdes dhe arsim shëndetësor cilësor** pavarësisht statusit të tyre ekonomik, vendndodhjes, etnicitetit, etj. Vetëm lobimi për të drejtat e fëmijëve për t'i vënë në krye të përparësive të qeverisë nuk mjafton pasi këto përparësi duhet të lidhen me **fonde dhe burime buxhetore të përshtatshme**.

Duhen sisteme të përshtatshme të **kontrollit dhe balancave** për sigurimin e saktësisë së përdorimit të buxhetit të dhënë për fëmijët, si dhe për krijimin e sistemeve efektive të monitorimit dhe të vlerësimit. Po ashtu, vlerësimet e efektivitetit të shpenzimeve buxhetore dhe ndikimit mbi të drejtat e fëmijëve përbëjnë element të rëndësishëm për përfshirjen e vlerësimeve të ardhshme.

Buxhetimi për fëmijët duhet të bëhet pjesë integrale e proceseve të planifikimit. Duke marrë parasysh ndryshimet në performancën e qeverisë drejt arritjes së objektivave kombëtare lidhur me fëmijët dhe zhvillimin, duhet bërë shumë punë për përmirësimin e fondeve dhe shpenzimeve dhe performancës së programeve që lidhen në mënyrë

të drejtpërdrejtë me përmirësimin e rezultateve për fëmijët. AKMDF-ja, MMSR-ja dhe MF-ja duhet të punojnë ngushtë bashkërisht në partneritetet për të forcuar procesin e planifikimit për buxhetin e 2016-ës dhe më tej.

Gjatë analizës u vu re po ashtu që termi buxhet për fëmijë shkakton disi konfuzion për shkak të analizës së kufizuar buxhetore në Shqipëri, e cila çon në keqkuptime pasi projekti mbështet prezantimin e një buxheti të veçantë për fëmijët. Më tej, gjatë analizës janë shqyrtuar aftësitë e analizave të organizatave për lidhjen e analizës së buxhetit me praktikën e punës me fëmijët.

Politikat e synuara rajonale: Dallimet në shpenzimet ndërmjet zonave urbane dhe rurale si dhe dallimet dhe karakteristikat në kushtet e tyre social-ekonomike kërkojnë politika specifike që i marrin parasysh këto dallime dhe që mund t'u përgjigjen me sukses nevojave të ndryshme në këto zona. Ka hapësirë për përmirësimin e *transportit publik për fëmijët e zonave rurale* qoftë nga pikëpamja sasiore dhe nga pikëpamja cilësore për t'i çliruar familjet nga shpenzimet e larta si dhe për t'u dhënë stimuj dhe mundësi prindërve në zonat rurale për t'i dërguar fëmijët në shkollë.

Investimet në parashkollor: Ka nevojë për më shumë investime publike për fëmijët në sistemin parashkollor, i cili duket gjithnjë e më tepër i rëndësishëm për *zonat urbane*, ku mbështetja tek anëtarët e familjes dhe në mbështetje familjare është më e pakët. Në këtë kuadër, shpenzimet më të larta mujore për arsimin ndërmjet *prefekturave më të varfra* paralajmërojnë për një barrë më të lartë financiare mbi familjet për shkak të numrit të madh të fëmijëve në moshë parashkollori, gjë e cila shoqërohet me shpenzime më të mëdha mujore nga prefekturat për fëmijët e moshës parashkollore. Nga ana tjetër, ofrimi më i madh dhe i përmirësuar i shërbimit parashkollor ofron *mbështetje sociale për nënat*, të cilat janë kryesisht ofrueset kryesore të kujdesit shëndetësor parësor, duke i rritur gjasat e tyre për t'u bërë pjesë e tregut të punës dhe për të kontribuar në të ardhurat e familjes. Kjo kërkon ndërveprim dhe koordinim të organeve të ndryshme të politikëbërjes për të ofruar stimuj që përmirësojnë jetesën e familjeve dhe, për pasojë, dhe mirëqenien e tyre.

Shërbime publike sipas demografisë: Politikat për ofrimet publike ose investimet duhet të marrin parasysh *përbërjen e moshës* së fëmijëve për t'i drejtuar investimet publike aty ku duhet, pasi fëmijët e moshave të ndryshme kanë nevoja të ndryshme dhe paraqesin pengesa të ndryshme financiare mbi familjet. Për më tepër, përderisa shpenzimet për arsimin rriten me moshën, prindërit me më pak të ardhura mund të hasen me vendimin për të vazhduar ose jo që t'i dërgojnë fëmijët në shkollë, ose në punë. Për pasojë, është e domosdoshme të kuptohet struktura e moshës së fëmijës dhe fondet e shpenzimeve për arsim brenda familjeve përpara se të merren vendime publike për fondet buxhetore për investimet publike.

Rritje e përpjekjeve për arsimim për familjet e varfra: duhet parashikuar më shumë mbështetje për familjet e varfra për të minimizuar rrezikun e dërgimit të fëmijëve në punë. Familjet me fëmijë të vegjël janë më të ndjeshme ndaj varfërisë dhe më tej mund t'i dërgojnë në punë fëmijët. Për pasojë, *demografia dhe përbërja e familjeve* është shumë e rëndësishme për ofrimin e fondeve publike, ashtu si edhe rritja e përpjekjeve lidhur me *shërbimet e arsimit* për të rritur nivelet e arsimit, për të ulur punën e fëmijëve dhe për të përmirësuar mënyrën e jetesës.

Politikat e ndjeshme gjinore: duhet të merren parasysh dallimet gjinore ndërmjet djemve dhe vajzave kur hartohen politikat dhe kur bëhen investime publike pasi *kjo mund të ketë ndikim të ndryshëm mbi ta*. Investimet publike duhet të induktojnë *barazi dhe mundësi të barabarta*. Vajzat dhe djemtë vihen lehtë në pozicionet e tyre shoqërore. Modelet e hershme të punësimit i ndjekin ata gjatë të gjithë jetës, ku gratë pozicionohen kryesisht në punë të papaguar në familje. Ndikimet për fëmijët në zonat rurale mund të jenë të ndryshme, pasi ato merren kryesisht me bujqësi. Për pasojë, kjo situatë kërkon vëmendje lidhur me *mundësitë për arsim për fëmijët dhe për mbështetje të mëtejshme për personat që jetojnë në zonat rurale*. Informacioni për aktivitetet e fëmijëve në punësim u shërben politikave sipas nevojave, të cilat *sigurojnë të drejtat e fëmijëve dhe i largojnë fëmijët nga puna, duke i vendosur në sistemin arsimor*. Djemtë duket se kanë më shumë të ngjarë të bëhen fëmijë që punojnë ose të angazhohen në punën e fëmijëve, ndërsa vajzat janë më të përfshira në punën e papaguar në familje, ku edhe vijnë të qëndrojnë dhe kur rriten.

Studimet në nivelin mikro: Studimet duhen kryer jo vetëm në nivelin makro, duke marrë parasysh faktorët e nivelit të lartë, por edhe në nivelin e familjeve, duke u përpjekur të kuptojnë nevojat e fëmijëve dhe ndarjen e fondeve buxhetore brenda familjes. Në këtë mënyrë, politikat në nivelin makro mund të jenë më gjithëpërfshirëse dhe më mirë të targetuara.

Përmirësimi i rezultateve – planifikimi i orientuar: Ndarja e burimeve duhet t'i përgjigjet nevojave specifike dhe të synojë rezultate specifike. Procesi i buxhetimit në disa sektorë duhet të përmirësohet me synim trajtimin më të mirë të mangësive në arritjen e rezultateve. Në veçanti, buxhetimi në sektorin shëndetësor mund të duhet të trajtojë më mirë nevojat e fëmijëve, të të varfërve dhe të grupeve të marginalizuara.

KAPITULLI 2

Rishikim Afatmesëm i Treguesve të Progresit të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2014

Experte: Elda Hallkaj (Denaj)

Dhjetor, 2014

Përmbajtja

Hyrje	56
Metodologjia.....	57
Progresi sipas treguesve.....	60
E drejta për Mbrojtje dhe Përfshirje Sociale.....	60
E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik.....	68
E drejta për zhvillim dhe arsim	75
E drejta për Kujdes Shëndetësor.....	82
E drejta për Mbrojtje Ligjore.....	91
Diskutime mbi Treguesit e Progresit.....	96
Përmbledhje e kategorizimeve.....	96
Statusi i realizimit.....	96
Kategoritë e ndryshimit.....	97
Qasja ndaj matjes së ndryshimit.....	98
Çështje të lidhura me përcaktimin e treguesve.....	99
Çështje të lidhura me mbledhjen e informacionit.....	100
Përfundime dhe Konkluzione.....	101
Shtojcë.....	104

Lista e Shkurtimeve

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHMDF	Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DPSHSSH	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror
KKDF	Këshilli kombëtar i të drejtave të Fëmijëve
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimit
MMSR	Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
MRD	Mënyrat e reja të disiplinimit
NJDF	Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
OJF	Organizata JoFitimprurëse
PKVF	Plani Kombëtar i Veprimit të Fëmijëve
ZA	Zyra Arsimore
BB	Banka Botërore

Hyrje

Rishikimi Afatmesëm i Treguesve të Progresit të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015 (PKVF) është ndërmarrë me iniciativë të organizatës Save the Children, Shqipëri mbështetur nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF). Paralelisht me këtë raport, në kuadër të të njëjtit program të mbështetur nga Bashkimi Europian¹, është kryer vlerësimi mbi rishikimin afatmesëm të buxheteve e shpenzimeve në përmbushje të PKVF. Pavarësisht përdorimit të qasjeve të ndryshme, të dy raportet janë ngushtësisht të lidhur për të plotësuar më mirë panoramën mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Me përfundimin e vlefshmërisë në kohë të PKVF (2015), në kuadër të të njëjtit program, do të ndërmerren vlerësimet përfundimtare, si në fushën e buxheti dhe shpenzimeve, edhe të treguesve, për të vlerësuar më mirë progresin e arrirë dhe adresuar nevojat për ndërhyrje gjatë procesit të PKVF vijuese.

Gjithashtu, raporti i rishikimit afatmesëm të treguesve të progresit të PKVF 2012-2015 pason raportin e situatës së të drejtave të fëmijëve 2013-2014, të publikuar nga ASHMDF me mbështetjen e UNICEF². Raporti afatmesëm synon të dokumentojë përmbushjen e deritanishme (2012-2014) të treguesve të përcaktuar në PKVF, si edhe do të shtjellojë disa nga problematikat e lidhura me to, dhe rekomandimet e nevojshme për përmirësim në të ardhmen.

Fokusimi tek treguesit ka shërbyer si një ushtrim për të kuptuar si këta tregues dhe informacioni i disponueshëm rreth tyre lehtëson matjen e suksesit të planit të veprimit si një dokument politik. Kjo qasje, edhe pse e kornizuar ngushtësisht tek treguesit, e ndërmarrë në bashkëpunim me stafin e ASHMDF ka lehtësuar të kuptuarin e përbashkët të problematikave mbi të dhënat dhe sistemet që mbledhin e i raportojnë ato. Kështu, përtej dokumentimit të situatës së progresit, iniciativa e hartimit të këtij dokumenti ka shërbyer si një aktivitet të zhvillimit të kapaciteteve të institucioneve për të përmirësuar raportimin mbi çështjet e lidhura me fëmijët.

PKVF 2012 – 2015 përbën një dokument të rëndësishëm politik në mbështetje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm në këtë dokument, si atyre qeveritarë, donatorë, shoqëri civile dhe komunitet përcjell mesazhin se respektimi i të drejtave të fëmijëve është detyra e të gjithëve, dhe mbi të gjitha bashkëpunimi efektiv i të gjithëve do të mund të sjellë rezultatet e pritshme në krijimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët.

PKVF 2012 – 2015 u hartua në përgjigje të rekomandimit 11 të BE-së për integrimin europian të vendit tonë. Ai vijoi pas përmirësimit të bazës ligjore - miratimi i ligjit

1. "Unlocking the Pot of Resources for Children's Rights in Albania" - EIDHR/2013/38; Implemented by Save the Children and the Institute for Contemporary Studies

2. ASHMDF/UNICEF. 2014. Raport Kombëtar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014. Tiranë:ASHMDF/UNICEF

nr.10347, datë 4.11.2010 “Mbi mbrotjen e të Drejtave të Fëmijës”, dhe përmirësimin institucional – ngritjes së ASHMDF.

PKVF 2012-2015 tërheq vëmendjen në dy drejtime kryesore: *a.* Forcimin e strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar e rajonal; *b.* Nxitjen e hartimit të politikave gjithëpërfshirëse, të koordinuara e harmonizuara të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve.

Në kuadër të të drejtave, PKVF përfshin të drejtën për mbrojtje dhe përfshirje sociale, të drejtën për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi; e drejta për zhvillim dhe arsim; e drejta për kujdes shëndetësor, dhe e drejta për mbrojtje ligjore. Paraqitur në kapituj të veçantë, për çdo të drejtë janë përcaktuar objektiva strategjike, objektiva specifike, aktivitete, institucione përgjegjëse, afate kohore, burime financiare dhe tregues.

ASHMDF, si institucion koordinues dhe monitorues i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, mbikqyr gjithashtu ecurinë e PKVF. Raportet e deritanishme të hartuara nga ASHMDF³ kanë ndjekur një metodologji të përgjithshme, herë duke reflektuar progresin sipas aktiviteteve të përcaktuara në PKVF, dhe herë pasqyrimin e përgjithshëm të ndërmarrjeve/përpjekjeve të realizuara për dhe rreth fëmijëve në sektorë të ndryshëm. Kështu, përgjithësisht përqëndrimi ka qenë mbi aktivitetet, por jo mbi rezultatet e shprehura në tregues.

Risia e informacionit të prezantuar në raportimin afatmesëm të arritjeve të treguesve është qasja metodike e fokusuar për të matur në mënyrë progresive dhe sistematike çdo tregues. Kjo merr rëndësi të veçantë nëse i konsiderojmë treguesit si instrumentat e nevojshëm për të përmirësuar llogaridhënien e insitucioneve të ndryshme në kuadër të mekanizmit të PKVF për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Metodologjia

Hartimi i dokumentit është bazuar në mbledhjen e informacionit fokusuar përfundimisht mbi treguesit e fushave të veprimit të PKVF 2012-2015, sipas racionalitetit të përmendur në hyrje të këtij dokumenti.

Në mungesë të raportimit sistematik të të dhënave të mëparshme mbi këta tregues, informacioni i mbledhur në kuadër të këtij raporti do të konsiderohet si fillestar për t'u krahasuar me atë të mbledhur në procesin e raportimit përfundimtar të arritjeve të PKVF në vitin 2015.

Informacioni i mbledhur është kryesisht ai i raportuar nga institucionet përgjegjëse tek ASHMDF, në përmbushje të detyrimeve ligjore⁴. Një pjesë tjetër e informacionit është mbledhur përmes kërkesave shtesë të drejtuara nga ASHMDF dhe Save the Children tek institucione të caktuara. Marrja e informacionit shtesë ishte thelbësor,

3. <http://www.femijet.gov.al/raporte>
Raportet 2011-2012; 2012-2013; 2013-2014.

4. VKM NR 267, datë 12.04.2012 “Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor”.

pasi të dhënat e përcaktuara në udhëzimin përkatës nuk përkojnë me informacionin e lidhur me treguesit.

Raporte të ndryshme të lidhura me fushat përkatëse janë konsultuar për të plotësuar panoramën e informacionit. Fokus grupe me OJF, aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve u organizuan për të mbledhur perceptime dhe informacione konkrete mbi aspekte të ndryshme të treguesve. Për të përmbushuar një nga të drejtat themelore të fëmijëve të cilët shënjestron ky raport, mendimi i fëmijëve, të organizuar në fokus grupe, u konsultua gjithashtu⁵.

Në diskutim ka qenë me aktorët e përfshirë prezantimi i ecurisë së treguesve në këtë raport. Kjo, pasi një sërë sfidash në përcaktimin e treguesve janë identifikuar, si edhe në mbledhjen e informacionit lidhur me to. Në kushtet më të mira, patja e informacionit mbi secilin tregues të mirëpërcaktuar do të lejonte të krahasohej në vijueshmëri ecuria (2012-2014), për të përcaktuar arritjen apo jo të treguesve në kuadër të afateve kohore të përcaktuara në PKVF.

Treguesit përcaktohen për të monitoruar rezultatet e objektivave/ programeve/ ndërhyrjeve të planifikuara. Në vetvete treguesit janë një *sinjalizues* i asaj që ka ndodhur, por janë të kufizuar për të na treguar pse programi/ndërhyrja ka sjellë ndryshim, pse dhe si ka ndodhur ndryshimi.

Për të adresuar kufizimet e sipërpërmenduar, treguesit në *seksionin e progresit* sipas treguesve janë shoqëruar me të gjithë informacionin e mundshëm të mbledhur për vitet përkatëse (2012-2014), jo vetëm numerik por edhe narrativ/përshkrues. Referime përkatëse shoqërojnë informacioni, në rastin e disponueshmërisë së tyre.

Për më tepër është përcaktuar kategorizimi i statusit të realizimit:

Tregues të realizuar – janë përfshirë tregues, informacioni për të cilët evidenton përmbushjen e tyre.

Tregues që tregojnë progres - në këtë kategori janë përfshirë tregues të cilët tregojnë më së shumti aktivitete të realizuara. Diskutueshmëria e progresit të këtyre treguesve vihet në pikëpyetje kryesisht nga mungesa e targeteve specifike si në vlera numerike edhe në afate kohore. Këto janë tregues të vlefshëm për t'u monitoruar në vazhdimësi nga ASHMDF. Gjithashtu do të jenë fokus i raportimit përfundimtar duke përdorur informacionin e mbledhur si bazë fillestare krahasuese.

Tregues të përcaktuar – përfshirë janë tregues për të cilët nuk është kryer asnjë aktivitet, ose kanë përfunduar afatet kohore të realizimit për përcaktuar në PKVF.

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë – kategorizimi është i gjerë, por ndërveprimi mes faktorëve rezulton në të njëjtën situatë të pamundësisë për të konkluduar mbi ecurinë e tij.

5. Grup diskutimi drejtuar me 30 të rinj të mbledhur në datë 4 nëntor 2014, në Elbasan, lehtësuar nga Save the Children

Seksioni i *diskutimeve mbi treguesit e progresit* tenton të klasifikojë treguesit sipas karakteristikave të veçanta, dhe evidenton çështje/problematika të lidhura me treguesit e PKVF. Konkluzionet janë menduar si një përmbledhje e rekomandimeve që mund të jenë të vlefshme gjatë proceseve të përmirësimit të sistemit të treguesve. Në përfundim të raportit, rekomandime nga dokumenta të Bashkimit European mbi treguesit për të drejtat e fëmijëve janë bashkangjitur si shtojcë orientuese.

Progresi sipas treguesve

E drejta për Mbrojtje dhe Përfshirje Sociale

Rritja e rolit të njësive të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë.

Objektivi: Hartimi dhe vlerësimi i politikave rajonale për çdo qark, për realizimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh gjendjen ekonomiko-sociale të rajonit.

Treguesit	Realizimi
Numri i qarqeve që kanë miratuar strategji rajonale për të drejtat e fëmijëve.	7 rajone kanë realizuar strategji rajonale veprimi për fëmijët, tre prej të cilave kanë përfunduar në vitin 2013 (Dibër, Vlorë, Shkodër). Në proces mbetën strategjitë në qarkun e Beratit dhe Lezhës. Asnjë strategji nuk është hartuar për Qarkun e Gjirokastrës, Korçë e Durrës ⁶ . <i>Në progres</i>
Numri i raporteve të progresit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjive.	Raporte vlerësimi janë zhvilluar vetëm në dy Qarqe, Fier dhe Shkodër për vitet 2013, 2014 ⁷ . <i>Në progres</i>
% e rritjes së buxhetit për fëmijë në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale në çdo qark	<i>Pa informacion në nivel qarku</i>

Objektivi: Hartimi i politikave për zbutjen e varfërisë dhe përjashtimin social të fëmijëve në nevojë.

Treguesit	Realizimi
Numri i Njësive të qeverisjes vendore për pilotimin e skemës së re të ndihmës ekonomike	3 Qarqe janë përfshirë në pilotim (Tiranë, Elbasan dhe Durrës) ⁸ . <i>I realizuar</i>

6. Informacion i raportuar nga ASHMDf

7. ibid

8. MMSR

<p>Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit Nr.9355 dt. 05.12.2006</p>	<p>VKM nr.904 datë 12.12.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike, në zonat pilot” dhe udhëzimi nr. 9 datë 23.06.2014 në zbatim të tij, i përcakton qartë të gjitha kriteret dhe procedurat e përfitimit të masës së ndihmës ekonomike në zonat pilote.</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Numri i NJDF dhe stafit të zyrave të Ndihmës Ekonomike të trajnuar</p>	<p><i>Pa informacion</i></p>

Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë

Objektivi: Deinstitutionalizimi – transformimi i shërbimeve rezidenciale në tipologji të reja shërbimesh

Treguesit	Realizimi
<p>Numri i shërbimeve të reja për fëmijë</p>	<p>2014: 1 Këshilli Administrativ i Shërbimit Social Shtetëror më datë 18.03.2014 me Nr.vendimi 166/5, vendosi miratimin e Hapjes së Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencës për Kategoritë në Nevojë. Në këtë kontekst, strukturave nacionale të shërbimeve që menaxhohen dhe administrohen nga SHSSH, i shtohet edhe një tipologji e re shërbimi⁹.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Transformimi i qendrave rezidenciale në Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë</p>	<p>2012-2013 Tirana Në këtë institucion jetojnë 38 fëmijë të cilët janë vendosur në 4 apartamente të ndarë përkatësisht sipas grupmoshave dhe gjinive të ndryshme¹⁰.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i shtëpive-familje në shërbimet rezidenciale dhe numri i fëmijëve që trajtohen aty</p>	<p>2014: 2 “Shtëpi Fëmije Rezidenciale Publike”¹¹ “Shtëpia e Fëmijë 0-6 vjeç Durrës”, ku trajtohen 20 fëmijë në dy “ Shtëpi familje” dhe “ Shtëpia</p>

9. DPSHSSH

10. ibid

11. DPSHSSH

e Fëmijës 6-16 vjeç Zyber Hallulli “- Tiranë e transformuar në 4 apartamente për 46 fëmijë rezidenciale.

Gjithashtu si pjesë e rrjetit të shërbimeve rezidenciale për fëmijë janë edhe qendrat rezidenciale jo publike OJF që ofrojnë këtë shërbim të formës “ Shtëpi Familje “ për fëmijët në nevojë si më poshtë” :

1. SOS- Fshatrat e Fëmijëve- Tiranë - 69 fëmijë
2. SFI- Rreze Dielli – Tiranë 8 fëmijë
3. “ Orët Faltume” – Elbasan 29 fëmijë
4. Vatër e Ngrohtë – Gjirokastër 14 fëmijë
5. Fillimet e Reja – Tiranë 13 fëmijë
6. Misioni Katolik” Bijat e Dashurisë – Mollas Elbasan 7 fëmijë
7. Komuniteti “ Papa Giovanni XXIII’- Shkodër 20 fëmijë

Në progres

Objektivi: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijë

Treguesit	Realizimi
Raportet e inspektoriatit të shërbimeve	Maj 2012 - Prill 2013: 40 Inspektime në institucione publike dhe jopublike Maj 2013 - Maj 2014: 57 Inspektime (17 Rezidenciale dhe 40 institucione ditore) 70% e tyre respektojnë standardet <i>Në progres</i>
Standartet e reja të miratuara për tipologjitë e reja të shërbimeve për fëmijë	2012-2014: 0 <i>I përealizuar</i>

Objektivi: Zgjerimi i hartës së shërbimeve për fëmijë. Bashkëpunim i njësive të qeverisjes vendore dhe donatorë të ndryshëm për ngritjen e shërbimeve të reja

Treguesit	Realizimi
Harta e shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe sipas njësive të qeverisjes vendore	2013: <i>I Realizuar</i> ¹²

12. <http://www.sherbimisocial.gov.al/>

Planet zonale ku përcaktohen nevojat e komunitetit për shërbimet për fëmijë	2013: Realizuar vetëm për Elbasan, Berat, Fier <i>Në progres</i>
Numri i kontratave të lidhura me ofrues të shërbimeve për fëmijë	<i>I paraportuar</i>

Objektivi: Mbrojtje alternative për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror

Treguesit	Realizimi
Raporti i vlerësimit të pilotimit të shërbimit të kujdestarisë	2013: Studim i mbështetur nga UNICEF ¹³ <i>I realizuar</i>
VKM e miratuar mbi kujdestarinë	VKM Nr 89 datë 26.01.2012 dhe udhëzimin Nr 6 datë 01.08.2012 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë” parashikon shërbim në familje kujdestare për fëmijët në nevojë të cilëve u mungon kujdesi prindëror. <i>I realizuar</i>
Numri i komiteteve të vlerësimit të familjeve të ngritura në 6 bashki	Nuk është mbledhur apo raportuar informacion mbi këtë <i>Pa informacion</i>
Numri i familjeve kujdestare të trajnuara.	Nuk është mbledhur apo raportuar informacion mbi këtë <i>Pa informacion</i>
Numri i anëtarëve të komisioneve që përzgjedhin familjen kujdestare të trajnuar	Nuk është mbledhur apo raportuar informacion mbi këtë <i>Pa informacion</i>
Numri i fëmijëve të birësuar	2012-2013: 80 birësime 2013-2014: 41 birësime <i>Në progres</i> ¹⁴

13. http://www.unicef.org/albania/Protection-Albania_fostering_evaluation-oct13.pdf

14. Komiteti Shqiptar i Birësimeve

<p>Monitorime periodike nëpër institucione publike dhe jopublike për zbatimin e afateve ligjore për fillimin e procedurave për birësim.</p>	<p>Viti 2013-2014: Janë monitoruar të gjitha institucionet publike dhe jo publike të përkujdesit të fëmijëve, ku prioritet kanë qënë institucionet të cilat kanë prurje të madhe fëmijësh të braktisur. Ndër më kryesoret qëndrojnë: institucioni i Vlorës, Durrësit, Korçës, Shkodrës dhe Tiranës. Mungon informacion mbi periodicitetin e monitorimeve apo raporte të lidhura me to.</p> <p>Në progres¹⁵</p>
<p>Hartimi i standarteve të shërbimit të birësim.</p>	<p>Viti 2013: Komiteti ka paraqitur edhe projekt propozimin për Rregulloren e Brendshme të KSHB, e cila do të pasqyrojë në një mënyrë mjaft të qartë të gjitha procedurat përkatëse që ndiqen në institucion në respektim të afateve të kërkuara ligjore. Viti 2014: Në proces</p> <p>Në progres¹⁶</p>
<p>Monitorime të periudhës pasbirësuese.</p>	<p>Viti 2012: 40 raporte pasbirësuese Viti 2013-2014: 50 raporte pasbirësuese</p> <p>Në progres¹⁷</p>

Harmonizimi i politikave për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor

Objektivi: Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Treguesit	Realizimi
<p>Raportet vjetore te gjendjes së realizimit të të drejtave të fëmijëve</p>	<p>2012: 1 “Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të ligjit “për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”¹⁸ 2014: 1 “Situata e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri 2013-2014”, mbështetur nga UNICEF me fokus realizimin e objektivave.</p> <p>Në progres</p>

15. ibid

16. ibid

17. ibid

18. <http://www.femijet.gov.al/ep-content/uploads/2014/02/RAPORTI-VJETOR-2012-2013.pdf>

<p>Mbledhjet e Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve (KKDF) për të diskutuar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në vend, çdo 6 muaj</p>	<p>2012: 1 2014: 1</p> <p><i>Në progres</i>¹⁹</p>
<p>Rekomandimet e dala nga mbledhja e KKDF</p>	<p>Viti 2014: Duke marrë në konsideratë situatën aktuale në vend, rekomandimet e Raportit Periodik Universal, dhe treguesit e prioritetit 5 (Udhërrëfyese për Integrimin European), u evidentuan përparësitë në ndërhyrje të lidhura me fuqizimin sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë miratimin e Protokollit për Mbrojtjen dhe Kujdesin për Fëmijët; buxhetimin me fokus fëmijët; koordinimi funksional i strukturave vendore²⁰.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i seminareve për qark lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe aktet e tij nënligjore</p>	<p>2013: 12 seminare (mbulimi i të gjitha qarqeve)²¹ Aktivitete të mbështetura nga UNICEF. Konsiderohet i përmbushur nga ASHMDF</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Numri i trajnimeve për stafin e ASHMDF</p>	<p>2013: 1 Në dhjetor 2013, ASHMDF në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor falas Tiranë dhe Ministrinë e Shëndetësisë organizoi trajnimin me temë “Përmirësimi i sistemit të regjistrimit dhe raportimit të lindjes së Fëmijëve”</p> <p>2014: 3 Trainim me bazë orientuese mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe forcimin e aftësive të nevojshme si punonjës të mbrotjes së fëmijëve duke ndërthurur informacionin teorik me atë praktik. Trajnim “Përgjigja e Shërbimeve Publike ndaj Fenomenit të fëmijëve në lëvizje” Trainim lidhur me planin e veprimit për identifikimin, asistencën dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge</p> <p><i>Në progres</i>²²</p>

19. <http://www.sociale.gov.al/te-reja/deklarata-per-shtyp/mblidhet-keshilli-kombetar-per-femijet-veliaj-statusin-e-jetimit-e-leshon-vetem-sherbimi-social-shteteror&page=5>

20. ibid

21. ASHMDF

22. ASHMDF

Rritja e numrit të stafit të ASHMDF

2012: 6 persona

2014: 7 persona

Rritja me 1 person pranë departamentit të statistikave

Në progres²³

Objekti: Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikore për vlerësimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe përjashtimin social të fëmijëve në nivel kombëtar dhe në nivel qarku

Treguesit	Realizimi
Akti nënligjor i miratuar	VKM NR 267, datë 12.04.2012 “Për Llojet, Mënyrën e Shkëmbimit të Informacionit dhe të Dhënave Statistikore të Kërkuara nga Agjencia e nga Strukturat Shtetërore Përgjegjëse, në Nivel Qendror dhe Vendor përcakton nivelin e bashkëpunimit të të gjitha institucioneve të përfshira si në nivel kombëtar ashtu edhe vendor për të shkëmbyer të dhëna statistikore dhe informacion dhe për të monitoruar më pas treguesit përkatës. Ky vendim ndikon në një masë të madhe monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve që kanë si objektiv të drejtat e fëmijëve, nëpërmjet grumbullimit të të dhënave mbi rastet e abuzimit të fëmijës dhe grumbullimit të treguesve përkatës të cilët janë të një rëndësie më të madhe për të zhvilluar rekomandime të politikave dhe programeve për të mbështetur mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. ²⁴ <i>I realizuar</i>
Institucionet përgjegjëse përcjellin informacionin statistikor të kërkuar në ASHMDF	2013-2014 78% e NJMF kanë raportuar rregullisht në vitin 2013. <i>Në progres</i> ²⁵
Numri trajnimeve të sektorit të statistikës në ASHMDF dhe rrjetit të NJDF në qarqe	2012-2014: 0
Lista e treguesve e përfshirë në legjislacionin për mbledhjen e statistikave	2014: Në proces Tashmë lista e treguesve është pjese e planit 5 vjeçar të INSTAT ²⁶ <i>Në progres</i>

23. ASHMDF

24. <http://www.femijet.gov.al/doc/VKMNr.267.pdf>

25. ASHMDF

26. Ibid

Objektivi: Vendosja e një partneriteti dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel qendror e vendor, Organizatave Jo fitimprurëse që veprojnë në këtë fushë

Treguesit	Realizimi
VKM-të e miratuara	<p>VKM NR 263, datë 12.04.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme, për bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, përcakton mekanizmat e bashkëpunimit midis administrates vendore dhe qendrore dhe organizatave jo-fitimprurëse. Duke pasur parasysh rëndësinë e punës së organizatave jofitimprurëse gjatë viteve të fundit mbi rastet e referimit të fëmijës dhe administrimit, ishte e nevojshme të fuqizohej bashkëpunimi i tyre me institucionet publike për zbatimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.</p> <p><i>I realizuar</i>²⁷</p>
Marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF	<p>Viti 2012: Nuk ka marrveshje. Viti 2013: Marrëveshja e bashkëpunimit midis ASHMDF dhe Observatorit të Fëmijëve Viti 2014: Marrëveshjet e nënshkuara ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF në kuadër të ndërhyrjes “<i>Ndihmë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge</i>” Midis MMSR dhe MPB “Për indentifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr.1 dhe Fëmijët e Botës e të Shqipërisë” Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr.2 dhe ARSIS. Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr.3 dhe Të ndryshëm e të barabartë. Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr.5 dhe ARSIS. Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr.6 dhe ARSIS. Midis ASHMDF, Njesisë bashkiake Nr. 10 dhe ARSIS.</p> <p><i>Në progres</i></p>
Numri i seminareve të organizuara dhe numri i pjesmarrësve në to	<p><i>I paqartë</i> – nuk lidhet me aktivitet konkret te PKVF, i paqartë cilët janë aktorët e përfshirë në seminare.</p>

27. <http://www.femijet.gov.al/doc/VKMNr.263.pdf>

E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik

Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi

Objektivi: Regjistrimi i të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, të lindur, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë

Treguesit	Realizimi
Miratimi i akteve nënligjore për regjistrimin e fëmijëve	I porealizuar
Mbajtja e aktit të lindjes për të gjithë fëmijët e lindur brenda vendit	I paraportuar ASHMDF raporton paqartësi në mënyrën e mbledhjes së këtij informacioni
Mbajtja e aktit të lindjes/regjistrimi për të gjithë fëmijët e lindur jashtë vendit	I paraportuar ASHMDF raporton paqartësi në mënyrën e mbledhjes së këtij informacioni

Objektivi: Ngritja dhe funksionimi i mekanizmave institucionale në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik

Treguesit	Realizimi
Numri i takimeve dhe i pjesmarrësve në nivel lokal për zbatimin e ligjit	2013: 12 takime ASHMDF raporton se treguesi është kuptuar si i njëjtë me atë të objektivit: <i>Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për realizimin e të drejtave të fëmijëve.</i> I realizuar
Numri i NJMF dhe NJDF të ngritura	2012: NJMF – 49 NJDF - 10 2014: NJMF: 196 (vlerë akumulative në vite) NJDF – 12 (vlerë akumulative në vite) Në progres ²⁸
VKM e miratuar për bashkërendimin e punës	VKM NR 266, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore

28. ASHMDF

	<p>përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij” ka si qëllim të ndihmojë kategorinë e fëmijëve në rrezik dhe përcakton të gjitha procedurat e ndërhyrjes për një fëmijë në rrezik, strukturat për të bashkëpunuar dhe subjektet që do të kenë të drejtën për të referuar rastin. Përveç fëmijës dhe prindit ose kujdestarit ligjor, subjektet e tjera që kanë të drejtën të referojnë një rast abuzimi përfshijnë “çdo person i cili si rrjedhojë e punës së tij/ose të saj vërteton rastin e dhunës kundër një fëmije dhe shkeljen e të drejtës së fëmijëve”; “çdo person i cili ka lidhje farefisnore me fëmijën;” dhe “çdo person i cili vërteton shkeljen e të drejtës së fëmijëve ose subjektet anonime”²⁹.</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Udhëzimi i Ministrit për metodologjinë e veprimit të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve/Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.</p>	<p>2012-2013: Hartuar Protokollin e Proçedurave të ndërhyrjes për mbrojtjen e fëmijëve në rrezik</p> <p>2014: Proces Miratimi Me Udhër Nr. 158 datë 6.08.2014, të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës për vlerësimin e draft- proçedurave të hartuara deri tani dhe bashkërendimin e punës për hartimin e draftit final të tyre³⁰.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Takimet e grupeve multidisiplinare për menaxhimin e rastit të fëmijëve në rrezik.</p>	<p>NJMF mund të raportojnë informacion narrativ mbi numrin e grupeve multidisiplinare (nëse ekzistojnë). Ky informacion deri më tani nuk është grumbulluar për t’u prezantuar në mënyrë statistikore nga ASHMDF, as nuk është kërkuar si i tillë nga NJMF.</p> <p><i>Pa informacion</i></p>
<p>Rregullore të miratuara në qarqet ku janë ngritur Komitetet Drejtues dhe në Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV) ku janë ngritur ekipet teknike multidisiplinore.</p>	<p>2014: Miratuar nga cdo qark rregullore e sugjeruar nga ASHMDF</p> <p>2015: Do të jetë në proces miratimi nga NJQV³¹</p> <p><i>Në progres</i></p>

29. <http://www.femijet.gov.al/doc/VKMNr.266.pdf>

30. ASHMDF

31. ASHMDF

<p>Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar NJMF/NJDF</p>	<p>2013: 1 Në dhjetor 2013, ASHMDF në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor falas Tiranë dhe Ministrinë e Shëndetësisë organizoi trajnimin me temë “Përmirësimi i sistemit të regjistrimit dhe raportimit të lindjes së Fëmijëve”</p> <p>2014: 3 Trainim me bazë orientuese mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe forcimin e aftësive të nevojshme si punonjës të mbrotjes së fëmijëve duke ndërthurur informacionin teorik me atë praktik. Trajnim “Përgjigja e Shërbimeve Publike ndaj Fenomenit të fëmijëve në lëvizje” Trainim lidhur me planin e veprimit për identifikimin, asistencën dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Statusi i punonjësit social i miratuar</p>	<p>2014: Miratuar Ligji 163/2014 “Për statusin e punonjësit social”³²</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Numri i kontrolleve/monitormi</p>	<p>2014: Hartimi i metodologjisë së monitorimit të punës në terren (ASHMDF) Monitorime të kryera 10 NJMF³³</p> <p><i>Në progres</i></p>

Objekti: Zbatimi i programit COMBI: “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive”

Treguesit	Realizimi
<p>Numri i avokatëve në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar për mënyrat e reja të disiplinimit (MRD)</p>	<p>2012-2014 Një informacion I tillë nuk rezulton I raportuar nga MAS tek ASHMDF. Gjithashtu, informacion nuk u raportua as përmes kërkesës me email të ASHMDF për këtë tregues.</p> <p><i>I porealizuar</i></p>
<p>Numri i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave të trajnuar për MRD</p>	<p>2012-2014 66 seanca orientimi rajonale në të gjitha DAR të vendit</p>

32. http://www.parlament.al/web/pub/ligj_nr_163_dt_4_12_2014_20659_1.pdf

33. ASHMDF

	Janë trajnuar 2645 drejtore dhe nëndrejtorë shkollash, mësues, psikologe, staf nga DAR/ZA ³⁴
	<i>Në progres</i>
Numri i aktiviteteve promovuese në nivel DAR/ZA	2012-2014 Në të gjitha kopshtet dhe shkollat e arsimit parauniversitar është ngritur këndi i programit COMBI me materiale informuese për MRD ³⁵ .
	<i>Në progres</i>
Emisione televizive dhe radiofonike, artikuj sensibilizues në shtypin e përditshëm për MRD	2012-2014 Informacion i pambledhur nga ndonjë institucion për raportim
	<i>Pa informacion</i>
Krijimi i Aleancave Rajonale të MRD (DAR/ZA komunitetit i prindërve)	2012-2014
	<i>I realizuar</i> ³⁶
Raporte mujore për diskutimin e zbatimit të MRD në të gjithë shkollat e arsimit parauniversitar	<i>I porealizuar</i>
Raporte vlerësuese për zbatimin e MRD në fillim dhe në fund të zbatimit të programit COMBI	<i>I porealizuar</i>

Objektivi: Vendosja dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik në të gjitha kopshtet, shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm

Treguesit	Realizimi
Numri i shkollave që kanë psikolog	Viti 2014: 138 psikologe në nivel kombëtar Udhëzuesi për miratim (informacion më poshtë) pritet të përmirësojë strukturën ekzistuese
	<i>Në progres</i>
Trajnimi i psikologëve (250)	Nuk ka nje manual mbi detyrat dhe funksionimin e psikologut dhe punonjesit social në shkolla. Trajnime të paraportuara.
	<i>I porealizuar</i>

34. MAS

35. ibid

36. Raportuar nga MAS pranë ASHMDF

Ngritja e sistemit koordinues dhe supervizues së shërbimit të psikologut në shkolla

Një udhëzues i ri, përgatitur nga grup pune ndërsektorial është në proces hartimi me synim përmirësimin e shërbimit të psikologut dhe punonjësit social në shkolla.³⁷

Në progres

Objektivi: Internet i sigurtë për fëmijë

Treguesit	Realizimi
<p>Një Kod Kombëtar sjelljeje, etike ndërmjet të gjithë aktorëve</p>	<p>Viti 2012: VKM Nr. 182 datë 13.03.2013 u miratua Kodi i Sjelljes "Për përdorim të sigurtë dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike" ndërmjet operatorëve të komunikimeve elektronike"³⁸ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me Ministrinë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit (MITIK) koordinuan procesin për hartimin dhe miratimin e Kodit të Sjelljes. Aktualisht në Shqipëri nuk ekzistojnë standarte dhe rregullore të qarta në lidhje me klasifikimin e përmbajtjes komerciale dhe operatorët e komunikimit telefonik dhe online pranojnë se nuk kanë kontroll mbi përmbajtjen që ofrohet në internet, por nëpërmjet këtij Kodi ata sigurojnë që përmbajtja komerciale e ofruar nga ose nëpërmjet tyre do të kontrollohet e do të klasifikohet brenda një kuadri të përshtatshëm. Përmbajtja komerciale do të "shënjohet" për të dalluar nëse është i përshtatshëm për moshën nën 18 vjeç. Sipas këtij Kodi sipërmarrësit angazhohen të ndihmojnë fëmijët dhe prindërit lidhur me përdorimin e rrjeteve apo shërbimet e internetit, duke pasqyruar Udhëzimet për prindërit në faqet e tyre të internetit. Kodi i sjelljes së këtyre operatorëve është një hap i parë, por mbetet me rëndësi hartimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar internet të sigurtë për fëmijët.</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Marrëveshje bashkëpunimi ofruesit e shërbimeve të internetit dhe operatorëve celularë etj.</p>	<p>Më 11 shkurt 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike në bashkëpunim me AKSHI nënshkruan dy memorandume</p>

37. Raportuar nga MAS pranë ASHMDF

38. <http://www.akep.al/informacion/legjislacioni/245-ceremonia-e-firmosjes-se-kodit-te-sjelles>
<http://plus.al/download/Kodi-i-sjelljes-07-02-2013.pdf>

	<p>mirëkuptimi për bashkëpunim midis Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, operatorëve celularë: AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus, Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit , si dhe ofruesve të shërbimit të internetit: Abtelecom, Abcom, Abissnet, Tring Communication</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Nënshkrimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe biznesit</p>	<p>Si më sipër</p> <p><i>I realizuar</i></p>

Mbrojtja e fëmijëve nga format më të këqija të punës

Objektivi: Forcimi i masave për parandalimin dhe garantimin e një mbrojtje më efektive për fëmijët e shfrytëzuar në format më të rënda të punës.

Treguesit	Realizimi
<p>Miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal</p>	<p>2012-2014</p> <p>Ndryshimet në Kodin Penal me ligjin nr. 144/2013, dt. 20.5.2013, ofrojnë garanci për mbrojtjen adekuate të fëmijëve nga krimet seksuale dhe shfrytëzimi ekonomik. Ndër ndryshimet esenciale që mund të përmendim është Neni 1, ku shtohen fjalët “të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijëve,”. Githashtu në nenin 50, bëhen këto ndryshime: “e/1) kryerja e veprës penale gjatë ose pas dhënies së urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes nga dhuna në familje;”. Ligjvënësit ndër të tjera, ka vendosur që të forcojë masën e dënimit për krimin e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, veprë e cila nga 15 vjet burg tashmë dënohet me 25 vjet burg. Në kod është shtuar edhe një veprë e re penale Neni 107, që ka të bëjë me dhunën me natyrë seksuale, ndërkohë që Neni 108 është rindryshuar i gjithi për të ofruar një mbrojtje nga krimet seksuale për fëmijëve e moshës 14-18 vjeç. Po në këtë veprë penale është përfshirë edhe tentativa për të takuar fëmijën për të patur marrëdhënie seksuale me të. Një shtesë tjetër në Kod është edhe ngacmimi seksual, përfshi edhe fëmijët, në paragrafin e ri C të nenit 108 të KP.</p>

Një rregullim të plotë ligjor ka pësuar edhe pornografia e fëmijëve në nenin 117 të Kodit Penal, i cili në ndryshimet e tij të fundit, e konsideron edhe posedimin, rekrutimin e një serë formash të tjera të pornografisë së fëmijëve si një krim.

Po ashtu një zgjidhje adekuate është gjetur edhe për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Neni 124, paragrafi C i Kodit, është përmirësuar, duke përfshirë të gjithë format e shfrytëzimit të fëmijëve. Neni i ri thotë: “Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Në progres

Aktivitete ndërgjegjësuere në të gjithë qarqet e vendit kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve

Për këtë tregues nuk ekziston një instrument matës apo raportues nga institucione të ndryshme për raportim tek NJDF apo ASHMDF

2014: Një fushatë sensibilizimi është ndërmarrë për të ndërgjegjësuar qytetarët mbi fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve në situatë rruge dhe për të denoncuar këtë fenomen nga ASHMDF/DPSHSSH dhe OJF. Pikënisjen e saj fushata e pati më datë 12 qershor 2014, Ditën Botërore kundër punës së Fëmijëve, me moton “Jo punës së fëmijëve”.

Për të vazhduar informimin dhe komunikimin me opinionin publik fushata po vazhdon cdo të enjtë, duke përfshirë grupe vullnetare nga të gjitha nivelet, nxënës, studentë të gjitha fakulteteve, të rinj në bashkëpunim me Drejtorinë e Rinisë në MMRS, vullnetarë nga organizata të komunitetit rom. Kjo fushatë synon dhe njohjen e publikut me punën dhe rezultatet e arritura nga institucionet në lidhje me fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve dhe ndihmën që po u jepet këtyre fëmijëve dhe familjeve.

Në progres

Studimi i INSTAT për punën e fëmijëve

2013: Raporti Publikuar³⁹

I realizuar

39. Dayiogly, M., 2013. Fëmijët që punojnë në Republikën e Shqipërisë. Tiranë: ILO/INSTAT

Objektivi: Rritja e rolit të Inspektoratit Shtetëror të Punës për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e situatës së fëmijëve që punojnë

Treguesit	Realizimi
Institucionalizim i bashkëpunimit në përputhje edhe me Ligjin për inspektimin Nr10433 dt 16.6.2011	2014: Raportuar në proces Në progres
Trajnimi i 120 inspektorëve të ISHP	2013: Raportuar në proces 2014: Raportuar në proces Në progres
Hartimi i Strategjisë së Inpektimit në Punë 2013-2020 duke i dhënë një fokus të veçantë punës së të miturve	2014: Drejtorja e Inspektimit të Punës dhe Dialogut Social, pranë MMRS raporton strategjinë në proces hartimi Në progres ⁴⁰

E drejta për zhvillim dhe arsim

Krijimi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme

Objektivi: Pusheti vendor ka aftësitë dhe buxhetet e nevojshme për të promovuar zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Treguesit	Realizimi
Studimi kombëtar për zhvillimin e hershëm të fëmijëve 0-3 vjec është zhvilluar dhe ka evidentuar problematikat dhe hapat për të ardhmen	Me mbështetjen e UNICEF është realizuar vlerësimi mbi shërbimet për fëmijërinë e hershme në çerdhe, institucionet rezidenciale dhe sektorin e shëndetësisë, duke evidentuar edhe problematikat në fushat përkatëse ⁴¹ . I realizuar
Standardet për çerdhet, për fëmijët 0-3 vjeç, janë përgatitur dhe miratuar	Standardet për projektimin e çerdheve janë hartuar në bashkëpunim me UNICEF, por nuk janë miratuar ⁴² . Në progres

40. Informacioni për tre treguesit e mësipërm është raportuar nga Inspektorati Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale si në proces pa ofruar detaje të mëtejshme

41. Haxhiymeri, E., Hallkaj, E., Ndrilo, M., Boci, A., 2013. Vlerësimi i kapaciteteve për shërbimet e fëmijëve 0-3 vjec. Tirane:UNICEF

42. <http://www.unicef.org/albania/Standartet-e-Cerdheve.pdf>

<p>Buxheti i pushtetit lokal për fëmijët 0-3 vjeç është rritur me 5%</p>	<p>Informacion i raportuar nga pushteti lokal përmes ndonjë instrumenti raportimi. Ky informacion nuk mbledhet gjithashtu nga asnjë agjensi tjetër, dhe nuk është përlogaritur në këtë nivel nga ndonjë studim.</p> <p><i>Pa informacion</i></p>
<p>Programe prindërimi sidomos me fokus shtresat në nevojë janë krijuar dhe implementuar</p>	<p>Protokolli/udhëzuesi i vizitave shëndetësore në komunitet është hartuar dhe miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me UNICEF, të zbatuara vetëm në kuadër të një projekti në familjet Rome⁴³.</p> <p><i>Në progres</i></p>

Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët

Objektivi: Përmirësimi dhe konsolidimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor publik cilësor dhe falas në nivelet e parashkollorit, arsimit të detyruar

Treguesit	Realizimi
<p>Rritje e numrit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë në arsimin parashkollor</p>	<p>MAS vlerëson që rreth 70% e fëmijëve 3-5 vjeçar ndjekin kopshtin. I padisponsueshëm përqindja për vitin 2012.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri kopshteve të reja dhe atyre të rikonstruara</p>	<p>Viti 2011-2012 Total Kopshte 1907 (1761 publike dhe 146 private)</p> <p>Viti 2012-2013 Total kopshte 1941 (1778 publike dhe 133 private)</p> <p>Viti 2013-2014 Total Kopshte 1900 (1773 Publike dhe 127 private)⁴⁴</p> <p><i>Analizimi i të dhënave tregon se numri total i kopshteve nuk është në rritje, por në 2014 ka 12 kopshte publike me shumë se në 2012</i></p> <p><i>I raportuar numri i kopshteve të rikonstruara</i></p> <p><i>Në progres</i></p>

43. Informacion i raportuar nga UNICEF tek ASHMDF

44. Ministria e Arsimit dhe Sporteve

<p>Rishikimi i kurrikulave të arsimit të detyruar</p>	<p>Reforma kurrikulare e arsimit bazë në vitin 2013 u përpoq të ofronte një kurrikul të re, por me gjithë përpjekjet e bëra, nuk arriti të zhvillojë një kurrikul me bazë kompetencat. Një reformë e re ka nisur tashmë me qëllim shndërrimin e kurrikulave në bazë kompetencash⁴⁵.</p> <p>Urdhri Nr. 323, datë 07.08.2014 “Për pilotimin e kurrikules së re në institucionet arsimore të arsimit bazë nd sistemin arsimor parauniversitar”.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i shkollave të reja për arsimin e detyruar</p>	<p>Viti 2011-2012 Total Shkolla Arsimi Bazë 1473 (1341 publike dhe 132 private)</p> <p>Viti 2012-2013 Total kopshte 1472 (1346 publike dhe 126 private)</p> <p>Viti 2013-2014 Total Kopshte 1464 (1340 Publike dhe 124 private)⁴⁶</p> <p><i>Analizimi i të dhënave tregon se numri total i shkollave të arsimit bazë është në ulje, dhe në vitin 2014 ka një shkollë më pak publike se në 2012)</i></p> <p><i>I perealizuar</i></p>
<p>Përqindja e buxhetit të shtetit dhe Përqindja e fondeve që do të alokohen nga të ardhurat e njëjësive të qeverisjes vendore për përhapjen e shkollave të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në to</p>	<p>Për arsimin bazë 2012: 1,976,687 ALL Shpenzime kapitale 2013: 1,245,335 ALL Shpenzime kapitale 2014: I paraportuar shpenzimi, buxheti i planifikuar 1,800,000 ALL</p> <p>Për arsimin e mesëm 2012: pa informacion 2013: pa informacion 2014: 1,171,738 ALL shpenzime kapitale</p> <p>Arsimi profesional 2012: 281,628 ALL 2013: 344,949 ALL 2014: 193,613 ALL⁴⁷</p>

45. Karameta, P. et al. 2014. Reforma e sistemit arsimor parauniversitar– Raport Vlerësues paraprak, Grupi i punës për reformimin e arsimit parauniversitar. Tirane: MAS

46. Ministria e Arsimit dhe Sporteve

47. Instituti i studimeve bashkëkohore. 2014. Vleresimi afatshkurtër i buxhetit dhe shpenzimeve në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015. Tiranë:ISB/EU

I paraportuar informacioni për njësitë e qeverisjes vendore.

Informacioni ekzistues tregon më ulje të buxhetit për infrastrukture, por duke ditur që pushteti lokal është një përgjegjës për infrastrukturën e institucioneve arsimore, është e mundur të arrihet në një konkluzion.

I paplotë si informacion

Ngritja apo rehabilitimi i bibliotekave Ngritje e kabineteve dhe laboratorëve Sigurimi i lidhjes me internet dhe laboratorët e teknologjisë

Koordinimi jo i mirë ndërmjet shkollave dhe DAR-ve, si dhe mungesa e fondeve ka bërë që bibliotekat të mos furnizohen me tituj të rinj librash që shërbejnë për nxitjen, motivimin dhe përjasjen e nxënësve ndaj librit.

Përsa i përket infrastrukturës së mësimdhënies, shkollat publike disponojnë laboratorë demonstrues të lëndëve fizikë, kimi, biologji dhe gjeografi, por në shumë raste ata nuk janë funksionalë. Mosfunksionimi i laboratorëve vjen si rezultat i sasisë së pamjaftueshme të mjeteve laboratorike dhe mjediseve të nevojshme për ngritjen e klasave laborator. Jo gjithmonë mjetet laboratorike që ofrohen nga DAR-et, përputhen me kërkesat e programeve për këto mjete, apo të nevojave që kanë realisht shkollat⁴⁸.

Në shkollat e arsimit bazë publik, raportohen 15731 PC, nga të cilët 11331 janë funksionalë, ndërsa 4400 PC janë jofunksionalë. Shkollat raportojnë 1631 laptopë, nga të cilët 432 janë jashtë funksionit. Raporti numër kompjuterësh në përdori për nxënës, ndryshon nga shkolla në shkollë; afërsisht, ky raport është 1:27 ose më keq. Në më shumë se 1/3 e shkollave, nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e informacionit online⁴⁹.

Në progres

Hartimi dhe përgatitja e modeleve alternative për trajnimin e mësuesve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve në përputhje me nevojat e tyre

Informacion mbi këtë tregues nuk është raportuar. Trajnimet profesionale të mësuesve tashmë ofrohen nga palët e treta, institucione jashtë MAS, si i tillë ky informacion nuk raportohet nga ndonjë institucion.

Pa informacion

48. Gjedia, R., et al (2013) "Raport Vlerësimi i fushave Klima dhe Etika në Shkollë dhe Kujdesi ndaj Nxënësit, IKAP

49. Karameta, P. et al. 2014. Reforma e sistemit arsimor parauniversitar– Raport Vlerësues paraprak, Grupi i punës për reformimin e arsimit parauniversitar. Tirane: MAS

Objektivi: Gjithëpërfshirje në mësimnxënie pavarësisht gjendjes social-ekonomike të familjes, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo vendodhjes gjeografike

Treguesit	Realizimi
<p>Rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK</p>	<p>Nëse marrim për bazë statistikën e numrit të popullsisë rome 3-18 vjeç, të nxjerr nga rajonizimi i popullsisë rome i realizuar nga UNICEF (2012), rezulton se: 87% e fëmijëve të moshës 6-18 vjeç janë në shkollë dhe 39% e fëmijëve 3-6 vjeç frekuentojnë kopshtin⁵⁰. Për vitin 2013-2014, 66% e nxënësve që ndjekin klasat e “Shansit të dytë janë romë⁵¹. <i>Informacioni aktual nuk mundëson analizimin e të dhënave për të treguar nëse treguesi është realizuar në këtë fazë. Disagregimi i të dhënave për fëmijët romë/egjiptianë në arsim ka nisur në vitin 2013 duke e bërë të pamundur krahasimin me vite të mëparshme.</i></p> <p>Në progres</p>
<p>Programe pune, kurrikula për fëmijët me aftësi të kufizuara që studiojnë në shkolla</p>	<p>Kurrikula aktuale raportet të jetë shumë “e rënduar” për fëmijët e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale. Për më tepër mungon mospajisja me teksteve mësimore të përshtatura, materiale e mjete të tjera lehtësuese për realizimin e programit. Mësuesit nuk kanë një udhëzues për përshtatjen e kurrikulës për nxënësit me aftësi të kufizuara⁵².</p> <p>I porealizuar</p>
<p>Aktet e miratuara për arsimin e fëmijëve me nevoja të kufizuara</p>	<p>Urdhri i Kryeministrit Nr. 232, datë 2.12.2013 “Per ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për zyrtarizmin e gjuhës së shenjave në RSh”. Urdhri Nr. 66, datë 18.03.2014 për “Ngritjen e grupit teknik për zyrtarizmin e gjuhës së shenjave në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në progres</p>
<p>Vazhdimi i shpërndarjes së teksteve falas në arsimin e detyruar 9-vjeçar, për të siguruar aksesin e duhur në arsim të</p>	<p>Kompesimi i teksteve falas në arsimin baze shprehet përmes shpenzimeve për këtë zë⁵³: 2012: 300,098 ALL</p>

50. <http://www.sidalbania.org/romacom.html>

51. Informacion nga MAS

52. http://resourcecentre.savethechildren.se/sites/default/files/documents/inclusive_education_in_albania_-_analytic_study.pdf

53. Instituti i studimeve bashkëkohore. 2014. Vleresimi afatshkurtër i buxhetit dhe shpenzimeve në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015. Tiranë:ISB/EU

<p>fëmijëve që i përkasin familjeve përfituese të Ndihmës ekonomike.</p>	<p>2013: 277,289 ALL 2014: 246,000 ALL</p> <p>Iniciativa ka vazhduar për vitet 2012-2014, duke qene se treguesi thekson vazhdueshmërinë e ndërhyrjes, mund të thuhet se është në progres, pavarësisht, shpenzimeve në zbritje ndër vite.</p> <p>Në progres</p>
<p>Vendosja e transportit për fëmijët dhe mësuesit</p>	<p>2012: 393,803 ALL 2013: 523,000 ALL 2014: 560,000 ALL</p> <p>Të dhënat tregojnë për rritje të buxhetit të vendosur në dispozicion për këtë shërbim⁵⁴.</p> <p>Në progres</p>

Objektivi: Ulja e nivelit të braktisjes së shkollës

Treguesit	Realizimi
<p>Uljen e braktisjes shkollore në Arsimin Bazë nën 0.3%</p>	<p>Sipas MAS treguesi zyrtar i braktisjes shkollore vlerësohet të jetë 0.43% 2013-2014</p> <p>I parealizuar</p>

Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimarrës në shkollë dhe jashtë saj

Objektivi: Nxitja e pjesëmarrjes së vazhdueshme dhe cilësore të fëmijëve në vendimarrje për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe në veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës.

Treguesit	Realizimi
<p>Hartimi i instrumentave dhe modaliteteve për pjesëmarrjen e fëmijëve në:</p> <p>a.informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik.</p> <p>b.të marrin përgjegjësi kundrejt vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit.</p>	<p>Funksionimi i Qeverisë së nxënësve, në shkollat e arsimit parauniversitar realizohet në zbatim të nenit 37 të Dispozitave normative të arsimit parauniversitar.</p> <p>Pothuajse në të gjitha shkollat e inspektuarara nga IKAP në 2013⁵⁵, janë ngritur organet kolegjiale si: Bordi i Shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Pedagogjik, Qeveria e Nxënësve dhe Këshilli i Disiplinës,</p>

54. Instituti i studimeve bashkëkohore. 2014. Vlerësimi afatshkurtër i buxhetit dhe shpenzimeve në përmbushje të Planit Kombëtar të Veprimit të Fëmijëve 2012-2015. Tiranë:ISB/EU

55. Gjedra, R., et al (2013) "Raport Vlerësimi i fushave Klima dhe Etika në Shkollë dhe Kujdesi ndaj Nxënësit" IKAP

c.të praktikojnë forma të delegimit dhe përfaqësimit.

d.të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës monitorim të zgjedhjes dhe të funksionimit të qeverisë së nxënësve.

por funksionimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë e vazhdueshme. Mungesa e një bashkëpunimi efikas me to reflekton një hallkë “të këputur” të funksionimit të mirë të institucioneve arsimore.

Drejtoritë e shkollave jo në të gjitha rastet kanë vënë në dispozicion mjedise për funksionimin normal të Qeverisë së Nxënësve. Qeveria e Nxënësve drejtohet nga një mësues/e koordinator, i cili lehtëson zgjidhjen e problemeve dhe veprimtaritë e planifikuara. Ai jo gjithmonë është përzgjedhur nga nxënësit. Qeveria e Nxënësve rrallë është përfshirë në hartimin e planit vjetor të shkollës dhe në vendimmarrje. Qeveria e Nxënësve, në pak raste mban dokumentacion të rregullt mbi veprimtarinë e saj.

Në progres

Objektivi: Promovimi i të drejtave të fëmijëve

Treguesit	Realizimi
Lloji i materialeve të shpërndara	Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi. Mund të jetë pjesë e programeve/projekteve të ndryshme. MAS dhe ASHMDF nuk disponojnë informacion konkret mbi këtë tregues. <i>I paraportuar</i>
Numri i shkollave ku janë shpërndarë	Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi. Mund të jetë pjesë e programeve/projekteve të ndryshme. MAS dhe ASHMDF nuk disponojnë informacion konkret mbi këtë tregues. <i>I paraportuar</i>
Numri i Qeverisë së Nxënësve të trajnuar	Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi. Mund të jetë pjesë e programeve/projekteve të ndryshme. MAS dhe ASHMDF nuk disponojnë informacion konkret mbi këtë tregues. <i>I paraportuar</i>
Lloji i aktiviteteve ku fëmijët kanë ushtruar të drejtën e tyre për pjesëmarrje	Ky informacion nuk mblidhet apo raportohet nga ndonjë institucion në përgjithësi. Mund të jetë

(në shkollë, struktura vendimmarrëse në NJQV)

pjesë e programeve/projekteve të ndryshme. MAS dhe ASHMDF nuk disponojnë informacion konkret mbi këtë tregues.

I paraportuar

E drejta për Kujdes Shëndetësor

Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për nënën dhe fëmijën

Objektivi: Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve shëndetësore për nënën dhe foshnjën e porsalindur

Treguesit	Realizimi
Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore me 3% në vitin 2014 nga niveli bazë i vitit 2012. Zvogëlimi i vdekshmërisë amtare me 2% në vitin 2014 nga niveli aktual i 2012.	<p>Ministria e Shëndetësisë viti 2012: vdekshmëria foshnjore (deri në një vjeç) shënon 7.9/1000 për lindje të gjalla. Viti 2013: 7.3/1000 lindje të gjalla</p> <p>INSTAT: Viti 2013: 8.84/1000 lindje të gjalla</p> <p>Ministria e Shëndetësisë Viti 2012: vdekshmëria amtare rezulton e ulur në 5.7 vdekje në 100 mijë lindje Viti 2013: 11.8 për 100.000 lindje të gjalla 2014: i paraportuar akoma</p> <p><i>Në progres</i> për vdekshmërinë foshnjore. <i>Në regres</i> për vdekshmërinë amtare.</p>
Përqindja e grave shtatzënë që marrin vizitën e parë brenda tremujorit të parë të shtatzënisë	<p>2012: 62% (MSH) 2013: 57.7% (MSH) 2014: i paraportuar akoma</p> <p>Pavarësisht se përqindja e grave është në zbritje, në mungesë të të dhënave për vitin 2014 nuk mund të dilet në konkluzione të tendencës.</p> <p><i>Në progres</i></p>
Përqindja e grave që asistohen nga personel mjekësor gjatë lindjes	<p>Viti 2012: 99.06% (MSH) Viti 2013: 99.95% (INSTAT) 99.97% (MSH) 2014: i paraportuar akoma</p> <p><i>Në progres</i></p>

<p>Numri protokolleve të përgatitura për kujdesin për të porsalindurin.</p>	<p>2012-2014: 6 protokolle të miratuar për kujdesin e të porsalindurit dhe nënës pas lindjes. Puna për këtë ka nisur në 2012, mbështetur nga UNICEF⁵⁶.</p> <p><i>Protokollet</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizitat e kontrollit për kujdesin shëndetësor të nënës pas lindjes • Kujdesi paslindjes për foshnjën e porsalindur • Menaxhimi i problemeve shëndetsore të nënës pas lindjes • Menaxhimi i problemeve shëndetsore tek i porsalinduri • Menaxhimi i shqetësimeve të nënës pas lindjes • Shenjat kërcënuese të neonatit <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Numri punonjësve të trajnuar të kujdesit shëndetësor të përfshirë në ofrimin e kujdesit obstetrik dhe neonatal, lidhur me praktikën e kujdesit holistik për lindjen dhe porsalindurin</p>	<p>2012-2014</p> <p>Trajnimi personelit shëndetësor të materniteteve Korçë, Vlorë, Kukës, Durrës, lidhur me paketën e trajnimit kujdesi efektiv perinatal/kujdesi për gruan shtatzënë. Numri i ofruesve të shëndetësisë së trajnuar është 579, nga 87 Qendra Shëndetësore⁵⁷.</p> <p><i>Në progres</i></p>

Objektivi: Të sigurohet që çdo institucion kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën, të ofrojë kujdes efektiv dhe bashkëkohor për ushqyerjen me gji duke zbatuar 10 hapat për një ushqyerje të suksesshme me gji⁵⁸

Treguesit	Realizimi
<p>Numri institucioneve shëndetësore të akredituar për menaxhimin e ushqyerjes me gji</p>	<p>2012: 5 institucione 2013: 8 institucione 2014: 9 institucione (nga 12 në gjithë Shqipërinë)</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen me gji dhe çështjet gjinore lidhur me të.</p>	<p>2013: 40 punonjës të rrethëve Gjirokastër, Delvinë, Sarandë, Shkodër 2014: 170 punonjës të shëndetësisë, shërbimi kujdesit parësor shëndetësor</p> <p><i>Në progres</i></p>

56. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

57. Informacioni është raportuar nga UNICEF tek ASHMDF

58. Treguesit e këtij objektivi janë raportuar tek ASHMDF nga Insituti i Shëndetit Publik

<p>Treguesit e ushqyerjes me gji të përcaktuar dhe të agreguar sipas gjinisë, vendndodhjes dhe gjendjes social ekonomike dhe të mbledhur periodikisht.</p>	<p>Tregues i plotësuar në vitin 2013 (Instituti i Shëndetit Publik).</p> <p>I realizuar</p>
<p>Numri fushatave në media lidhur me ushqyerjen me gji</p>	<p>Lloji i aktiviteteve 2013-2014: Website www.ushqyerjaefemijeve.com Rrjete sociale Transmetim radio 10 biseda TV 10 artikuj media shkruar Takime e konkurs me nënat</p> <p>Në progres</p>

Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët

Objektivi: Zbatimi i programeve kombëtare për të promovuar të ushqyerit e shëndetshëm, aktivitetin fizik të fëmijëve, “gender sensitive”

Treguesit	Realizimi
<p>Udhëzuesit dietetikë për fëmijët të përgatitur sipas moshës dhe gjinisë</p>	<p>2012-2014: 6 Udhërrëfyes janë hartuar dhe miratuar⁵⁹ Hapat për një ushqyerje të sukseshme me gji në komunitet Shtesat në mikronutiente tek fëmijët Ushqyerja e fëmijës me formule foshnjore Fillimi i ushqyerjes shtesë tek fëmijet Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna</p> <p>I realizuar</p>
<p>Protokollet për ndjekjen e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve nga kujdesi parësor shëndetësor</p>	<p>2012-2014: 6 Udhërrëfyes janë hartuar dhe miratuar⁶⁰ Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 0-6 muajsh Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 6-24 muajsh Vizitat e monitorimit të rritjes dhe zhvillimit për fëmijët 2-6 vjeç Monitorimi i zhvillimit të fëmijës 0-6 vjeç</p>

59. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

60. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

	<p>Ndjekja e rritjes sipas kurbave të rritjes Vleresimi i dëgjimit tek fëmijët 0-6 vjeç Vleresimi i shikimit tek fëmijët 0-6 vjeç</p> <p><i>I realizuar</i></p>
<p>Numri i treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës të përfshira në sistemin e monitorimit të performancës së qendrave shëndetësore</p>	<p><i>I porealizuar</i></p>
<p>Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen dhe këshillimin për ushqyerjen.</p>	<p>Mbështetur në kuadrin rregullator të miratuar, u hartuan module të akredituara të trajnimit për ofruesit e shërbimit për monitorimin e rritjes dhe ushqyerje. Aktivitetet e trajnimit me përfitues 579 ofrues shërbimi (87 qendra shëndetësore) në Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Durrës pritet të shtrihen ndër ofrues në mbarë vendin.</p> <p><i>Raportimi për këtë tregues është i njëjtë me atë të objektivit më sipër. Treguesi: Numri punonjësve të trajnuar të kujdesit shëndetësor të përfshirë në ofrimin e kujdesit obstetrikal dhe neonatal, lidhur me praktikat e kujdesit holistik për lindjen dhe porsalindurin</i></p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i trajnimeve të kryera</p>	<p><i>I paraportuar</i></p>
<p>Kurrikulat shkollore për ushqyerjen të përgatitura dhe të përfshira në programet shkollore.</p>	<p>Nxënësit e klasave 1-9 të arsimit bazë janë prezantuar me kurrikulat e edukimit mbi ushqyerjen, hartuar nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit. Ky edukim është pjesë e moduleve kros kurrikulare. 20 shkolla kanë pilotuar modulet në Kukës, Shkodër, Tirana and Durrës. Rreth 300 sesione të hapura edukimi si edhe 10 evente me pjesëmarrjen e mësuesve, nxënësve dhe prindërve janë organizuar gjatë 2013-2014. Në vazhdimësi pritet aplikimi i moduleve në të gjithë shkollat e vendit⁶¹.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Përqindja e personelit arsimor të trajnuar për rëndësinë e ushqyerjes dhe aktivitetit fizik</p>	<p><i>I pavlefshëm</i>⁶²</p>

61. Raportuar nga Instituti i Shëndetit Publik tek ASHMDF

62. Cilësuar si i tillë nga Instituti i shëndetit Publik

Numri fushatave promociionale lidhur me aktivitetin fizik për fëmijëtViti 2013-2014: 5 fushata⁶³***Në progres***

Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë

Objektivi: Vaksinimi i plotë në kohë të gjithë fëmijëve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. Monitorimi i cilësisë së vaksinave dhe survejimi për imunizim të popullatës

Treguesit	Realizimi
Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë	2012-2014. Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë për të tre vitet është mbi 97% <i>Në progres</i>
Numri vaksinave te reja te përfshira në kalendarin kombëtar të vaksinimit	2012-2014: 1 - Vaksina e IPV Për të gjithë fëmijët e lindur që nga 1 Mars 2014 dy dozat e para të vaksinës së poliomielitit bëhen me vaksinën inaktive IPV. IPV nuk është antigen i ri, por ndryshim i llojit të vaksinës nga ajo orale me pika në atë inaktive me injeksion. <i>I realizuar</i>
Përqindja e popullatës rome të vaksinuar sipas kalendarit rutinë	Viti 2012-2013: (MSH) Nga fushatat e kryera rezultojnë vetëm fëmijët shtesë të vaksinuar, pra që nuk janë vaksinuar nga vaksinimi rutine (75 fëmijë). Përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik raportojnë se ky tregues nuk mund të mblidhet, pasi nuk ekziston asnjë informacion i disagreguar në bazë etnie në sistemin shëndetësor. Informacion mund të vazhdojë të mblidhet përmes fushatava, por nuk mund të tregojë përqindjen e popullatës së vaksinuar. <i>Pa informacion/i pavlefshëm</i>
Numri i personelit shëndetësor të trajnuar lidhur me imunizimin, dhe sistemin e raportimit	Viti 2012: 500 Viti 2013: 200 Viti 2014: 600 <i>Burimi: Instituti i Shëndetit Publik</i> <i>Në progres</i>

63. Ky informacion është raportuar nga UNICEF tek ASHMDF, por pa detaje mbi fushatat.

<p>Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për zinxhirin ftohës</p>	<p>Viti 2012: 500 75 persona të ritrajnuar për pajisjet e reja si frigoriferët ice-lined dhe rregjistruarit e temperaturave (Fridge-Tag). Këta persona kanë trajnuar në vazhdim të gjithë stafin vaksinator në Shqipëri.</p> <p>Viti 2013: 200</p> <p>Viti 2014: Në fund të 2014 është parashikuar trajnimi për një pajisje të re monitoruese të temperaturave për rreth 600 punonjës sipas skemës në komentin e mësipërm.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Numri i kontrolleve të bëra për sëmundjet infektive dhe joinfektive.</p>	<p>Viti 2012: 50 Viti 2013: 30 Viti 2014: 40</p> <p>Përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik ngrenë pikëpyetje mbi pavlefshëmërinë e këtij treguesi.</p> <p><i>I pavlefshëm</i></p>
<p>Numri i aktiviteteve promociionale, edukimi shëndetësor i komunitetit, familjeve, lidhur me rëndësinë e vaksinimit të fëmijës. Fuqizimi i sistemit ALERT</p>	<p>Viti 2013-2014: Persa i perket rëndesise se vaksinimit eshte realizuar nje emision i posacem televiziv mbi rëndesine e vaksinimit, i cili ritransmetohet here pas here sipas kerkesave tona e po ashtu eshte prodhuar nje video per sistemin elektronik te vaksinimit e cila behet publike here pas here ne rrjetet sociale. Sistemi alert nuk ka ndryshuar ai vazhdon të ruajë të njëjtin nivel raportimi në të tria vitet (2012-2014) me 97%.⁶⁴</p> <p>Përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik ngrenë pikëpyetje mbi pamundësinë e matjes së treguesit mbi numrin e aktiviteteve në nivel kombëtar.</p> <p><i>I pamatshëm</i></p>
<p>Numri i aktiviteteve promociionale dhe edukuese për parandalimin e sëmundjeve infektive/ higjena ushqimore, vetjake dhe e ambientit, masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve ngjitëse, etj</p>	<p>Viti 2012: 3 Viti 2013: 2 Viti 2014: 2</p> <p>Ky tregues nuk mblidhet dhe raportohet nga asnjë institucion. Përfaqësues të Institutit të Shëndetit</p>

64. Instituti i Shëndetit Publik

	<p>Publik ngrene pikepyetje mbi pamundësinë e matjes së tij në nivel kombëtar.</p> <p><i>I pamatshëm</i></p>
Numri i temave/orëve mësimore të zhvilluara në shkollë mbi sëmundjet infektive	<p>Ky tregues nuk mblidhet dhe raportohet nga asnjë institucion. Përfaqësues të Institutit të Shëndetit Publik sugjerojnë për heqjen e tij nga seksioni i shëndetit.</p> <p><i>I paraportuar/i pamatshëm</i></p>
Observatori i shëndetit në ISH	<p>2012-2013: Në proces diskutimi për funksionin dhe mënyrat e punës së tij 2013-2014: Asnjë ecuri zhvillimi</p> <p><i>I porealizuar</i></p>

Objektivi: Monitorimi i rregullt i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor në qendrat shëndetësore dhe këshillimoret e fëmijës

Treguesit	Realizimi
Protokollet e unifikuara, rregulloreve, etj për monitorimin e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës	<p>2012-2014: 6 Udhërrëfyes⁶⁵ Hapat për një ushqyerje të sukseshme me gji në komunitet Shtesat në mikronutiente tek fëmijët Ushqyerja e fëmijës me formule foshnjore Fillimi i ushqyerjes shtesë tek fëmijet Ushqyerja me gji tek nënat me HIV/AIDS Ushqyerja me gji në rast sëmundjeje të nënës dhe kur trajtohet me barna</p> <p><i>I realizuar</i></p>
Numri i qendrave shëndetësore që ofrojnë ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës	<p>2012-2014: 413 (të gjitha Qendrat Shëndetësore)</p> <p><i>I realizuar</i></p>
Përqindja e fëmijëve të moshës 0-1 vjeç që marrin vizitat e detyrueshme sipas protokollit klinik	<p>Ky informacion nuk mblidhet dhe raportohet nga Insituti i sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor. Raportimi bëhet vetëm me numër vizitash.</p> <p><i>I paraportuar/i pamatshëm</i></p>

65. Ministria e Shëndetësisë, Urdhër No. 62/18.02.2014 dhe 157/26.04.2014

Numri i trajnimeve dhe personelit të trajnuar për monitorimin e rritjes, zhvillimit si dhe përmirësimin e aftësive këshilluese për shëndetin e fëmijës.

Mbështetur në kuadrin rregullator të miratuar, u hartuan module të akredituara të trajnimit për ofruesit e shërbimit për monitorimin e rritjes dhe ushqyerje. Aktivitetet e trajnimit me përfitues 579 ofrues shërbimi (87 qendra shëndetësore) në Kukës, Shkodër, Tiranë dhe Durrës pritet të shtrihen ndër ofrues në mbarë vendin.

Në progres

I njëjti informacion është raportuar në tre indikatorë të ndryshëm në planin e veprimit, për shkak të përkufizimit të gabuar të treguesve.

Objektivi: Zgjerimi i modelit të MISF (Menaxhimi i Integruar i Sëmundjeve të Fëmijërisë) për ndjekjen dhe trajtimin e fëmijëve 0-5 vjeç në të gjitha shërbimet e KSHP të kujdesit për fëmijën

Treguesit	Realizimi
Numri personelit te trajnuar	Viti 2012-2013: 70 mjek dhe 40 infermierë të Kujdesit Shëndetësor Parësor Korçë 45 mjek familjeje Durrës Viti 2013-2014: I paraportuar <i>Në progres</i>
Numri i komunave që janë përfshirë në modelin e MISF komunitar	Viti 2012-2013: 5 komuna të Korçë që kanë gjithsej 62045 banorë dhe 2766 fëmijë 0-5 vjeç Viti 2013-2014: I paraportuar <i>Në progres</i>

Kontrolli dhe parandalimi i IST, përfshirë HIV/AIDS

Objektivi: Parandalimi dhe ulja e rasteve të HIV/AIDS dhe IST te fëmijët

Treguesit	Realizimi
Numri i fëmijëve dhe nënave me HIV/AIDS	Viti 2012: (28 raste në total) 4 raste të reja Viti 2013: (34 raste në total) 6 raste të reja Viti 2014: (38 në total) 4 raste të reja Specialistët e Institutit të Shëndetit Publik raportojnë shqetësimin e formulimit të treguesit për nënat me HIV/AIDS. Ato sugjerojnë

	<p>zëvendësimin e tij me një tregues “Nr i grave shtatzene te testuara per HIV/AIDS rezultuar me status pozitiv”.</p> <p>I papërcaktuar mirë</p>
<p>Numri qendrave të referencës nëpër maternitete dhe që janë të pajisuara me reagentë dhe pajisje laboratorike për HIV/AIDS</p>	<p>Viti 2012-2014: 1</p> <p>Qendra Kombëtare e referencës për parandalimin e transmetimit të HIV nga nëna te fëmija pranë Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” në Tiranë.</p> <p>I realizuar</p>
<p>Numri qendrave shëndetësore që ofrojnë trajtim për HIV/AIDS</p>	<p>Viti 2012-2014: 0</p> <p>I porealizuar</p>
<p>Numri i materialeve informative për HIV/AIDS të përgatitura dhe shpërndara</p>	<p>Viti 2012: 12 000 fletë-palosje 8000 postera 2000 postcard-s Viti 2013: 12 000 fletë-palosje 8000 postera 2000 postcard-s Viti 2014 – I paraportuar</p> <p>Në progres⁶⁶</p>
<p>Ofrimi i egzaminimeve dhe trajtimi i fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS, në një qendër të specializuar</p>	<p>Trajtimi i femijeve të infektuar me HIV bëhet vetëm në 1 qendër, Shërbimi i Pediatriisë, Qendra Spitalore “Nënë Tereza”, Tiranë.</p> <p>I realizuar</p>
<p>Numri i fushatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS</p>	<p>Viti 2012: 3 Dhjetor 2012, diskutim në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë mbi çështjen e fëmijëve HIV pozitiv në Shqipëri Takime në Ishëm, Durrës me strukturat e Drejtorisë Arsimore për menaxhimin e rastit HIV pozitiv të një fëmije që ndiqte shkollën në këtë fshat.</p> <p>Viti 2013: Fushata e 1 Dhjetorit ka vendosur theksin në parandalimin e transmetimit nga nëna te femija.</p>

66. Informacion i raportuar nga Programi Kombëtar për HIV/AIDS tek ASHMDF

Diskutim në Komisionin Parlamentar të Shëndetësisë me fokus Parandalimin e Transmetimit nga Nëna tek femija dhe fëmijët me HIV

Viti 2014: Takime në Tiranë dhe Vlorë për menaxhimin e rastit HIV pozitiv të një fëmije jetim që jeton me HIV/AIDS në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Njësinë për mbrojtjen e fëmijëve pranë Bashkisë Vlorë.

Në progres⁶⁷

E drejta për Mbrojtje Ligjore

Mbrojtja e fëmijëve në konfliktin me ligjin

Objektivi: Rritja e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve si dhe shkurtimi i afateve kohorë të tyre.

Treguesit	Realizimi
Ulja e kohëzgjatjes së mbajtjes në paraburgim të të miturve (vlerësohet: 5-7 muaj, synimi: 2-4 muaj).	I paraportuar
Dekreti i Presidentit për seksionet e të miturve në gjykatat e shkallës së parë	I porealizuar
Miratimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale	Viti 2013: Ngritja e grupit të punës Viti 2014: I Paraportuar ⁶⁸ I porealizuar
Numri i trajnimeve dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur me të trajnuar me praktikat më të mira në administrimin e drejtësisë për të mitur.	I paraportuar

67. Informacion i raportuar nga Programi Kombëtar për HIV/AIDS tek ASHMDF

68. Informacion nga Ministria e Drejtësisë tek ASHMDF

Objektivi: Rritja e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur.

Treguesit	Realizimi
<p>Përqindja e të miturve në konflikt me ligjin të devijuar nga procesi gjyqësor dhe referuar në masa alternative të dënimit me burgim (vlerësim: 20%, synimi: 40%)</p>	<p>Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2014, numri i fëmijëve të dënuar me dënime alternative është 290, nga të cilët 7 femra dhe 234 djem. Ndërsa në vitin 2013, numri i fëmijëve të dënuar në total është 325, nga të cilët 3 femra dhe 323 djem. Nga një vështrim krahasimor, në një mesatare të dy viteve 2013 dhe 2014, përgjatë një 6-mujori vihet re një tendencë në rritje e numrit të dënimeve alternative të dhëna nga gjykata për fëmijët në konflikt me ligjin.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Protokolle, rregullore për zbatimin e dënimeve alternative për të miturit</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës me mbështetjen e UNICEF, në Tetor 2014, lancoi program “Google mapping”, me të cilën bëhet i mundur identifikimi i zyrave vendore të shërbimit të provës si dhe i qendrave pritëse me të cilat mund të bashkëpunojnë për zbatimin e dënimit alternativ për të miturit.</p> <p>Me Urdhrin Nr. 100, datë 21.02.2014 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të provës”, numri i stafit të shërbimit të provës është rritur nga 104 në 134 punonjës të arsimuar në fushën e drejtësisë, punës sociale dhe psikologjisë.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>Krijimi i dhomës së ndërmjetësve</p>	<p>Në mbështetje me Ligjin nr.10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, më datë 07.07.2013, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe JUST-USAID, datë, 07.07.2013 u zhvillua Mbledhja e parë e Ndërmjetësve të licensuar dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve⁶⁹</p> <p><i>I realizuar</i></p>

69. http://www.dhkn.gov.al/?page_id=5909

Objektivi: Rehabilitimi dhe rintegrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin.

Treguesit	Realizimi
<p>% e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit, që ndjekin arsim të detyruar (vlerësim: ska, synimi: 100% e të miturve që nuk kanë kryer arsimimin e detyruar ndjekin shkollën).</p>	<p>Viti 2012: Sipas analizës vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve 2012, gjatë periudhës shtator-nëntor 2012, nga fillimi i zbatimit të Memorandumit të nënshkruar më datë 05.12.2008 midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, për hapjen e ciklit të detyruar shkollor 9 vjeçar në sistemin e burgjeve, përpos shkollave në 5 burgje të vendit, për herë të parë në vitin e ri akademik 2012-2013, u hapën 3 shkolla brenda institucioneve të paraburgimeve “Jordan Misja”, I.E.V.P. Vlorë, I.E.V.P. Lezhë, në seksionin e të miturve dhe 1 shkollë në burgun e Rogozhinës për të dënuarit në moshë madhore. Sipas të dhënave të muajit dhjetor 2012, 228 të dënuar janë regjistruar në shkolla.</p> <p>Viti 2013-2014: Në IEVP, zhvillohet procesi arsimor i detyrueshëm i ciklit 9 vjeçar për personat me liri të kufizuar. Procesi shkollor në IEVP, zhvillohet në bazë të marrëveshjes midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, mbi bashkëpunimin mbi procesin arsimor në IEVP. Kurrikulat mësimore, planet, regjistri i shkollës dhe dokumentacionet e tjera, janë të njëtrajtshme me shkollat publike, duke qenë se shkollat në IEVP janë vartëse të tyre. Regjistrimi i nxënësve në shkolla kryhet mbi bazën e dokumentit të mbarimit të shkollës. Me përfundimin e shkollës, i mituri përfiton dëftesën nga shkolla përkatëse ku është regjistruar. Në total 45 të mitur kanë përfunduar ciklin mësimor 2013-2014. Të miturit, gjithashtu, janë të punësuar sipas mundësive që ofrojnë institucionet. Në total, 9 të mitur janë të aktivizuar në aktivitetet punësimi⁷⁰.</p> <p><i>Në progres</i></p>
<p>% e të miturve që kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegruar (vlerësim:50%, synimi: 90% kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegruar).</p>	<p>Viti 2014: MMSR dhe MD janë në fazën e rishikimit të Memorandumit të Bashkëpunimit me qëllim përgatitjen për ri-integrim të personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim,</p>

70. Informacion I dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve tek ASHMDF

nëpërmjet organizimit të formimit profesional në IEVP, dhe krijimit të mundësive për ri-integrimin e tyre në shoqëri, pas lirit. Formimi profesional i personave të paraburgosur dhe të dënuar me burgim do të realizohet përmes kurseve të formimit profesional që do të zhvillohen në ambiente të veçanta të përshtatura për dhënie mësimi dhe praktikë profesionale pranë IEVP. Kurset e formimit profesional në IEVP do të zbatohen nga Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Në progres

Treguesit për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të miratuara

I porealizuar

Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin

Objektivi: Plotësimi i kuadrit ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën (14 vjeç) e përgjegjësisë penale.

Treguesit	Realizimi
Ligji dhe akte nënligjore të miratuara për zbatimin e masave educative për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale.	2012-2014: 0 <i>I porealizuar</i>
50 % e të miturve që kryejnë krim dhe janë nën moshën e përgjegjësisë penale të përfshirë në programe edukuese	Sipas legjislacionit Shqiptar të miturit nën moshën 14 vjeç përjashtohen nga ndjekja penale, por ata mund të jenë subjekt i masave edukuese apo rehabilituese ⁷¹ . Këto programe nuk janë aplikuar asnjëherë për shkak të mungesës së infrastrukturës së nevojshme ⁷² . <i>I porealizuar</i>

Objektivi: Ndikim i drejtpërdrejtë në rehabilitimin e tyre në shoqëri.

Treguesit	Realizimi
Hartimi i një set treguesish	<i>I porealizuar</i> (afati i realizimit përcaktohet në vitin 2015)

71. Neni 12, 46 Kodit Penal.

72. Xhafellari, M., Gjoni, O., 2013 Fëmijët nën moshën për përgjegjësi penal. Tirana:ARSIS/QSHPLI/Save the Children, p. 28

Mbrojtja e fëmijëve, viktima dhe dëshmitarë të krimit

Objektivi: Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit.

Treguesit	Realizimi
Rregullimet në KPP, KP të miratuara	I porealizuar (afati i realizimit përcaktohet në vitin 2015)
Protokolle dhe sistemi i monitorimit të trajtimit të miturve si viktima dhe dëshmitarë	I porealizuar (afati i realizimit përcaktohet në vitin 2015)

Objektivi: Përmirësimi i trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë.

Treguesit	Realizimi
Ndryshime në infrastrukturën e policës për mjedise miqësore ndaj të miturve	<p>Viti 2013 Me mbështetjen e organizatës Save the Children, Albania, janë ngritur dhoma të intervistimit miqësor për fëmijët në 6 komisariate të policisë së Tiranës.</p> <p>Në progres</p>
Numri i trajnimeve dhe i personave të trajnuar (gjykatë, prokurorë, polici gjyqsore, etj)	I paraportuar

Diskutime mbi Treguesit e Progresit

Përmbledhje e kategorizimeve

Ky seksion do të përqëndrohet në kategorizime të ndryshme të mundshme të treguesve. Kjo qasje na lehtëson të kuptuarin e treguesve të përdorur në PKVF, dhe orienton mbi problematikat aktuale lidhur me to.

Statusi i realizimit

Duke ndjekur parimet e përcaktuara në metodologji për karakterizimin e treguesve, paraqetitet një përmbledhje sipas fushave të të drejtave mbi statusin aktual të ecurisë së treguesve.

E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale

Tregues të realizuar: **8**

Tregues që tregojnë progres (nivele të ndryshme): **19**

Tregues të porealizuar: **1**

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë: **7**

E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik

Tregues të realizuar: **8**

Tregues që tregojnë progres (nivele të ndryshme): **14**

Tregues të porealizuar: **5**

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë: **4**

E drejta për zhvillim dhe arsim

Tregues të realizuar: **1**

Tregues që tregojnë progres (nivele të ndryshme): **11**

Tregues të porealizuar: **3**

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë: **7**

E drejta për kujdes shëndetësor

Tregues të realizuar: **9**

Tregues që tregojnë progres (nivele të ndryshme): **18**

Tregues të porealizuar: **3**

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë: **9**

E drejta për mbrojtje ligjore

Tregues të realizuar: **1**

Tregues që tregojnë progres (nivele të ndryshme): **5**

Tregues të porealizuar: **8**

Tregues të paraportuar/painformacion/pavlefshëm/paqartë: **3**

Kategoritë e ndryshimit

Kategoritë e treguesve janë të lidhur me matjen e niveleve/kategorive të ndryshme të ndryshimit. Në rastin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve, është e rekomandueshme një kombinim i treguesve që masin ndryshimet strukturale, procesin dhe rezultatet.

Treguesit strukturalë reflektojnë ratifikimin dhe adoptimin e instrumentave ligjorë; si edhe ekzistencën e mekanizmave bazik institucional dhe buxhetor të konsideruara të rëndësishme për lehtësimin e realizimit të të drejtave specifike të fëmijëve.

Treguesit e procesit masin përpjekjet në nivel qendror, rajonal dhe vendor për të zbatuar përcaktimet strukturore. Ato përfshijnë zbatimin e masave të politikave, programe specifike veprimi, iniciativat e trajnimeve, fushatave dhe aktiviteteve të tjera që synojnë përmbushjen e të drejtave specifike të fëmijëve. Ato janë shpesh progresivë në natyrën e tyre, kështu që janë më pranueshme për të matur progress në kohë.

Treguesit e rezultateve masin arritjet individuale dhe kolektive që reflektojnë nëse të drejtat e fëmijëve janë realizuar në një kontekst të caktuar, dhe shkallën e përfitimit të fëmijëve nga ndërhyrjet/veprimet e realizuara.

Kombinimi i këtyre treguesve, i përqafuar së fundi nga organizma të ndryshëm të fushës së të drejtave të fëmijëve, synojnë tranzicionin nga treguesit e fokusuar vetëm tek rezultatet, drejt treguesve të cilët reflektojnë më mirë veprimet dhe impaktin e politikave. Fusha të ndryshme të drejtash mund të përshtaten me kategoritë e sipërpërmendura të indikatorëve.

PVP 2012-2015 paraqet tregues të të tre kategorive, por bazohet më së tepërmi tek treguesit e procesit.

E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale

Tregues strukturalë: **7**

Shembull: Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ndryshimeve të ligjit Nr. 9355, dt. 05.12.2006 për pilotim të skemës së re të ndihmës ekonomike.

Tregues procesi: **27**

Shembull: Numri i njësive të qeverisjes vendore për pilotim të skemës së re të ndihmës ekonomike

Tregues rezultati: **2**

Shembull: Numri i fëmijëve të birësuar

E drejta për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik

Tregues strukturalë: **8**

Shembull: Miratimi i akteve nënligjore për regjistrimin e fëmijëve

Tregues procesi: **21**

Shembull: Numri i shkollave që kanë psikolog

Tregues rezultati: **0**

E drejta për zhvillim dhe arsim

Tregues strukturalë: **4**

Shembull: Buxheti i pushteti lokal për fëmijët 0-3 vjeç është rritur me 5%

Tregues procesi: **14**

Shembull: Ngritja dhe rehabilitimi i bibliotekave të shkollave

Tregues rezultati: **3**

Shembull: Rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me aftësi të kufizuara.

E drejta për kujdes shëndetësor

Tregues strukturalë: **4**

Shembull: Protokolle të miratuara për ndjekjen e kujdesit të fëmijëve

Tregues procesi: **28**

Shembull: Numri i fushatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS

Tregues rezultati: **7**

Shembull: Përqindja e fëmijëve të vaksinuar

E drejta për mbrojtje ligjore

Tregues strukturalë: **6**

Shembull: Miratimi i ligjit për zbatimin e masave educative për fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale

Tregues procesi: **6**

Shembull: Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar për trajtimin e fëmijëve si viktimë dhe dëshmitarë

Tregues rezultati: **5**

Shembull: 50% e të miturve që kryejnë krim dhe janë nën moshën e përgjegjësisë penale të përfshirë në programe edukuese

Ky përcaktim specifik për kategori të ndryshme të treguesve për fushë synon pikërisht të konkretizojë përfundimin mbi mungesën e një balance apo bashkërendimi të treguesve strukturalë, procesit dhe rezultatit (dallim bën kapitulli mbi mbrojtjen ligjore). Mungesa e dukshme e treguesve të rezultatit është një nga arsyet që vlerësimi i ecurisë së progresit të PVF nuk mund të identifikojë situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në vend.

Qasja ndaj matjes së ndryshimit

Një kategorizim tjetër i treguesve është i lidhur me përjashtjen cilësore dhe sasore të vlerësimit. *Tregues sasiorë* janë shifror (numër, përqindje); përmbajnë ndryshore që mund të paraqiten lehtësisht në mënyrë numerike.

Treguesit cilësorë shënojnë ndryshore që nuk është e lehtë të paraqiten numerikisht. Për to përdoret shkalla vlerësuese përshkruese.

Këta tregues përfaqësojnë dy paradigma të ndryshme për të pasqyruar e kuptuar realitetin, të lidhur me mënyrën sesi të dhënat mbledhen (fjalë përkundrejt numrave), dhe nga perspektiva e përzgjedhur (perspektiva përkundrejt objektive) apo zbuluese përkundrejt shpjeguese.

PVP 2012-2015 bazohet tërësisht në tregues sasior, në mungesë të plotë të perspektivës cilësore. Një gjë e tillë është e pritshme për shkak të përdorimit të treguesve të procesit. Përjashtja cilësore mund të ishte një alternativë e lidhur me treguesit e rezultateve, për të matur në një kornizë vlerash ndryshimet e përfituara nga

fëmijët. Metodologjia cilësore do të siguronte mbi të gjitha përfshirjen e perceptimeve të fëmijëve në realizimn e të drejtave. Kështu, përfshirja e tyre do të ishte subjekti i matjes si pjesë përbërëse e treguesve të PVF.

Nga ana tjetër, në një fushë veprimi të caktuar, përdorimi i tregusve sasior dhe cilësor do të kërkonte një metodologji tepër të mirëpërcaktuar për të shmangur disa nga sfidat e metodologjisë mikse.

Çështje të lidhura me përcaktimin e treguesve

Në këtë seksion do të shqyrtohen disa çështje të tjera, me qëllim evidentimin e problematikave të tregueve të përfshirë në PKVF, që sfidojnë përcaktimin e statusit të përmbëshjes së tyre.

- PKVF përmban tregues që u mungon përcaktimi i shkallës së matjes së progresit.

Shembull: Aktivitete ndërgjegjësuere në të gjithë qarqet e vendit.

Edhe pse ky përbën një fushë treguesi, i mungon ndryshueshmëria e ndryshimit për t'u matur. Fusha e treguesit ka nevojë për specifikim konkret siç mund të ishte: numri i fushatave të zhvilluara; numri i përfituesve të fushatës, etj.

Shembull: Vendosja e transportit për fëmijët dhe mësuesit.

Do të ishte tepër e vlefshme nëse treguesi do të ishte formuluar në mënyrë rezultative për të matur numrin e përfituesve nga vendosja e transportit, apo strukturale nëse do të matej buxheti i vendosur në dispozicion për të siguruar transportin. Mos përcaktimi nuk lejon pasqyrimin efektiv të ndryshimit dhe mbi të gjitha dështon të jetë nxitës për autoritetet përgjegjëse në përmbushjen e tij.

- PKVF përmban tregues që nuk përmbushin funksionin e pikës së referimit ose të krahasimit.

Një tregues i mirëpërcaktuar gjendet tek kapitulli i mbrojtës ligjor: “Ulja e kohëzgjatjes së mbajtjes në paraburgim të të miturve (vlerësohet 2012 5-7 muaj, synimi: 2-4 muaj).

Në disa raste si p.sh. tek treguesi “Ulja e braktisjes shkollore në arsimin bazë nën 0.3%” edhe pse është i pranishëm elementi krahasues mungon informacioni fillestar për të kuptuar progresin.

Pjesa më e madhe e treguesve nuk reflektojnë as pikën e referimit as atë të krahasimit.

- Tregues që nuk masin ndryshim.

Shembull: Numri i materialeve informative për HIV/AIDS të përgatitura dhe shpërndara.

Tregues të tillë procesi nuk shprehin shumë në vetvete, duke ngritur një nga pyetjet me të rëndësishme të përcaktimit të treguesve, atë të dobishmërisë së tyre.

Përgjithësisht, PKVF përmban më tepër fusha treguesit, por jo elementë benchmark (indiciot) e ndryshimit – tregues fillestar dhe progresi. Kornizës aktuale i mungojnë treguesit sinjalizues të alarmit – të lidhur me standartet. Këta tregues informojnë se çfarë përcakton regresin me pasoja negative për situatën e të drejtave të fëmijëve.

- Karakterizuar nga fragmentimi në konceptimin e treguesve, në PKVF ekziston raportim për indikatorë të formuluar ndryshe por përsëritës.

Shembull: Numri i takimeve dhe i pjesmarrësve në nivel lokal për zbatimin e ligjit. Dhe,

Numri i seminareve për qark lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe aktet e tij nënligjore.

- Janë të pranishëm tregues që nuk korespondojnë mes fushës së caktuar të së drejtës dhe sektorit/institucionit përgjegjës për raportim.

Shembull: Numri i temave/orëve mësimore të zhvilluara në shkollë mbi sëmundjet infektive (vendosur në fushën e së drejtës për kujdes shëndetësor)

Një gjë e tillë, evidenton mangësinë kryesore të PKVF, në të cilin nuk është përfshirë institucioni përgjegjës për raportimin e secilit tregues.

- PKVF nuk përcakton veprime dhe tregues mbi fenomene të rëndësishme të lidhura me fenomene apo grupe vulnerable të fëmijëve, siç janë fëmijët e ngjuar, etj.
- Tregues të PKVF janë të shkëputur e të palidhur me njëri-tjetrin. Si të tillë, ato dështojnë të japin panoramë tërësore të fushave/komponentëve të caktuar.

Shembull: Lidhur me shërbimin e kujdestarisë, edhe pse 5 tregues janë përcaktuar, ato humbasin të japin panoramën mbi zhvillimin sepse u mungon informacioni për fëmijët në kujdestari, sipas grupmoshës, gjinisë, apo ata që ndërpresin shërbimin e kujdestarisë.

Çështje të lidhura me mbledhjen e informacionit

Në mbledhjen e informacionit për shkrimin e këtij raporti u evidentuan problematika të tjera si:

- burime të nevojshme financiare për të mbledhur dhe raportuar informacion mbi treguesit e PKVF nuk ishin buxhetuar apo shpenzuar nga institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal përgjatë gjithë shtrirjes kohore të tij;
- ndryshimi i formateve të mbledhjes së të dhënave dhe raportimit të institucioneve përkatëse, siç është rasti i Shërbimit Social Shtetëror, duke krijuar një boshllëk të informacionit për vitin 2013;
- mosraportimi i treguesve specifik nga institucionet
- kontradita / mospërputhshmëria e informacioneve të marra për të njëjtët tregues nga institucione të ndryshme – Vdekshmëria foshnjore dhe amtare raportohen ndryshe nga Ministria e Shëndetësisë dhe INSTAT, për shkak të përdorimit të metodave të ndryshme të përlogaritjes.

Përfundime dhe Rekomandime

Planit të veprimit të fëmijëve 2012-2015 i mungon një kornizë strategjike, tërësore dhe e mirëpërcaktuar e sistemit të treguesve për të matur objektivisht statusin e ecurisë së zbatimit të veprimtarive apo situatën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Tregues të parealizuar u evidentuan në këtë raport, që mund të dëshmojnë në më të mirën e rasteve në rivlerësim të prioriteve të ndërhyrjes nga sektorë të ndryshëm. Megjithatë, problematik qëndron fakti që nuk u arrit të merrej asnjë informacion mbi arsyet/faktorët e lidhur me mosrealizimin e tyre, apo zëvendësimin e treguesve me të tjerë më relevantë.

Treguesit në progres, siç përmendet dhe në hyrje të këtij dokumenti, do të jenë fokusi kryesor i ndjekjes së ecurisë në vijim. ASHMDF dhe partnerët përgjatë vitit 2015 duhet të intensifikojnë përpjekjet për të mbledhur informacion të vlefshëm mbi to.

Treguesit e realizuar nuk do të jenë pjesë e vlerësimit të ardhshëm të treguesve (fund 2015).

PKVF duhet të riformulojë tregues të paqartë apo pavlefshëm, në bashkëpunim me ekspertët e fushave në mënyrë që treguesit e pavlefshëm apo të paraportueshëm të zëvendësohen ku është e mundur me tregues të përmirësuar. Më tepër investigim duhet të realizohet në vijim lidhur me ato tregues që janë të paraportuar, në mënyrë që statusi i tyre të jetë më mirë i përcaktuar në vlerësimin e ardhshëm.

Përfundimet e këtij rishikimi përkthehen në një proces vlerësimi të vazhdueshëm në vitin e ardhshëm për treguesit e PKVF. Kjo praktikë është e ndryshme nga qasja tradicionale e vlerësimit të arritjeve si pjesë e një aktiviteti të ndodhur në një kohë të kufizuar/përcaktuar. Procesi të mësuarit institucional që do të përfshijë rishikimin dhe përmirësimin e treguesve të PKVF, do të jetë tepër i vlefshëm në procesin e hartimit të planit të ri kombatar të veprimit të fëmijëve.

Mbi këtë argumentim, sesioni i konkluzioneve prezantohet në vijim si përmbledhje rekomandimesh për këto procese. Treguesit e përfshirë në PKVF duhet të konsiderohen ngushtësisht të lidhur me sistemet e të dhënave për fëmijët në vend. Kështu, rekomandimet janë të vlefshme për të dyja rastet:

- Hartimi i një kornize/sistemi të plotë/gjithëpërfshirës treguesish që përcakton përmbajtjen e treguesve, institucionet/aktorët e përfshira në përcaktimin, mbledhjen e raportimit të treguesve, mekanizmat për të koordinuar dhe komunikuar me ta, metodologjinë e mbledhjes dhe raportimit të treguesve, si edhe buxhetet e nevojshme për të mbledhur dhe raportuar këto të dhëna.
- Konceptimi i kornizës/sistemit të treguesve si diçka më tërësore sesa rezultatet në fushat e të drejtave të përftuara në kohë (për shembull, regjistrimi në shkollë, etj). Vetëm monitorimi i rezultateve nuk do të sigurojë shpjegime për prirjet/tendencat, dhe ecurinë.

- Ndërtimi i kornizës/sistemit të treguesve në harmoni me sistemet e të dhënave që mbliidhen zyrtarisht nga institucionet.
- Formulimi i treguesve sipas metodologjive dhe parimeve si më poshtë:
 - o Treguesit duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin në mënyrë të tillë që marrëdhëniet dhe ndryshimet në këto marrëdhënie mund të sigurohen për të sugjeruar shpjegimet e mundshme për ndryshimet e vrojtuar në rezultate. Për shembull në fushën e të drejtës për zhvillim dhe arsim, për të kuptuar më së mirë ecurinë e progresit së zbatimit të PKVF apo situatën e të drejtave të fëmijëve, treguesit duhet të reflektojnë kontekstin (të dhëna demografike, etj.); burimet (burimet humane, materiale dhe financiare të disponueshme për sistemin arsimor); Proceset (tërësia e sistemeve që krijojnë mjedisin arsimor); Arritjet.
Brenda një kornize/sistemi tërësor, treguesit do të përbënin një kompozitë për të siguruar informacione të dobishme për dukuri/fusha komplekse si ato të lidhura me të drejtat e fëmijëve.
Në mënyrë ideale, një sistem treguesish mat komponentët e veçantë të sistemit dhe gjithashtu siguron informacion se si komponentët veprojnë së bashku për të prodhuar efektin e përgjithshëm. Me fjalë të tjera, i gjithë informacioni i siguruar nga një sistem i treguesve është/duhet të jetë më i madh se sa shumica e pjesëve të tij.
 - o Treguesit duhet të jenë:
 - *Realë* - të pasqyrojnë aspekte reale të funksionimit ose të veprimtarisë
 - *Të rëndësishëm* - të pasqyrojnë aspekte të rëndësishme të një funksioni ose veprimtarie; të sigurojnë informacion për problemet e rëndësishme të lidhura me fushën
 - *Të dobishëm* - të masë faktorët në të cilët mund të ndikojnë tek politikat/programet, etj.
 - *Të vlefshëm* - të pasqyrojnë atë çka është supozuar të shënojnë/masin.
 - *Të qartë* - të shprehin qartë nëpërmjet përmbajtjes qëllimin që synojnë.
 - *Objektivë* - të krijojnë mundësinë që përdorues të ndryshëm të treguesve të arrijnë në gjykime të njëjta.
 - *Të mundshëm* - të shënojnë mbledhjen e një informacioni të mundshëm.
 - *Të krahasueshëm* - të shënojnë elemente që janë të qëndrueshem gjatë kohës dhe kanë të njëjtin kuptim në kontekste të ndryshme, duke bërë të mundur krahasimim në kohë dhe në nivele të ndryshme.
 - *Të pranueshëm* - të pranohen nga të gjithë aktorët e lidhur me fushën.
 - o Shtrirja e matjes së ndryshimit nga treguesit duhet të jetë gjithëpërfshirëse - në aspektin e matjes së ndryshimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
- Përforcimi i lidershipit, dhe strukturave menaxheriale që funksionojnë bazuar në udhëzime të mirëpërcaktuara, dhe adoptueshme.
- Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të treguesve
- Buxhetimi i sistemit të treguesve nga niveli qendror deri në atë vendor, për të investuar në përmirësimin e kapacitetet njerëzore, mjeteve dhe proceseve të

nevojshme për ta shndërruar sistemin e treguesve në një system funksional dhe efektiv.

Rekomandimet e sipërpërmendura mund të jenë të vlefshme për sisteme të ndryshme treguesish. Por, korniza e sistemit për PKVF duhet të reflektojë për së tepërmi, parimet e promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Artikuj artikuj specifikë të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve orientojnë përcaktimin/krijimin e kornizës së nevojshme të treguesve për PKVF, dhe procesin e mbledhjes dhe raportimi të informacionit mbi to:

Mos diskriminimi (artikulli 2 KDF)

Përputhshmëria me këtë parim kërkon të vlerësohet fakti që fëmijët ndryshojnë sipas moshës, origjinës etnike, situatës social ekonomike, përkatësisë gjinore dhe faktorëve të tjerë. Treguesit duhet të paraqesin diversitetin e fëmijëve. Kjo lidhet ngushtësisht me parimin e disagregimit të të dhënave, një mungesë e theksuar e treguesve aktualë të PVF.

Interesi më i mirë i fëmijës (Artikulli 3 KDF)

Interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë fokusi i planifikimit, zbatimit të politikave dhe çdo procesi vendimmarrës. Zbatimi i këtij artikulli kërkon tregues me fokus fëmijën.

E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit (Artikulli 6 KDF)

E drejta garanton plotësimin e kushteve më të mira për zhvillimin individual të fëmijës. Tregues të lidhur me këtë të drejtë shkojnë përtej atyre sasior e cilësor, apo vdekshmëri foshnjore, ato lidhen me aksesin e shërbimeve dhe cilësinë e jetës.

Pjesëmarrja e Fëmijëve (Artikulli 12 KDF)

Tregues që reflektojnë këtë të drejtë dëshmojnë për përfshirjen e fëmijëve. Realizimi i përfshirjes së këtyre treguesve kërkon investime në kërkime pjesëmarrëse cilësore dhe sasior me fëmijë në kontekste/situata e me karakteristika të ndryshme.

Shtojcë

Kritere që mund të merren parasysh për hartimin e treguesve specific të bazuara në të drejtat e fëmijëve⁷³:

- o Treguesit i konsiderojnë fëmijët si një grup social të të drejtpërdrejtë vëzhgimi (jo thjesht pjesë e familjes apo komunitetit, institucionit)
- o Treguesit i konsiderojnë fëmijët si agjentë aktivë/aktorë social kompetnet (jo objekte passive, apo thjesht marrës së shërbimeve)
- o Treguesit bazohen në përkufizimin e KDF të 'fëmijës' si individ nën 18 vjeç. Megjithatë, treguesit mund të shfaqin fleksibilitet në përcaktimin e limiteve të moshës, duke përfshirë në disa raste edhe grupmoshën e të rinjve.
- o Treguesit përdorin të dhëna të orientuara nga fëmijët, të disagreguara sipas moshës e karakteristikave të ndryshme, për të reflektuar parimin e mosdiskriminimit.
- o Treguesi adreson dimension e brezave (të krahasimit të të drejtave të fëmijëve me statusin e të drejtave të të rriturve)
- o Treguesi bazohet në një kornizë normative të të drejtave të fëmijës që përfshin:
 - Respektimin e të drejtave
 - Promovimin e të drejtave
 - Përbushjen e të drejtave
- o Treguesit reflektojnë parimin e universalitetit të standartit (duke synuar krahasimin mes vendeve apo sektorëve)
- o Treguesit reflektojnë parimin ndërlidhjes mes të drejtave, për të mos qëndruar të izoluar/shkëputuar
- o Treguesit përmbajnë parimin e fuqizimit të fëmijësve si zotërues të së drejtës
- o Treguesit përmbajnë parimin e përgjegjshmërisë së përbushësve të detyrimeve (institucioneve, përfshirë familjen) Treguesit reflektojnë të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje. Ato përshkruhen në gjuhë të kuptueshme prej tyre.
- o Treguesit shprehin ndarjen e përgjegjësive mes prindërve/familjeve/kujdestarëve, institucioneve dhe shtetit.
- o Treguesi shoqërohet me një metodologji të qartë: kush e mbledh/raporton, për çfarë qëllimi, bazuar mbi cilat të dhëna/sisteme.
- o Treguesit janë të përshtatshëm, të vlefshëm, të besueshëm, të thjeshtë, e të përmbledhur.
- o Treguesit bazohen në koncepte/përkufizime të pranuar.

73. European union agency for fundamental rights (1020) "Developing indicators for the protection, respect and promotion of the rights of the child in the European Union" (Hartimi i treguesve për mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Bashkimin Europian)



Save the Children

Rr. "Komuna e Parisit", Lagjia 8,
Pallatet I Maji, Vila "Lami"; P.O. Box 8185

Tel: +355 4 2261840

Tel: +355 4 2261929

Tel: +355 4 2266227

Fax: +355 4 2263 428

info.albania@savethechildren.org
albania.savethechildren.net



Savethechildrenal



Savethechildrenalb